



FAQE 4



FAQE 4



FAQE 7



FAQE 8

Koha

www.koha.mk



Shtetet që
po vrasin
gazetarët

FAQE 15

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3213 • E premte 3 nëntor 2017 15 DEN



KSHZ refuzoi ankesat e BESËS

Shkup, 2 nëntor - Të enjten në seancë të veçantë për shqyrtimin e ankesave partiake nga rrethi i dytë zgjedhor, Komisioni Shtetëror Zgjedhor ka hedhur poshtë të gjithë 86 ankesat e Lëvizjes BESA për Komunën e Çairit dhe një ankesë për Komunën e Tetovës. Para-

prakisht, të gjitha ankesat e Lëvizjes BESA për Çairin, anëtarët e KSHZ vendosën ti akumulojnë në një ankesë të vetme me arsyetimin se të 86 ankesat - kishin për bazë parregullsi të njëjta. Anëtarja e KSHZ-së, Ermira Asani Salija, kërkoi që të hapën kutitë e vendvo-

timeve për Komunën e Çairit me qëllim që të shihen edhe njëherë mbi 1000 fletëvotimet e pavlefshme, por që nuk u mor parasysh nga anëtarët tjetër e KSHZ-së. Duhet theksuar se përfaqësuesja e Lëvizjes BESA në KSHZ, Ermira Asani Salija votoi njëjtë... **FAQE 3**

Përfundoi procesi gjyqësor për "Lagjen e Trimave"

746 vjet burg për Grupin e Kumanovës



Shqiptimin e aktgjykimeve për të akuzuarit e "Lagjes së Trimave", gjykatësja Verka Petrovska, të enjten e ka bërë në mungesë shumicës së të akuzuarve. Duke e pasur parasysh aktakuzën e ngritur nga Prokuroria, e mbështetur në veprat penale "organizatë terroriste" dhe "terrorizëm", Trupi gjyqësor të enjten 26 të akuzuar nga "Grupi i Kumanovës" i dënoi me 746 vjet heqje lire, shtatë prej tyre me burg të përjetshëm dhe katër të akuzuar në mungesë provave u lirua nga akuzat **FAQE 5**

Rruga Shkup-Bllacë me para të ndërkombëtarëve!



Shkup, 2 nëntor - Me Buxhetin e vitit 2018 nuk do të parashihen mjete për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, por vetëm 3 milionë euro për sanimin e këtij aksi rrugor. Edhe pse pas rishikimit të buxhetit të vitit 2017, Ministria e Financave u zotua se më Buxhetin e vitit 2018 do të parashihen

mjete buxhetori për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, pasi me rishikim janë paraparë mjete financiare për përgatitjen e dokumentacionit final, gjegej-sisht projektit të ri. Në pyetjen se pse autostrada Shkup-Bllacë nuk parashihet të ndërtohet me para buxhetore, ministri i Financave, Dragan Tevdovski,

u përgjigj se Qeveria tani më ka aplikuar për sigurimin e mjeteve financiare nga IPA Fondet për ndërtimin e këtij aksi rrugor. "Në mënyrë aktive punohet në sigurimin e dokumentacionit të ri për ndërtimin e këtij aksi rrugor. Vitin e ardhshëm me siguri se do të kemi dokumentacionin final dhe nëse... **FAQE 2**

FORUM Ekuacione diplomatike në Ballkan



Ngjarjet e fundit në Ballkan kanë treguar se barometri i diplomacisë "aktive" ka pësuar një luhajtje të ndjeshme duke favorizuar ekonominë politike. Dalja në shesh e disa të dhënave ku tregohet se gjigandi rus "Gazprom" po synon të monopolizojë përmes privatizimit të gjithë tregun ballkanas të... **FAQE 10-11**

RAJON Qeveria e Haradinajt ka 200 këshilltarë!

FAQE 14

RAJON Njohja e Kosovës nuk është e pakthyeshme

FAQE 14

SPECIALE Kush e tradhtoi Ana Frankun?



FAQE 16



Buxheti për vitin 2018 në debat publik

Rruga Shkup-Bllacë me para të ndërkombëtarëve

Edhe pse pas rishikimit të Buxhetit të viti 2017, Ministria e Financave u zotua se më Buxhetin e vitit 2018 do të parashihen mjete buxhetori për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, kjo autostradë nuk parashihet të ndërtohet me para buxhetore, por se Qeveria tani më ka aplikuar për sigurimin e mjeteve financiare nga IPA fondet për ndërtimin e këtij aksi rrugor

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 2 nëntor - Me Buxhetin e vitit 2018 nuk do të parashihen mjete për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, por vetëm 3 milionë euro për sanimin e këtij aksi rrugor. Edhe pse pas rishikimit të buxhetit të viti 2017, Ministria e Financave u zotua se më Buxhetin e vitit 2018 do të parashihen mjete buxhetori për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, pasi me rishikim janë paraparë mjete financiare për përgatitjen e dokumentacionit final, gjegjësisht projektit të ri. Në pyetjen se pse autostrada Shkup - Bllacë nuk parashihet të ndërtohet me para buxhetore, ministri i Financave, Dragan Tevdovski, u përgjigj se Qeveria tani më ka aplikuar për sigurimin e mjeteve financiare nga IPA Fondet për ndërtimin e këtij aksi rrugor.

“Në mënyrë aktive punohet në sigurimin e dokumentacionit të ri për ndërtimin e këtij aksi rrugor. Vitin e ardhshëm me siguri se do të kemi dokumentacionin final dhe nëse shkon sipas planit, në gjysmën e dytë të vitit 2019 do të punohet në gjetjen e mjeteve financiare përmes donatorëve apo kreditorëve ndërkombëtar. Qeveria tani më ka aplikuar për sigurimin e mjeteve financiare nga IPA fondet për ndërtimin e këtij aksi rrugor. E gjithë kjo tregon se ekziston mundësia që ndërtimi i kësaj autostrade të fillojë në gjysmën e dytë të viti 2019. Kjo autostradë është përfshirë edhe në Programin e Qeverisë së Maqedonisë dhe pasi të sigurojmë mjetet e mjaftueshme financiare nga IPA fondet, do të fillojnë menjëherë punimet në terren për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë”.

Propozim-Buxheti në debat publik

Ndryshe, ministri i Financave Tevdovski, tha se për herë të parë Propozim-buxhetin për vitin 2018 e prezantoi para përfaqësuesve të mediave, ndërsa paralajmëroi se gjatë 10 ditëve në vijim Propozim-buxheti do të prezantohet



QEVERIA RRIK AKCIZËN E NAFTËS PËR 3 DENARË

Qeveria e Republikës së Maqedonisë nga 1 janari i vitit të ardhshëm planifikon të rrisë akcizën e naftës për tre denarë. Ministri i Financave të Republikës së Maqedonisë, Dragan Tevdovski në debatin e sotëm publik duke prezantuar propozim-buxhetin për vitin 2017 tha se me rritjen e akcizës dhe TVSH-së (tatimi i vlerës së shtuar) çmimi i dizelit do të jetë më i lartë për 3.5 denarë. Sipas tij, arsyeja për rritjen e akcizës janë rekomandimet e BE-së për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe zvogëlimin e ndotjes. Siç theksoi ai, me këtë rritje çmimi i naftës në Maqedoni do të jetë më i ulët krahasuar me rajonin. Efekti i prituri i rritjes së akcizës në Buxhetin për vitin 2018 të cilin sot e prezantoi në Ministrinë e Financave do të jetë 1.6 miliardë denarë, ndërsa nga TVSH-ja 350 milionë denarë dhe me këtë do të ketë të ardhura shtesë për Ndërmarrjen Publike për Rrugë Shtetërore.

edhe para ekspertëve, organizatave joqeveritare, organizatave qytetare si dhe Odave Ekonomike të Maqedonisë para se të shkojë për miratim në seancë qeveritare me 15 nëntor.

“Për herë të parë, Propozim-buxheti i Maqedonisë, para se i njëjti të miratohet nga Qeveria, prezantohet para përfaqësuesve të mediave dhe ditëve në vijim do të hapet debat me organizatat e joqeveritare, organizatat qytetare, me përfaqësues të odave ekonomike dhe secili mund të japë vërejtjet apo të japë propozime rreth projekteve të Buxhetit për vitin 2018”, tha Tevdovski. Ministri Tevdovski gjatë prezantimit të Buxhetit për vitin 2018, para media informoi se Buxheti i viti të ardhshëm është projektuar në 211,7 miliardë denarë ose 3,44 miliardë euro.

“Të ardhurat janë planifikuar në 193,5 miliardë, ndërsa deficiti buxhetor në 18,2 miliardë denarë ose 2,7 për qind nga BPV-ja. Për të ardhura kapitale

janë paraparë 24,7 miliardë denarë, ndërsa në Buxhetin e propozuar ka mjete edhe për paga më të larta në arsim, shëndetësi si dhe rritje të pensioneve, gjegjësisht harmonizim i tyre me shpenzimet për jetesë”, tha Tevdovski.

Ministri Tevdovski njëherit tha se Propozim-buxheti që nga e marta është lëshuar për debat publik. Shpenzimet janë për 4,1 për qind më të larta nga ato në vitin 2017, ndërsa të ardhurat për 4,7 për qind.

“Është planifikuar konsolidim gradual fiskal, i cili shihet edhe nga ajo se deficiti i planifikuar për vitin e ardhshëm, është më i ulët për 0,2 për qind nga ai në vitin 2017, i cili është paraparë në 2,9 për qind. Në afat të mesëm, është planifikuar konsolidim gradual fiskal, gjegjësisht kontroll i ashpër i shpenzimeve më pak produktive, njëkohësisht sigurim i shumës së konsiderueshme të investimeve kapitale për mbështetjen e ekonomisë vendore”, tha ministri Tevdovski, duke shtuar se deficiti buxhetor do të financohet nga burime vendore dhe të jashtme, varësisht nga kushtet e tregut.

stri Tevdovski, duke shtuar se deficiti buxhetor do të financohet nga burime vendore dhe të jashtme, varësisht nga kushtet e tregut.

“Pjesa më e madhe e shpenzimeve janë të dedikuara për pensione, mbrojtje sociale dhe të fëmijëve me 32 për qind nga shpenzimet e përgjithshme, 19 për qind janë të dedikuara për zhvillimin ekonomik dhe punën financiare, 14 për qind për shëndetësi, 11 për qind për arsim, shkencë dhe sport, nga 5 për qind për ndërtimtar, transport, komunikim dhe ekologji, bujqësi dhe rend publik dhe siguri, 3 për qind për mbrojtje, nga 2 për qind për punë të jashtme dhe BE integrim dhe kulturë dhe nga 1 për qind për gjyqësi dhe zhvillim rajonal”, tha ministri Tevdovski.

Me Propozim buxhetin për vitin 2018 pagat janë projektuar në 27,1 miliardë denarë dhe ka rritje prej 460 milionë denarë për shkak të pagave më të larta për të gjithë pjesë-

tarët e ARM-së, punësimet të reja në kopshtet për fëmijë si dhe rritjes së pagave në shëndetësi, arsim dhe kopshte për 5 për qind, e cila është planifikuar me pagën e shtatorit në vitin 2018.

“Te shpenzimet kapitale është planifikuar rritje prej 1,3 miliardë denarë më shumë në krahasim me ribalancin nga viti 2017. Gjithashtu është planifikuar intensifikim i të gjitha aktiviteteve në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, infrastrukturën komunale dhe energjetike, investime në shëndetësi, arsim dhe mbrojtje të fëmijëve, ndërsa posaçërisht janë rritur mjetet për mbrojtje. Në suaza të shpenzimeve kapitale janë planifikuar mjetet për përfundimin e aksit rrugor Demir Kapi - Smokvicë, rikonstruimi i Korridorit 10, ndërtimi i binarëve hekurudhor nga Korridori 8, rindërtimi i hekurudhës Manastir-Kremenice dhe ndërtimi i sektorit rrugor Gradsko-Drenovë, për të cilën gjithsej janë planifikuar 3,5 miliardë denarë. Për infrastrukturën komunale janë planifikuar 5,9 miliardë denarë për ndërtim të sistemit kombëtar gaz-përçues, për ujësjellës dhe kanalizime, stacione fil-truese dhe zhvillim të barabartë rajonal. Për investime në ZZHTI janë planifikuar 431 milionë.

Nuk ndryshohet shkalla e kontributeve sociale

“Për ndërtimin e kopshteve për fëmijë, objekteve sportive, shkollave fillore dhe të mesme, universiteteve dhe konvikteve studentore janë planifikuar 2,4 për qind miliardë denarë, për investime në shëndetësi 1,9 miliardë denarë, për investime në mbrojtje një miliardë denarë, në gjyqësi 531 milionë denarë dhe për rend publik dhe siguri 917 milionë denarë”, tha Tevdovski. Ministri Tevdovski njëherit paralajmëroi se shkalla e kontributeve sociale nuk do të mund të ndryshohet, ndryshim do të ketë vetëm te ata punëtorë që marrin prapues të paga më të larta, te të cilët do të rritet tatimi personal prej 12 në 16 për qind nga vlera e paga mesatare.

“Kthimi i TVSH-së ndaj firmave, edhe më tej do të jetë i rregullt dhe jodiskriminues, duke theksuar se në shtator është bërë kthesë prej 2 miliardë denarë. Për mallra dhe shërbime janë paraparë 17,2 miliardë denarë dhe ato janë

më të ulëta për 420 milionë denarë, gjegjësisht për 2,4 për qind në krahasim me projektimin për vitin 2017”, tha Tevdovski.

Ndërsa sa i përket ndryshimeve tatimore, Tevdovski tha se nga janari i vitit 2018 do të rritet akciza për derivatet e naftës për 3 denarë, ndërsa tatimi progresiv do të zbatohet nga vitin 2019. Në debatin publik për Propozim buxhetin për vitin 2018, që u mbajt në hapësirat e Ministrisë së Financave, morën pjesë përfaqësues të odave ekonomike, sindikatave, sektorit joqeveritar dhe institucioneve ndërkombëtare financiare prezent në Maqedoni. Sektori i biznesit kërkoi zbatim të mirë të tatimit progresiv, që kompanitë të jenë të gatshme për zbatimin e tij. Sindikatat u zotuan për rritje të pagave dhe pagesës së K-15, ndërsa sektori joqeveritar për realizimin e të ardhurave kapitale. Ministrit Tevdovski u shpreh se pikërisht në drejtim të gatishmërisë së mirë tatimi progresiv do të fillojë në vitin 2019, ndërsa sa i përket rritjes së pagave minimale tashmë po ndërmerrn masa për rritjen e nivelit të përgjithshëm të pagave me rritje të pagës minimale, ndërsa vitin e ardhshëm do të ketë rritje në atë që bazohet shoqëria, gjegjësisht në arsim dhe shëndetësi. Sipas ministrit Tevdovskit me rritjen ekonomike do të kontribuohet edhe drejt rritjes së pagave në të gjithë sektorët, ndërsa sa i përket pagesave të K-15, informoi se nuk janë paraparë mjete në Propozim-buxhetin për vitin 2018, por nëse krijohen kushte mund të bëhet me rishikimin e buxhetit.

SQARIM

Në shkrimin me titull: "Zgjedhjet e parakohshme, sa larg aq edhe afër", në numrin e gazetës më datë 31 tetor, gazeta KOHA ka përvjedhur një gabim teknik, me çrast, deklaratën e analistit politik Alajdin Demiri, e ka shënuar si deklaratë të profesor Denko Malevski. Me këtë rast, redaksia e gazetës KOHA i kërkon ndjesë profesor Malevskit.

BULLGARIA DO TË ULË ÇMIMET E ROAMINGUT ME MAQEDONINË

Gjatë muajve në vijim do të nënshkruhet memorandum ndërqeveritar për uljen e çmimeve në roamingun për vendet nga Ballkani Perëndimor, paralajmëroi sot ministri bullgar i Transportit, Teknologjive Informatike dhe komunikimeve, Ivajlo Moskovski, transmeton BTA. Moskovski po merr pjesë në biznes konferencën "Horizonte logjistike 2025" në Sofje, ku para gazetarëve foli për angazhimet dhe qëllimet e Ministrisë së Transportit, Teknologjive Informatike dhe Komunikimeve gjatë Kryesimit të ardhshëm të Bullgarisë me Këshillin e BE-së. "Nuk mund të kemi çmime prej gjashtë-shtatë levë për minutë me Maqedoninë, me Bosnjë e Hercegovinën apo Serbinë. Këto janë çmime të tmerrshme", deklaroi ministri Moskovski. Theksoi se pret që operatorët të nënshkruajnë marrëveshje deri në fund të vitit.



Shqyrtohen ankesat nga rrethi i dytë zgjedhor



KSHZ refuzoi ankesat e BESËS

Paraprakisht, të gjitha ankesat e Lëvizjes BESA për Çairin, anëtarët e KSHZ vendosën ti akumulojnë në një ankesë të vetme me arsyetimin se të 86 ankesat - kishin për bazë parregullsi të njëjta. Anëtarja e KSHZ-së, Ermira Asani Salija, kërkoi që të hapën kutitë e vendotimeve për Komunën e Çairit me qëllim që të shihen edhe njëherë mbi 1000 fletëvotimet e pavlefshme, por që nuk u mor parasysh nga anëtarët tjetër e KSHZ-së

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 2 nëntor - Të enjten në seancë të veçantë për shqyrtimin e ankesave partiake nga rrethi i dytë zgjedhor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhor ka hedhur poshtë të gjithë 86 ankesat e Lëvizjes BESA për Komunën e Çairit dhe një ankesë për Komunën e Tetovës. Paraprakisht, të gjitha ankesat e Lëvizjes BESA për Çairin, anëtarët e KSHZ vendosën ti akumulojnë në një ankesë të vetme me arsyetimin se të 86 ankesat - kishin për bazë

parregullsi të njëjta. Anëtarja e KSHZ-së, Ermira Asani Salija, kërkoi që të hapën kutitë e vendotimeve për Komunën e Çairit me qëllim që të shihen edhe njëherë mbi 1000 fletëvotimet e pavlefshme, por që nuk u mor parasysh nga anëtarët tjetër e KSHZ-së. Duhet theksuar se përfaqësuesja e Lëvizjes BESA në KSHZ, Ermira Asani Salija votoi njëjtë si të gjithë anëtarët tjerë, duke mos përkrahur gjatë votimit ankesën nga Lëvizja BESA për Komunën e Çairit. Siç theksuan anëtarët e KSHZ-së, në ankesat Lëvizjes BESA nuk kishte të evidentuara në kohë vërejtje në procesverbalet në vendotimet në të cilat kjo parti pretendon se ka pasur parregullsi të ndryshme. "Më duhet të them se ankesat nuk kanë asnjë element bazë që cekën në Kodin Zgjedhor, orën, vullën e personit zyrtar, emrat e atyre që kanë bërë parregullsi..., thjesht kemi mungesë të fakteve dhe nuk mund të marrim si të bazuara juridikisht", tha Subhi Jakupi, anëtar i BDI-së në KSHZ. KSHZ po ashtu gjatë seancës për shqyrtimin e ankesave nga partitë politike për rrethin e dytë zgjedhor hodhi poshtë

edhe një ankesë të Aleancës për Shqiptarët për Komunën e Strugës dhe në një vendotim të fshatit Oktis, ndërsa mbetën për t'u shqyrtuar edhe 12 ankesa tjera të kësaj partie për Komunën e Strugës. Paraprakisht, KSHZ vendosi që të shikohet procesverbal, ndërsa të sille origjinali i deklaratës së anëtarit komunal zgjedhor për Komunën e Strugës, Naser Ilajzi, e vërtetuar tek noteri. Pas shikimit të procesverbalit, anëtarët e KSHZ-së - Subhi Jakupi, Violeta Duma, Sasho Sërcev dhe Subhi Jakupi ndonëse ishin të një mendimi - se ankesa nuk përmban elemente bazë si emri i personit që ka votuar në grup, vërejtja në procesverbal i vëzhguesit partiak dhe vula e personit zyrtar. "Unë nuk mund të them se nuk ka pasur votime në grup, por dëshmitë janë vetëm fjalë që thoni ju këtu, ndërsa mungojnë dëshmitë konkrete. Mirë, anëtarit i Komisionit zonal ka bërë deklaratë meqë nuk janë përfillur vërejtjet e vëzhguesit të partisë suaj nga anëtarët e Komisionit të evidentohet në procesverbal. Por as në deklaratë nuk ka të dhëna për emrat e atyre që, sipas

jush, kanë votuar në grup", tha Sasho Orcev, anëtar i KSHZ-së. ndërsa edhe anëtarja tjetër Violeta Duma, vuri theksin tek mungesa e shënimit të orës kur ka ndodhur votimi në grup dhe dëshmitë tjera që duhet të ishin në procesverbal. "Sipas asaj që kemi përpara, ne nuk dimë orën kur ka ndodhur votimi në grup, as se kush e ka bërë atë, as nuk kemi dëshmi se janë refuzuar vërejtjet e vëzhguesit, nuk ka këtu ndonjë emër të atyre që kanë votuar në grupi familjar që ti kishin si dëshmitar. Ankesa nuk asnjë bazë juridike për ta pranuar si të vlefshme", tha Violeta Duma. Ndërkohë, Subhi Jakupi në një prononcim të shkurtër për gazetën KOHA thotë se "partitë shqiptare nuk kanë mësuar nga zgjedhjet e parlamentare dhe përsërisin të njëjta gabime kur ankimojnë procesin zgjedhor". Nga Lëvizja BESA dhe nga Aleanca për Shqiptarët kanë paralajmëruar se do të shkojnë në tej me procesin ankimor, duke bërë padi në Gjykatën Administrative, megjithëse përfaqësuesit e këtyre partive në KSHZ thanë se presin të mbarojnë njëherë me ankimet në KSHZ.

Bashkëpunim për progres drejt BE-së dhe NATO-s

Shkup, 2 nëntor - I tërë rajoni duhet të shkojë përpara drejt BE-së dhe NATO-s, por vetëm nëse e avancojmë bashkëpunimin mund t'i realizojmë këto qëllime strategjike, tha kryeministri Zoran Zaev në "Konferencën ekonomike të Malit të Zi 2017 - sfidat në rrugën drejt BE-së" rajonale që po mbahet në Budvë. Në fund, përmendi Zaev, gjithçka reduktohet në ekonomi, madje edhe anëtarësimi ynë në BE dhe NATO. Është me rëndësi bashkëpunimi i suksesshëm me shteteve, sepse vetëm bashkërisht, si treg më i madh ekonomik, mund të jenë më atraktive për ekonominë ndërkombëtare dhe komunitetin e biznesit. "Duhet së bashku të dërgojmë mesazhin në shtetet tona se shumë gjëra varen nga ne. Përmes këmbimit të përvojave, lëvizshmërisë, fuqisë së kualifikuar punëtore, klimës politike të bashkëpunimit, bashkëpunimit të odave, çrrënjosjen e korrupsionit, dërgojmë sinjal të fortë se ky rajon mund të jetë një vend tërheqës për investime", potencoi kryeministri. Ne të gjithë duam, tha, të bëhemi anëtarë të BE-së dhe NATO-s, kryesisht për shkak të cilësisë së jetës së qytetarëve tanë. Të punojmë së bashku drejt këtij qëllimi, apeloj Zaev. Në konferencën ekonomike në Budvë u konstatua se udhëheqësit e vendeve të rajonit takohen për herë të shtatë për disa muaj, gjë që kurrë nuk ka ndodhur më parë. Gjithashtu, vlerësimi se procesi i Berlinit i jep rezultatet, sepse vetëm përmes bashkëpunimit infrastrukturor dhe komunikimit, është e mundur të arrihet një bashkëpunim më aktiv ekonomik, i rëndësishëm për të gjitha vendet e rajonit. E gjithë kjo, konkluduan diskutuesit, kryeministra dhe përfaqësues të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor është një mesazh i rëndësishëm pasi rajoni është i pjekur dhe i vetëdijshëm se vetëm bashkëpunimi i fuqishëm dhe i fortë e sjell më afër ndaj qëllimeve strategjike - BE dhe NATO. Rruga e Ballkanit Perëndimor në BE dhe NATO është e përbashkët, me fqinjët e saj, të dakordohen për pjesëmarrësit e "Konferencës Ekonomike të Malit të Zi 2017 - Sfidat në rrugën drejt BE-së" rajonal, që po mbahet në Budvë.



Hulumtim i profesorëve Tina Frejbuirg dhe Tobias Bohmelt

Maqedonia në BE deri në vitin 2023

Shkup, 2 nëntor - Maqedonia më së shpejti nga vendet-kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian do t'i përmbushë kriteret për hyrje, në vitin 2023. Serbia dhe Turqia këtë do ta bëjnë diçka pas vitit 2030, ndërsa Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina. Këto janë rezultatet nga hulumtimi, të cilin e zbatuar profesoresha e politikës krahasuese e Shkollës për shkencë politike dhe ekonomike pranë Universitetit Sent Galen në Zvicër, Tina Frejbuirg dhe Tobias Bohmelt, profesor

pranë Universitetit në Es-eks. Ata kanë punuar një studim për kapacitetin e vendeve-kandidate që të bëhen anëtarë të Unionit, duke shfrytëzuar model për parashikim për zgjerimin e ardhshëm të BE-së. Në studim është shqyrtuar kapaciteti i kandidatëve që të jenë të komplementuar me BE-aki-t masive (aquis communautaire), në të cilin përmbahen kushtet primare për vijimin e bisedimeve dhe sigurimin përfundimtar të anëtarësisë. Hulumtuesit për parashikim si pikë referi-

mi e kanë marrë rëndësi të zgjerimit nga viti 2004, ndërsa rezultatet treguan se vetëm një vend nga kandidatet aktuale dhe potenciale tërësisht do t'i përmbushë kriteret për hyrje në Union, Maqedonia edhe atë në vitin 2023. Mali i Zi edhe krahas asaj që konsiderohet si vend i Ballkanit Perëndimor, me gjasa të mëdha për hyrje të shpejtë, nuk ka qenë i kyçur në analizë sepse shkak të mungesës së të dhënave. Vendi i fundit, që është kyçur drejt Bashkimit Evropian ishte Kroacia, në vitin 2013.

Pas mungesës disavjeçare nga axhenda e zgjerimit, Ballkani Perëndimor sërish është në fokus, para se gjithash për shkak të krizës së refugjatëve, por edhe si përgjigje e interesit të rritur të Rusisë për këtë pjesë të botës. Edhe derisa Rusia sërish përpigjet të krijojë imazh se mund të ofrojë alternativë për integrim euroatlantik, BE paraprakisht këtë vit e riafirmoi angazhimin e saj për zgjerim drejt Ballkanit Perëndimor me gjashtë vende, të cilave do t'u ndihmojë t'i plotësojnë kërkesat politike dhe

ekonomike për hyrje. Qeveria gjermane e përforcoi Procesin e Berlinit, të njohur si Berlin plus ose Plan Mini Marshall, me qëllim që rajonit t'i jepet nxitje ekonomike, por edhe t'i kompensohet për pritjen e gjatë për anëtarësim në BE. Hulumtuesit thonë se edhe krahas asaj që rruga drejt BE-së është një proces i projektuar paraprakisht i ditur si i rreptë nga aspekti burokratik në raporte me rregullat, që duhet të respektohen, megjithatë ai është i hapur lloj të ndryshëm të ndikimit, të cilët mund ta

ndërrojnë tajmingun e kandidatëve nga Ballkani Perëndimor në lidhje me progresin e tyre.

Faktorët, të cilët mund të sjellin deri në përshejtim të procesit, sipas tyre mund të vijë deri në formë të ndryshimeve politike, si transferi i paradokoshëm i fuqisë në duart e Qeverisë proevropiane të Maqedonisë.

Nga ana tjetër për shembull përkeqësimi i gjendjes së institucioneve demokratike në Turqi mund të shkaktojë ngrirje të procesit të zgjerimit për disa vite.



Mbledhja e përbashkët me Shqipërinë, më 2 dhjetor

Shkup, 2 nëntor - Tema të interesit të përbashkët, me fokus në bisedimet për zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore mes Maqedonisë dhe Bullgarisë do të shqyrtohen në mbledhjen e përbashkët të qeverive të dy vendeve, e cila do të mbahet më 23 nëntor në Strumicë, njoftoi të enjten shërbimi për shtyp i Qeverisë bullgare. Paraprakisht, edhe Qeveria e Maqedonisë, solli vendime për mbledhje të përbashkëta me Bullgarinë, si dhe me Shqipërinë më 2 dhjetor. Mbledhja e dy qeverive do të përfundojë me vendosjen e kurorës me lule në përmendoren e presidentit të Maqedonisë, Boris Trajkovski (1999-2004). Mbledhja e përbashkët është vazhdimësi e dialogut pozitiv dhe partneritetit mes dy vendeve, ceket në kumtesën nga shërbimi për shtyp i Qeverisë bullgare. Mbajtja e mbledhjes së përbashkët ishte dakorduar gjatë vizitës zyrtare të kryeministrit Bojko Borisov në fillim të gushtit, kur u nënshkrua Marrëveshja për miqësi, bashkëpunim dhe fqinjësi të mirë mes dy shteteve.

Shkup, 10 aksidente me gjashtë të lënduar

Shkup, 2 nëntor - Gjashtë persona janë lënduar më lehtë në gjashtë nga gjithsej 10 aksidente trafiku të regjistruara gjatë 24 orëve të fundit në rajonin e SPB Shkup. Në katër janë shkaktuar dëme materiale. Siç informon MPB-ja, gjatë ditës së djeshme policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër më të madh të kundërvajtjeve. Dyzet e dy shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa e lejuara, dy janë shkyçur nga komunikacioni për shkak të vozitjes nën ndikim të alkoolit, gjashtë nuk i kanë respektuar rregullat për tejkalim, dy kanë kaluar në dritë të kuqe të semaforit, ndërsa 16 kanë qenë pa patentë shoferi, gjegjësisht me automjet të paregjistruar. Janë sanksionuar edhe 16 këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë kalimit të shënuar për këmbësorë, gjegjësisht kanë kaluar në dritë të kuqe të semaforit. Janë sanksionuar 72 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotreci" janë larguar 74 automjete. Në kuadër të aksionit të edukimit për komunikacion "T'i mbrojmë fëmijët në komunikacion" Sektori për parandalim sot do të realizojë punëtori edukative me nxënësit e klasës së dytë në SHFK "Kole Nedellkovski", e cila ndodhet në rajonin e komunës Qendër.


Me këtë dokument që tani më është në fazën e propozim tekstit, janë përfshirë të gjitha nivelet e shkollimit konvencional dhe jo konvencional, ndërsa janë përfshirë propozimet e dala nga diskutimi me grupet punuese. Të arsimit i mesëm, për shembull, janë evidentuar 10 çështje të cilat shënojnë edhe pikat sfiduese të Strategjisë, respektivisht politikave arsimore në të ardhmen

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 2 nëntor - Kanë mbetur vetëm edhe një javë nga afati deri kur mund të paraqiten vërejtjet dhe sugjerimet për ndryshimin e sistemit arsimor në Maqedoni. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka caktuar datë 10 nëntor, si kohën e fundit kur të gjithë të interesuarit mund të shkruajnë në adresën elektronike "komentuari@mon.gov.mk" ose në arkivin e MASH-it propozimet për reformën në arsim. Paraprakisht, MASH u angazhuan për përpilimin e Strategjisë Gjithëpërfshirëse të Arsimit 2018-2025, i cili do të shërbejë si dokument bazë, mbi të cilin do të mbështeten politikat arsimore për tetë vite të ardhshme. Në të njëjtën kohë, MASH bën të ditur se dokumenti është konsultuar edhe me ekspertë dhe akademikë, për "të vënë në

MASH vazhdon aksionin për reforma në arsim

Propozimet deri në 10 nëntor



pah rëndësinë" sikurse thonë ata, si dhe "duke dashur të ndjekin parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirës", ndërsa Strategjia Gjithëpërfshirëse e Arsimit (2018-2025) do të kalojë edhe në debat publik para se i njëjti ti dërgohet Qeverisë për miratim.

Me këtë dokument që tani më është në fazën e propozim tekstit, janë përfshirë të gjitha nivelet e shkollimit konvencional dhe jo konvencional, ndërsa janë përfshirë propozimet e dala nga diskutimi me grupet punuese. Të arsimit i mesëm, për shembull, janë evidentuar 10 çështje të cilat shënojnë edhe pikat sfiduese të Strategjisë, respektivisht politikave arsimore në të ardhmen. Përveç problemit në mbingarkesën e programeve mësimore, korrëgjimin e libra, aty përmendet edhe mos pasqyrimi në aktivitete mësimore dhe jashtë mësimore i arsimit ndërkulturor, si dhe disproporcioni në ndarjen e shkollave apo edhe të shërbimeve profesionale.

"Mësimdhënësit nuk marrin trajnim të duhur praktik gjatë trajnimit fillestar ose praktikës; nuk ka profesionalizëm dhe neutralitet politik të drejtë të shkollave; shërbimet profesionale nuk janë të ekipuara sipas nevojave të shkollave (p.sh. sipas numrit të nxënësve, gjuhës në të cilën zhvillohen mësimet)", thuhet në këtë pikë. Ndërkaq, çështja e shërbimeve pedagogjike, sikurse plotësohet më tej, është edhe faktor për cilësinë e ulët, apo të paktën për gamën e kufizuar të shërbimeve pedagogjike, si këshillimi për karrierë ose udhëzime për nxitjen e talentit të nxënësve.

Në vërejtjet për arsimin multikulturor, thuhet se "ka pengesa që ndalojnë integrimin e nxënësve, të cilët mësojnë në një gjuhë tjetër përveç gjuhës amtare". Konkretisht, nxënësit ndahen në ndërrime, varësisht gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, edhe atë ka raste kur ndarjet bëhen në ndërtesa të veçanta dhe me administratë të veçantë.

"Në të njëjtën kohë, motivimi i shkollave dhe mësuesve për të siguruar integrimin ndëretnik dhe arsimin gjithëpërfshirës është shumë i ulët, për shkak të mungesës së motivimit apo mbështetjes financiare", qëndron në dokumentin e Strategjia Gjithëpërfshirëse e Arsimit (2018-2025). Vërejtjet vijojnë me çështjen e vlerësimit të cilësisë së kurrikulës dhe programit mësimor si dhe me vlerësimin e nxënësve, të cilët sikurse qëndron në dokument "nuk janë konsistente në kuptim të të gjithë faktorëve relevantë". Nuk janë gjithashtu koherente as reformat në fushën e arsimit të mesëm pasi nuk janë gjithmonë në përputhje me reformat në arsimin fillor, kurse mbetet në nivele të pakënaqshme mbështetja e nxënësve për pjesëmarrje, sikurse thuhet demokratike në shkollë, ashtu sikurse mungon informacioni i vazhdueshëm dhe i vlefshëm për sistemin arsimor kombëtar në perspektivat ndërkombëtare.

Ministria e Kulturës nis me emërimet

Javën tjetër në komisione ulen anëtarë të rinj

Nga Ministria e Kulturës nuk jepen hollësi lidhur me shkarkimet dhe emërimet e reja, që gjithsesi janë paralajmëruar disa muaj më parë, si pjesë e ndryshimeve dhe reformave brenda institucionale, por edhe e kriterëve të reja dhe transformimeve që ka pësuar vetë konkursi vjetor

Koha Evis HALILI

Shkup, 2 nëntor - Emrat e anëtarëve të rinj të komisioneve në Ministrinë e Kulturës, të cilët do të

merren me shqyrtimin e projekteve të Konkursit për programin vjetor do të mësohen javën e ardhshme. Edhe pse jozyrtarisht në opinion qarkullojnë emra që do të zëvendësojnë anëtarët aktualë, nga Ministria e Kulturës thonë se javën e ardhshme, kur të mbyllet edhe procesi i zgjedhjeve lokale, do të bëhen publike ndryshimet eventuale në të shtatë komisionet, atë të Arteve vizuale, arkitekturë dhe dizajn; Folklor muzikë dhe aktivitet skenik-muzikor; Dramatik; Literaturë dhe veprimtari botuese; Projektet interdisiplinare; Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe Veprimtaria

ndërkombëtare. Po ashtu, nga ky institucion nuk jepen hollësi lidhur me shkarkimet dhe emërimet e reja, që gjithsesi janë paralajmëruar disa muaj më parë, si pjesë e ndryshimeve dhe reformave brenda institucionale, por edhe e kriterëve të reja dhe transformimeve që ka pësuar vetë konkursi vjetor.

"Se çfarë ndryshimesh do të ketë do të publikohen javën e ardhshme, me përfundimin e procesit zgjedhës, atëherë kur edhe ligjërisht mundësohen emërimet dhe shkarkimet", thonë nga Ministria e Kulturës. Sa i takon anëtarëve shqiptarë në këto komisione do të

ketë sërish ndryshime, edhe pse një pjesë janë emëruar vitin e kaluar. Si komisione ku nuk do të ketë lëvizje janë ato të Botimit dhe Muzika, ndërsa në komisionet e tjera do të përzgjidhen anëtarë të rinj. Anëtarët e komisioneve për disa vjet me radhë nuk kanë lëvizur nga posti, madje një pjesë prej tyre e kanë vazhduar disa herë mandatin dy vjeçar. Shkarkimet e dy viteve të fundit dhe qarkullimi i një pjese nga një komision në tjetrin janë lidhur me vërejtjet që janë bërë lidhur me rezultatet e konkursit, numri i projekteve dhe ajo që vazhdimisht është problematike buxheti i vogël që

është vënë në dispozicion të projekteve shqiptare, krahasuar me të tjera, sidomos në muzikë, por edhe botime.

Konkursi për financimin e projekteve me interes nacional në kulturë për vitin e ardhshëm do të mbyllet pas dy javësh. Pas gati dhjetë vitesh ky konkurs, kriteret dhe kushtet e konkurimit kanë ndryshuar me qëllim unifikimin dhe thjeshtëzimin e tij dhe për t'u përshtatur nevojave dhe kërkesave të atyre që merren me kulturë. Për këtë arsye Ministria e Kulturës që prej shpalljes së Konkursit, një muaj më parë ka organizuar disa sesione informative ku

përfaqësues të këtij institucioni japin instruksione për formën e drejtë të aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe plotësimin e tyre në të shtatë veprimtaritë. Në konkursin e sivjetshëm, rezultatet e të cilit do të shpallen në fund të muajit dhjetor, pritet të ketë numër më të vogël projekteve që do të realizohen, por sipas deklaratimeve të kreut të këtij institucioni, Robert Allagjovki, kriteri bazë do të jetë cilësia dhe jo arritja e përqindjeve. Po ashtu edhe prioritet kanë ndryshuar, si në sektorin e muzikës, ku projektet që lidhen me folklorin po ashtu vendosen në plan të dytë.



Përfundoi procesi gjyqësor për "Lagjen e Trimave"

746 vjet burg për "Grupin e Kumanovës"

Shqiptimin e aktgjyqimeve për të akuzuarit e "Lagjes së Trimave", gjykatësja Verka Petrovska, të enjten e ka bërë në mungesë shumicës së të akuzuarve. Duke e pasur parasysh aktakuzën e ngritur nga Prokuroria, e mbështetur në veprat penale "organizatë terroriste" dhe "terrorizëm", Trupi gjyqësor të enjten 26 të akuzuar nga "Grupi i Kumanovës" i dënoi me 746 vjet heqje lire, shtatë prej tyre me burg të përjetshëm dhe katër të akuzuar në mungesë provave u lirua nga akuzat

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 2 nëntor - Nën brohoritje "Kjo është tokë e Shqipërisë" dhe "UÇK, UÇK", duke kënduar himnin kombëtar dhe këngë patriotike siç është "Besa Besë", 37 të akuzuarit e "Grupit të Kumanovës", të enjten e bojkotuan seancën gjyqësore në të cilën Këshilli penal i shqiptoi aktgjykimet përfundimtare. Ashtu si shumë herë deri më tani, i akuzuari Shefqet Hallaçi, të cilët gjykata e dënoi me 40 vite burg, ishte i pari i cili u ngrit dhe tha se nuk e pranon asnjë vendim nga Këshilli penal i kryesuar nga gjykatësja Verka Petrovska. Reagimit të tij për njëherë iu bashkëngjiten edhe të akuzuarit tjerë, të cilët vazhduan me brohoritje kombëtare, me çka i akuzuari Demë Shehu, tha se shteti i Maqedonisë asnjëherë nuk do të jetë i qetë, dhe se gjaku i dëshmorëve të rënë më 9 maj 2015, çdoherë do t'i ndjek ata pas. Me këtë rast, i akuzuari Valdet Zekaj tha se "Shqipëria një ditë do të



BDI KËMBËNGULË PËR HETIM NDRËKOMBËTAR

Bashkimi Demokratik për Integrim mbetet në qëndrimin e vet për përfshirje të ekspertëve ndërkombëtarë në një hetim gjithëpërfshirës për zbardhjen e të gjitha paqartësive të ndërlidhura me rastin e Kumanovës. Kështu thuhet në një njoftim të BDI-së, ndërsa thuhet se "procesi i gjykimet dhe dëshmitë e protagonistëve nxorën në sipërfaqe dilemat rreth organizatorëve dhe motiveve të këtij rasti të rëndë, prandaj qytetarët kanë nevojë ta kuptojnë të vërtetën e plotë". "Pjesë të dëshmitë si dhe materialeve me të cilat qytetarët kishin mundësi të njoftohen nëpërmjet të mediave aludojnë në përfshirjen e dyshuar edhe të përfaqësuesve zyrtar të institucioneve më të larta të shtetit në komunikim me protagonistët e ngjarjes. Prandaj, ftojme Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe autoritetit e sundimit të së drejtës që të përfshijnë ekspert ndërkombëtarë në hetimin e rastit si dhe të vendosin komunikim dhe bashkëpunim edhe me autoritetit e Kosovës dhe Shqipërisë në shkëmbimin e informacioneve drejt zbardhjes së tërësishme", thuhet në njoftimin e BDI-së.

bëhet, por Maqedonia si shtet asnjëherë nuk do të ekzistojë". Situatën e tensionuar gjykatësja Verka Petrovska tentoi disa herë të vë nën kontroll, megjithatë pas shumë vërejtjeve që të akuzuarit të qetësohet dhe të ulën e t'i dëgjojnë aktgjykimet, ajo dha urdhër që të pjesa e cila rebelohet - të largohet nga salla gjyqësore. Shqiptimin e aktgjyqimeve për të akuzuarit e "Lagjes së Trimave", gjykatësja Petrovska të enjten e ka bërë në mungesë shumicës së të akuzuarve. Duke e pasur parasysh aktakuzën e ngritur nga prokuroria, e mbështetur në veprat penale "organizatë terroriste" dhe "terrorizëm", Trupi gjyqësor të enjten 26 të akuzuar nga "Grupi i Kumanovës" i dënoi me 746 vjet heqje lire, 7 prej tyre me burg të përjetshëm dhe katër të akuzuar në

mungesë provave - u liruan nga akuzat. "Sami Ukshini dënohet me 40 vite burg, Andi Krasniqi me dënim burg të përjetshëm, Demë Shehu me burg të përjetshëm, Qenan Iseni 20 vjet heqje lirie, Fadil Fejzullahu burg të përjetshëm, Irfan Lutfiu 14 vite burg, Fadil Elshani, 20 vjet burg, Esat Kafegjollji 40 vjet burg, Ardian Bujari 40 vjet burg, Shefqet Hallaçi 40 vjet burg, Lirim Demiri 20 vjet burg, Hajrush Abdia 20 vjet burg, Betim Kabashi 20 vjet burg, Genci Sefaj 40 vjet heqje lirie, Lendrit Rustemi 20 vjet burg, Rufki Dogani 40 vjet burg, Nasuf Bekiri burg të përjetshëm, Mirsad Qerimi 20 vjet burg, Bajram Elshani 40 vjet burg, Lirim Krasniqi 40 vjet burg, Sevdail Miftari 40 vjet burg, Fatmir Reçica 40 vjet burg, Beg Bajraj burg të përjetshëm, Fadil Rushitovski burg të përjetshëm, Musadi Pajaziti 13 vjet burg, Ragmi Latifi 18 vjet burg, Seadudin Abdullahu 14 vjet burg dhe Ebiq Aliji 12 vjet heqje lirie", ishin vendimet që i përmendi gjykatësja Petrovska. Mes tjerash, ajo shtoi se në mungesë provave dhe dëshmitë, të cilat i ka propozuar Prokuroria Publike, Ibrahim Murtezani, Fazli Osmani, Besnik Ajdini dhe Besnik Bajrami, lirohen nga akuzat. Avokati mbrojtës i të akuzuarve në rastin "Lagja e Trimave",

Naser Raufi ka theksuar se dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykatës Penale të Shkupit, janë shumë të larta. Sipas tij, në këtë proces gjyqësor nuk janë prezantuar të gjitha provat dhe argumentet, dhe se ekzistojnë dëshmi se ky rast ka qenë i orkestruar nga ana e shërbimeve sekrete të Maqedonisë. "Janë dënime shumë të lartë, ku nga 37 persona, katër janë liruar, ndërsa 7 persona janë dënuar me burg të përjetshëm, kurse të tjerët janë dënuar me dënime të ndryshme edhe atë më vite burgim nga 11 vite e më shumë, po ashtu ka edhe 11 persona që janë dënuar me nga 40 vite heqje lire. Unë prapë ndaj mendim se ky rast është i montuar, ku janë të përfshirë edhe shërbimet sekrete", tha Raufi, avokati mbrojtës i të akuzuarve. Ndryshe, në luftimet e 9 majit nga e "Grupit të Kumanovës" u vranë 9 shtetas të Kosovës, një nga Maqedonia dhe 8 pjesëtarë të forcave policore. Ky proces gjyqësor i filluar në shkurt të vitit të kaluar, gjatë gjithë kohës është shoqëruar me shkelje dhe parregullsi të ndryshme, duke filluar nga mos lejimi i familjarëve të prezantojnë në seancat e para gjyqësore, maltretimet dhe rrahjet që ju bëheshin të akuzuarve gjatë transportit nga burgju për në gjykatë e kështu me radhë.



Kaq shumë policë as në 2001-shin nuk janë parë në Shkup



Forca të shumta të policisë, duke përfshirë këtu të gjitha njësitet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ai Njësi për intervenim të shpejtë, "Alfat" dhe policë të uniformuar, kanë "zbarkuar" sot në Shkup, konkretisht në di-



ametër 1 kilometër rreth Gjykatës Penale të Shkupit, ndërsa po zhvillohet seanca gjyqësore kundër të akuzuarve shqiptarë në rastin "Lagja e Trimave". Të akuzuarit në gjykatë ishin sjellë me helikopter, ndërsa dy helikopterë të tjerë kishin vëzhguar situatën nga larta gjatë



gjithë kohës sa po zhvillohej gjykimi. Ndryshe, shtatë të akuzuar: Demë Shehu, Fadil Fejzullahu, Andi Krasniqi - Komandant Malisheva, Nasuf Beqiri, Valdet Zekaj, Beg Bajraj dhe Fazli Rushitovski janë dënuar me burgim të për-



jetshëm, 26 të tjerë janë dënuar me 746 vjet burg, ndërkohë që janë liruar si të pafajshëm Ibrahim Murtezanin, Besnik Bajramin, Fazli Osmanin dhe Besnik Ajdinin. Me 40 vite burg është dënuar Sami Ukshini - Komandant Sokoli.

IBRUSH IBRAHIMI ËSHTË PERSONI I ARRESTUAR PARA GJYKATËS

Përderisa gazetarët dhe familjarët e të akuzuarve të enjten e prisnin lajmin për aktgjykimin përfundimtar për "Lagjen e Trimave", njësitet policore kanë arritur ta arrestojnë një person, i cili në vete mbante një çantë të zeze dhe brohoriste "hajde gjuani". Sipas të dhënave jozyrtare, personi në fjalë është Ibrush Ibraimi, i cili me një mjet ende të pidentifikuar, kërcënonte policinë para gjykatë.





Presidenti Ivanov në Londër

Nga 1 janari shërbimet e ujit me çmim të rregulluar

Shkup, 2 nëntor - Deri më 15-të nëntor Komisioni Rregullator për Energjetikë do ta përpilojë listën e tarifave për shërbimet e ujit që nga 1 janarit i vitit të ardhshëm do të duhet ta zbatojnë të gjitha ndërmarrjet publike ujësjellës në komunat me mbi 10.000 banorë. Pastaj lihet periudhë ndërmarrjet publike t'i dorëzojnë vërejtjet e tyre eventuale dhe kompetentët të sjellin vendim për çmimet e reja që do të hyjnë në fuqi nga fillimi i vitit të ardhshëm. Me listën e tarifave, që është përpiluar në suaza të projektit "Reforma në sektorin e nivelit qendror, financuar nga Bashkimi Evropian, ndërta implementuar nga shtëpia konsultuese Niras, do të përcaktohet lista mesatare e tatimeve për të cilën ndërmarrjet publike do të mund të paguajnë për ujin e papërpunuar për pije, për ujë për pije dhe për furnizimin me ujë, për mbledhjen dhe largimin e ujërave të zeza dhe për pastrimin e ujërave të zeza për ato komuna ku ka stacione filtruese apo duhet të ndërtohen në vitin 2018. Kompensimi i përgjithshëm që e paguajnë qytetarët për të gjitha listat e tarifave do të jetë në suaza të pragut të qasjes, gjegjësisht jo më shumë se tre për qind nga të ardhurat për person në amvisëri. Nga Komisioni Rregullator thonë se ata i kanë përpiluar të gjitha aktet e nevojshme nënligjore që mundësojnë të rregullohen çmimet e shërbimeve të ujit në vend. Komunat me mbi 10.000 banorë tashmë kanë aplikuar në Komisionin Rregullator për çmim, ndërsa ato me numër më të vogël të banorëve do të duhet të aplikojnë gjatë vitit 2018, ndërsa nga 1 janari i vitit 2019 të fillojnë të shesin shërbime ujore me çmime të rregullta. Në pajtim me Ligjin për energjetikë, Komisionit Rregullator nga 1 janari i vitit të ardhshëm është kompetent edhe për formimin e çmimeve të shërbimeve ujore në vend. Komisioni Rregullator është i obliguar të sjell vendim me një sërë çmimesh, gjegjësisht të konfirmohet çmimorja mesatare, maksimale dhe minimale, ndërsa çmimi sipas të cilës shitet uji do të konfirmojnë këshillat e komunave apo Qeverive për kompanitë të cilat kanë për obligim të prodhojnë ujë të papërpunuar për pije. Periudha e rregulluar në pajtim me rregulloren dhe metodologjinë për konfirmimin e çmimeve është tre vjet.

Kriza e emigrantëve, BE nuk është Evropë pa Ballkanin e integruar

"Derisa Ballkani nuk hyn në BE, BE-ja do të përballlet me këtë që ne e kemi tani. Mësuam se në BE shërbimet e sigurisë nuk kanë besim mes vete. Nuk i ndajnë informacionet dhe nuk ekzistojnë ndërgjegjësimit se ekzistojnë kërcënim i përbashkët", tha Ivanov në fjalimin në Institutin mbretëror për marrëdhënie ndërkombëtare "Çatan Haus" në Londër



Shkup, 2 nëntor - Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, në fjalimin në Institutin mbretëror për marrëdhënie ndërkombëtare "Çatan Haus" në Londër, porosi se Bashkimi Evropian duhet të gjejë një mënyrë të re të marrjes së vendimeve gjatë krizës dhe potencoi se vendet evropiane duhet të kenë ndërgjegjësimit më të madh për kërcënimet e përbashkëta të sigurisë. "Ballkani, për fat të keq mbetet jashtë BE-së. Kjo përvojë me krizën e emigrantëve është një mësim deri të burokracia evropiane të kuptojë se BE-ja ende nuk është Evropë dhe nuk mund të flasë në emër të Evropës. Ballkani ende nuk është pjesë e Bashkimit Evropian. Dhe derisa Ballkani nuk hyn në BE, BE-ja do të përballlet me këtë që ne e kemi tani. Mësuam se në BE shërbimet e sigurisë nuk kanë besim mes vete. Nuk i ndajnë informacionet dhe nuk ekzistojnë

ndërgjegjësimit se ekzistojnë kërcënim i përbashkët", tha Ivanov në fjalimin në temën "Maqedonia, migrimet dhe siguria: leksione të mësuara". Terrorizmi, shtoi presidenti, nuk është ai i cili ka qenë në vitet e 60-ta, të 70-ta. Terrorizmi i shfrytëzoi të gjitha teknologjitë e reja, rrjetet sociale, shfrytëzoi madje lidhjet e koduara satelitore dhe çdo herë është më përpara se cila do polici ose shërbim i zbulimit. "Të lënë vetë, si shtet ne pamë se duhet t'i ndërmarrim gjërat në duart tona. Maqedonia në mënyrë më të suksesshme përballlet me emigrantët. Aq sa ka mundur, iu ka ndihmuar të gjithëve. Shumë lehtë është të kritikosh nga pozita neutrale, pa pasur përgjegjësi për pasojat nga e gjithë kjo që ka ndodhur gjatë krizës së emigrantëve", porosi-

ti presidenti i Republikës së Maqedonisë. Duke folur për aspektin e sigurisë së krizës, Ivanov theksoi se edhe pse ruta ballkanike e emigrantëve është e mbyllur, migrimi i paligjshëm ende nuk është penguar dhe se rrjetet e trafikimit kriminal kanë rol të rëndësishëm në gjenerimin e kërcënimeve të sigurisë për Maqedoninë dhe Evropën. Ivanov para të pranishmëve në "Çatan Haus" e sqaroi planin me të cilin, siç tha, Maqedonia arrin ta rregullojë valën e emigrantëve me një hyrje dhe një dalje. "U tregua se kriza nuk mund të zgjidhet vetëm me deklarime politike dhe procedura burokratike, por duhet të menaxhohet me ndihmë dhe mbështetje edhe nga ana e shërbimeve të sigurisë dhe strukturave të armatës", theksoi presidenti i Maqedonisë.

Ivanov shtoi se këtë përvojë, më vonë e kanë pranuar edhe vendet e tjera nga Ruta ballkanike dhe armata ka qenë ajo e cila i ka ndihmuar policisë në kontrollin dhe rregullimin, me çka në pranverë të vitit 2016, Ruta ballkanike u mbyll. Presidenti i Maqedonisë theksoi se migrimet nuk kanë përfunduar, sepse në afërsi të drejtëpërdrejtë të kufijve të jashtme të Evropës gjinden midis 20 dhe 30 milionë emigrantë potencialë. Konstatoi edhe se shteteve ballkanike iu është e nevojshme Bashkim Evropian, sepse njerëzit thjeshtë dëshirojnë siguri ligjore. Në kuadër të vizitës së punës në Britani të Madhe, presidenti i Maqedonisë mbajti fjalim në Unionin prestigjioz të Oksfordit dhe realizoi takime me kryetarët e dy dhomave të parlamentit britanik.

Rritet numri i të prekurve nga gripi, për një javë 63 raste të reja

Shkup, 2 nëntor - Javën e kaluar (prej 23 deri më 29 tetor) janë regjistruar 63 raste të reja të të prekurve nga gripi, që është rritje për 40 për qind në raport me javën paraprake (prej më 16 deri më 22 tetor), thuhet në raportin e Institutit për Shëndet Publik të Republikës së Maqedonisë të publikuar sot në ueb faqen e saj. Në krahasim me numrin e rasteve të regjistruara në periudhën e njëjtë sezonin e kalu-

ar, shënohet rritje prej 46.5 për qind. Gjatë kësaj jave, janë paraqitur persona të prekur prej nëntë njësiteve raportuese. Numri më i madh janë regjistruar në Njësinë rajonale Gostivar - 36 persona të prekur. Incidencë e lartë gjithashtu është vërejtur në NJR Gostivar - 30.1, në 100.000 banorë, ndërsa më e ulët në QSHP Prilep - 1.1 në 100.000 banorë. Numri më i madh i të prekurve nga gripi

këtë javë janë paraqitur në grupmoshën e cila e përfshin pjesën më të madhe të popullatës (prej 15-64 vjeç) - 39 raste (61.9 për qind), ndërsa incidencë më të lartë (6,1 në 100.000 banorë) u regjistrua tek personat mbi 65 vjeç, ku gjithsej janë paraqitur 16 të prekur. Në sezonin 2017/2018 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripi është 123, që është për 28.1 për qind më pak në

krahasim me periudhën e njëjtë vitin e kaluar kur janë regjistruar 171 persona të prekur. Sipas raporteve të aritura nga qendrat për shëndet publik/njësi rajonale, 25.171 persona janë vaksinuar së bashku me javën e kaluar (prej 23 deri më 29 tetor) në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe janë harxhuar 89.9 për qind e numrit të përgjithshëm të vaksinave të furnizuara.

Osmani priti në takim ambasadorin e Spanjës

Ballkani në BE sjellë stabilitet për gjithë rajonin

Shkup, 2 nëntor - Vlerësoj shumë mbështetjen e Spanjës për aspiratat euro-atlantike dhe për fillimin e bisedimeve aderuese të Maqedonisë, si dhe qëndrimin e përgjithshëm të Spanjës për mbështetjen e zgjerimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, e cila do të sjellë stabilitet në gjithë rajonin dhe do të hapë dyert e bashkëpunimit në më shumë fusha që secila është në interes edhe të mbajtjen së stabilitetit në gjithë Evropën. Këtë e

theksoi zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i angazhuar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani në takimin e djeshëm me ambasadorin e porsaemëruar të Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Maqedonisë, Emilio Lorenzo Sera. Siç bëri të ditur Sekretariati për Çështje Evropiane, Osmani ka shprehur kënaqësinë nga bashkëpunimi bilateral mes Maqedonisë dhe Spanjës dhe me ambasadorin ranë dakord se është e nevojës

që në periudhën e ardhshme të punojnë në përforcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm mes dy vendeve në më shumë nivele, me intensifikimin e vizitave në nivel të lartë, por mbetet e hapur mundësia edhe për ndihmën bilaterale nga Spanja. Në takim zëvendëskryeministri Osmani informoi ambasadorin Sera lidhur me procesin reformues për integrimin evropian të vendit. "Zgjedhjet e lira, të drejta dhe kredibile lokale,

paraqesin kurorë të pjesës 3 të Planit 3-6-9, në veçanti duke pasur parasysh faktin se pjesa më e madhe e masave të parapara në këtë pjesë ishin në drejtim të zbatimit të zgjedhjeve të lira të drejta dhe kredibile lokale. Këto konkluzat për zgjedhje u konfirmuan edhe nga ana e misionit ndërkombëtar OSBE/ODIHR, si dhe nga të gjitha vëzhguesit tjerë ndërkombëtar dhe vendor", ka theksuar Osmani, thuhet në kumtesën e SÇE.





Sa fitojnë bankat nga qytetarët

Për 6 muaj, 210 milionë euro nga kamatat dhe provizionet

Nga të dhënat zyrtare të BPM-së, mund të konstatojmë se vetëm për 6 muajt e parë të këtij viti, nga kamatat dhe provizionet, bankat vendore kanë realizuar të hyra totale në vlerë prej 210 milionë euro apo vetëm nga kamatat kanë realizuar të hyra prej 161 milionë euro, ndërsa 49 milionë euro janë të hyra nga provizionet dhe kompensimet



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 2 nëntor - Pagesa vjetore e anëtarësisë për llogarinë transaksionale apo kartela kreditore, pagesa e faturës energjetike, ujit, ngrohjes, pagesat për bllokim apo deblokim të llogarisë transaksionale me urdhër të përmbaruesve, kamata plus, për saldo minus në kartelë, janë pagesa shtesë që qytetarët e Maqedonisë ua paguajnë bankave si shërbime ditore. Këto janë vetëm një pjesë e provizioneve, të cilat bankat ua paguajnë klientëve të tyre si harxhime plotësuese, e për të cilat ankohen qytetarët. Edhe pse provizionet që bankat paguajnë për pagesa të faturave komunale për klientët nuk janë edhe aq të larta dhe sillen nga 30 denarë deri më 100 denarë, këto para si kompensim apo provizion që merren, bankave ju sjellin përfitime të larta. Nëse marrim shembull taksën radiodifuzive për vitin e kaluar, të cilën ishin të obliguar ta pa-

guanin rreth 650.000 amvisëri dhe rreth 70.000 mijë firma, nga provizioni, brenda një muaji, vetëm për këtë shërbim bankat inkasuan 13.6 milionë denarë ose 225.000 euro apo brenda një viti kalendarik rreth 1.7 milionë euro.

Nga Banka Popullore e Maqedonisë (BPM) informojnë se vlerën e provizioneve që marrin bankat nga klientët për pagesa bankare apo transaksionet bankar, e përcaktojnë vetë bankat dhe në nivel vjetor e përbëjnë një të tretën e të hyrave totale dhe fitimeve të bankave. Nga të dhënat zyrtare të BPM-së, mund të konstatojmë se vetëm për 6 muajt e parë të këtij viti, nga kamatat dhe provizionet, bankat vendore kanë realizuar të hyra totale në vlerë prej 210 milionë euro apo vetëm nga kamatat kanë realizuar të hyra prej 161 milionë euro, ndërsa 49 milionë euro janë të hyra nga provizionet dhe kompensimet, të cilat sipas BPM-së, për 6 muajt e parë fitim i pastër i bankave është 49 milionë euro

vetëm nga provizionet.

Në pyetjen drejtuar bankave komerciale në vend, se sa janë reale provizionet dhe kompensimet që bankat vendore i kanë caktuar, sqarojnë se harxhimet reale që klientët paguajnë për shërbimet bankare, janë caktuar në bazë të kriterëve që e formojnë shumën e provizioneve apo kompensimeve. Sipas tyre, e vetmja mënyrë që klientët të mos paguajnë provizione apo kompensime për pagesat bankare, është që qytetarët shumë pak t'i shfrytëzojnë sportelet e bankave, të tërheqin më pak para kesh nga bankomatet dhe pagesat e faturave komunale apo çdo lloj tjetër të pagesave bankare ta bëjnë përmes e-banking ose bankës elektronike.

"Parametrat për caktimin apo formimin e provizioneve apo kompensimeve janë harxhime real që bankat i bëjnë gjatë kryerjes së shërbimeve të klientëve përmes kontakteve direkte në sportelet e bankave. Mënyra më e mirë që klientët të mos paguajnë provizione apo

kompensime për pagesat bankare, është të fillojnë të përdorin e-banking apo bankën elektronike, e cila u mundëson klientëve të bëjnë çdo lloj pagese bankare përmes internetit dhe për këtë të paguajnë zero provizion apo kompensim", informojnë nga NLB "Tutunska Banka", Shkup. Edhe nga "Komericialna banka", Shkup, thonë se rregullisht i përcjellin lëvizjet ekonomike në tregun bankar në vend dhe në pajtim me resurset që i shfrytëzojnë për zhvillimi dhe mirëmbajtjen e prodhimeve dhe shërbimeve bankare që ata ofrojnë, dhe në bazë të këtyre shërbimeve formojnë dhe çmimin e provizioneve apo kompensimeve.

"Kur bëhet caktimi i provizioneve apo kompensimeve bankare që duhet të paguajnë klientët, si komponentë kryesore për harxhimet merret aspekti i resurseve njerëzore, materiale dhe teknike, harxhimet për përllogaritjen e aktivitetëve pagesore, ndërsa në mënyrë plotësuese merren parasysh edhe aktivitetet promovuese që i realizojnë banka si dhe nevojën që klientët të fillojnë të përdorin kanalet moderne që në të ardhmen të kryejnë pagesa bankare me zero provizion ose kompensim. Pra, preferohet sa ma pak pagesa në mënyrë direkte dhe më para kesh në sportelet e bankave dhe më shumë të shfrytëzohet shërbimi i e-banking apo pagesa elektronike përmes internetit", thonë nga "Komericialna banka", Shkup.

Shkupi ndotet nga djegia e mbeturinave

Shkup, 2 nëntor - Djegia e mbeturinave në ambient të hapur, të cilat përveç ndotjes së ajrit, paraqesin edhe rrezik për sigurinë e qytetarëve, shfrytëzimi i pakontrolluar i lëndëve djegëse të papërshtatshme në shtëpi individuale dhe në instalimet industriale nga kapaciteti më i vogël, të cilët janë nën kompetencë të vetëqeverisjes lokale, konstatoi Inspektorati shtetëror pranë kontrolleve në terren gjatë natës në Shkup të bëra sipas raportimeve të qytetarëve. Inspektorët kanë bërë shumë kontrolle në terren në territorin e komunave të Shkupit, veçanërisht në Karposh, Gjorçe Petrov dhe Gazi Babë. Nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor theksojnë se është i nevojshëm harmonizim i aktivitetëve të inspektorateve lokale dhe shtetërore për përballje më të mirë me këtë problem. "Aktivitetet në terren treguan se ekziston harmonizim i pamjaftueshëm në veprimin e Inspektorateve shtetërore dhe lokale dhe kjo krijon zbrazëtira dhe mungesë të mbulimit të përditshëm të numrit të madh të pikave të nxehta ekologjike. Kjo qartë tregon se që të sigurohet mbrojtje e efikasë në shëndetin dhe mjedisin jetësor është e nevojshme koordinim urgjent i inspektiveve për mjedisin jetësor. Veçanërisht është alarmuese situata në Shkup, ku veprojnë madje tre nivele të inspektorateve (shtetëror, urban dhe komunal), ndërsa rezultati është i pakënaqshëm", tregojnë nga MMJPH. Për këtë qëllim, më 8 nëntor do të mbahet takim koordinues me të cilin do të udhëheq zëvendësministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Jani Makraduli. Në takim do të marrin pjesë përfaqësues të shumë institucioneve kompetentë për mjedisin jetësor në Shkup - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, inspektorati shtetëror, inspektoratet urbane dhe komunale, si dhe të gjithë kryetarët e komunave të Shkupit, të cilët e kanë iniciuar.

54 gazetarë të sulmuar në 5 vite, asnjë sulmues nuk është ndëshkuar!

Shkup, 2 nëntor - Dy nëntori është Dita ndërkombëtare për parandalimin dhe mos dënimin e krimeve kundër gazetarëve. Në Maqedoni pesë vitet e fundit ka pasur 54 sulme ndaj gazetarëve, por asnjë nga kryerësit nuk është ndëshkuar. Sipas të dhënave

që i posedon Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), të marra nga qeveria, nga 54 sulme ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit, vetëm 10 raste kanë parashtruar pesë vepra penale dhe pesë padi. Por, siç potencon kryetari i SHGM-së, Naser Selmani nuk

kanë informata për fatin e atyre proceseve, sepse prokuroria dhe gjyqësori nuk informojnë se deri në cilën fazë kanë arritur lëndët. "Lëndët tjera ose nuk janë hulumtuar fare ose sulmuesit kanë kaluar vetëm me vërejtje të shkruar në letër. Në peri-

udhën e ardhshme do të punojmë me qeverinë e re të krijojnë mekanizëm institucional për dënim dhe dhunë ndaj gazetarëve. Në këtë mekanizëm duhet të marrin pjesë policia, prokuroria dhe gjyqësori", tha Selmani për REL.

Analizë e Qendrës për hulumtime ligjore

Gjykata Kushtetuese e mbyllur për debate

Shkup, 2 nëntor - Gjykata Kushtetuese nga viti 1992, kur është miratuar Rregullorja për punën e saj deri tani ka mbajtur vetëm pesë debate publike me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, edhe pse debati publik është i obligueshëm për të sjellë vendime në lëndët të tilla, në pajtim me rregullat procedurale. Këto janë konkluzionet nga analiza "Dukshmëria e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë gjatë sjelljes së vendimeve me përqendrim të posaçëm kur vendos për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit", i përpiluar nga Qendra për hulumtime ligjore dhe analiza në suaza të projektit katër mujor, i mbështetur nga "Civika Mobiltaa". Në periudhën prej tetorit të vitit 1992 në përfundim me 31 korrikun e vitit 2017 janë mbajtur gjithsej pesë debate publike, që krahasuar me numrat e ra-

donisë gjatë sjelljes së vendimeve me përqendrim të posaçëm kur vendos për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit", i përpiluar nga Qendra për hulumtime ligjore dhe analiza në suaza të projektit katër mujor, i mbështetur nga "Civika Mobiltaa". Në periudhën prej tetorit të vitit 1992 në përfundim me 31 korrikun e vitit 2017 janë mbajtur gjithsej pesë debate publike, që krahasuar me numrat e ra-



portëve vjetore të Gjykatës në sa kërkesa gjithsej ka vepruar Gjykata, do të thotë vetëm në 3,8 për qind, ajo ka mbajtur debat publik. Debat

i parë publik është mbajtur në vitin 2007. Debat publik do të thotë thirrje e palëve në procedurë, avokatit të popullit dhe presencës së ekspertëve. Hulmuesja ligjore Cvetanovska në këtë kontekst e përmendi aktvendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Selmani dhe të tjerë kundër Maqedonisë, në të cilën mes tjerash konfirmohet se Kushtetuesja nuk ka mbajtur debat publik në kërkesë të Selmanit dhe të tjerëve për

mbrojtjen e lirive dhe të drejtave. Konkluzion nga analiza është edhe se qytetari nuk është mjaftueshëm i njohur me kushtet kur mund të kërkohet mbrojtje e lirive dhe të drejtave si dhe me natyrën ligjore të vendimeve të Kushtetues, që si pasojë ka numër të madh të kërkesave të hedhura poshtë. Është vërejtur edhe trend i uljes së kërkesave të parashtruar deri te Kushtetuesja në vitet 2011, 2012 dhe 2013.



28 vjeçarja mbi 10 vite në dializë

Zinepe Iseini apelon për ndihmë

“Kam nevojë për ndihmë dhe kërkoj nga të gjithë ata që kanë mundësi të më ndihmojnë për të kaluar këtë dimër. Deri më tash më kanë ndihmuar shumë dhe unë i falënderoj të gjithë dhe u jam mirënjohëse, sepse edhe ata kanë ndarë nga vetja për të më ndihmuar”, apelon ajo



Koha **Urim HASIPI**

Gostivar, 2 nëntor - Ajo është 28 vjeçe, por gati se 16 vjet radhazi është në terapi me dializë. Zinepe Iseini nga qyteti i Gostivarit që në moshë të vogël ka mbetur jetime dhe është rritur me shumë mundime, duke tejkaluar shumë sfida që jeta i kishte sjellë. Që nga viti 2004, ajo rregullisht merr terapinë me dializë, ndërsa jeton e vetme pa pasur asnjë afër që ta ndihmojë. Deri më tash ka mbijetuar me ndihmën e shumë qytetarëve nga vendi dhe jashtë, duke përballuar varfërinë dhe sëmundjen e saj të veshkave. Ndihmë ka kërkuar në shumë dyer, por gjithmonë kanë qenë të mbyllura, përveç bamirësve të shumtë që kanë pasur mirëkuptim për situatën e saj. Zinepe Iseini, e lindur me 1988 nga Gostivari, vuan nga sëmundja e veshkave. Ajo që nga mosha e saj 16 vjeçare (plot 12 vjet), vuan nga sëmundja e veshkave dhe trajtohet në Spi-

talini e qytetit të Gostivarit, në repartin e hemodializës. Ajo bën dializë 3 herë në javë dhe shpëtim i vetëm është dializa, pra gjendja shëndetësore dhe jeta e saj momentalisht varen nga aparati për dializë dhe ka nevojë për ndihme financiare. “Momentalisht jetoj me një ndihmë prej 2000 denarë në muaj. Kjo nuk më mjafton për nevojat elementare dhe ditore që i nevojiten një njeriu për të jetuar normalisht. Vështirë është se unë jetoj e vetme, në një shtëpi e cila gjatë dimrit pikon nga të gjitha anët”, shprehet Zinepe Iseini. Zinepe

Iseini mbijeton me një ndihmë sociale prej 2000 denarë në muaj, por kjo nuk i mjafton as për të plotësuar nevojat elementare. Ajo është e re, por në fytyrën e saj qëndrojnë shumë rrudha ku qëndrojnë prej saj, flet për nga një vështirësi që aspak nuk është e zakonshme për moshën e saj. Në moshën 15 vjeçare kur ajo ende thurte ëndrrat e rinisë, një e papritur shqetësoi shëndetin e saj, për ta paralajmëruar se nga ai moment, jeta e saj tërësisht do të ndryshonte dhe se vuajtjet sapa kishin filluar. Ajo të freskët e ka kujtimin e hidhur kur një ditë

fillon t'i fryhet trupi, pa ndjerë asnjë dhimbje dhe në momentin që paraqitet për analiza në spital, mjekët konstatojnë se veshkat e saj kishin ndaluar së funksionuari dhe për pasojë, menjëherë i nënshtrohet trajtimit me dializë. Së fundmi, Zinepi po përballet edhe me tension shumë të lartë të gjakut dhe gjë që i ka shkaktuar probleme të shumta në zemër. Por, krahas të gjitha këtyre lajmeve të këqija, fatmirësisht qëndron në faktin se mjekët në Shkup, tashmë kanë gjetur veshkë adekuatë për të kryer transplantin, por në pyetje janë vetëm 25 mijë euro, që ajo përfundimisht të lirohet nga fistullat që kanë shkaktuar dëmtime të shumta në krahët e kësaj 28 vjeçare. Ajo kërkon ndihmë për të mbijetuar në dimrin që afon, sepse në shtëpinë e vjetër ku jeton kushtet nuk i mundësojnë që të ketë një ambient më të ngrohtë.

“Kam nevojë për ndihmë dhe kërkoj nga të gjithë ata që kanë mundësi të më ndihmojnë për të kaluar këtë dimër. Deri më tash më kanë ndihmuar shumë dhe unë i falënderoj të gjithë dhe u jam mirënjohëse, sepse edhe ata kanë ndarë nga vetja për të më ndihmuar”, apelon ajo. Për të ndihmuar Zinepe Iseinin mund të lajmëroheni në numrin e celularit 070 821 757. Ndërsa ndihmat mund t'i dërgoni edhe në xhironlogaritë bankare: Stopanska Banka: 200002485016317 për denarë dhe për euro: MK:07200002223083628 Eu.

Edhe një doktor në sferën e shkencave politike



Shkup, 2 nëntor - Këto ditë në Universitetin e Evropës Juglindore, në fakultetin e Administrimit Publik dhe Shkencave Politike, kandidati Muaz Agushi, me sukses mbrojti tezën e doktoraturës me titull “Zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore në Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë-analizë krahasuese”.

Komisioni në përbërje prej: Prof. Dr. Agni Aliu, kryetar i komisionit, Prof. Dr. Etem Aziri, mentor, Prof. Dr. Bejtush Gashi, Prof. Dr. Elena Andreevska dhe Prof. Dr. Abdulla Azizi, anëtarë të komisionit e vlerësuan lartë punimin e Dr. Muaz Agushit, i cili në mënyrë të hollësishme sjell krahasimin në mes të sistemeve zgjedhore në Maqedoni dhe Shqipëri. Punimi në fjalë, në kapitullin e fundit ilustron me një sërë grafikash dhe tabelash të bazuara nga të dhënat e studimit empirik që është realizuar në këto dy shtete.

Dr. Muaz Agushi, aktualisht është drejtor i Sektorit për Kulturë dhe Shkencë pranë BFI-së. Ka mbaruar SHMI “Medreseja Isa Beu”, ndërsa Fakultetin e Sheriatit dhe Shkencave Islame, në drjetimin Komparacioni i Medhehebeve dhe Politika e Sheriatit në Universitetin e Kuvajtit. Master studimet për diplomaci i mbaroi në Fakultetin e Administrimit Publik dhe Shkencave Politike në Universitetin e Evropës Juglindore, ndërkohë specializimin për Metodikën e mësim-besimit e kreu në USHT.

Xhemaili zyrtarisht kryetar i Komunës së Bogovinës

Tetovë, 2 nëntor-Komisioni Komunal Zgjedhor në Bogovinë të enjten i ka ndarë certifikatën kryetarit të ri të kësaj Komune Albon Xhemaili nga Aleanca për Shqiptarët. Po ashtu edhe ushtruesja e detyrës kryetare e Komunës së Bogovinës, Lumturije Iljazi, ia dorëzoi postin kryetarit të ri, Albon Xhemailit nga Aleanca për Shqiptarët. Kryetari Xhemaili gjatë fjalës së tij përshëndetëse, e falënderoi ushtruesen e detyrës për mikpritjen dhe premtori se do të punojnë shumë për këtë komunë. Ai theksoi se premtimet e dhëna gjatë fushatës do t'i mbajë. Ndër të tjera, Xhemaili



premtori për depolitizimin e administratës dhe arsimit dhe gjithashtu tha se fjalës së tij do t'i qëndrojë deri më të mandatit

të tij. Përndryshe, në zgjedhjet e 15 tetorit, në raundin e parë garuan katër kandidatë, Berzah Bejtullah nga BDI, Elvir Iseni nga PDSH dhe Minur Asani nga Lëvizja Besa. Në raundin e dytë garuan Bejtullah nga BDI-ja dhe Xhemaili nga Aleanca për Shqiptarët. Kandidati i BDI-së mori 5390 vota, ndërsa kandidati i Aleancës 6430 vota. Po ashtu sot certifikatat i kanë marrë edhe 19 këshilltarët e rinj në Këshillin e Komunës së Bogovinës. Në këtë përbërje BDI-ja ka 7 këshilltarë, Aleanca për Shqiptarët 5, Lëvizja Besa 5 këshilltarë dhe dy këshilltarë PDSH-ja. (U.H.)

Ligjëratorë e përfaqësuesit të UNICEF-it, Benjamin Perk

Fëmijët viktimë të dhunës, me mundësi më të mëdha për probleme në jetë

Shkup, 2 nëntor - Fëmijët, të cilët i janë ekspozuar dhunës, kanë vështirësi në mësimin e tyre, zhvillimin social dhe emocional, zhvillimin dhe trurit dhe zhvillimin fizik. Ata kanë edhe mundësi më të madhe të futen në probleme, krim, të zhvillojnë varshmëri. Këto janë një pjesë e pikëpamjeve nga hulumtimet dhe dëshmitë e reja nga neuroshkenca dhe psikologjia me të cilat tregohet lidhshmëri e drejtpërdrejt midis nivelit të përvojave negative në fëmijëri me suksesin në jetën e

të rriturve që në ligjëratorën e së enjtes “Personi i njohur-Dhuna në jetën e fëmijëve dhe adoleshentëve” i ndau përfaqësuesi i UNICEF-it, Benjamin Perks në Fakultetin Filozofik në Shkup. “Ajo çka mund të shihet është se fëmijët të cilët u janë ekspozuar dhunës fizike, familjes disfunktionale, keqpërdorimit emocional, anashkalimit ka më shumë mundësi që të futen në fatkeqësi, probleme, të kenë gjendje më të keqe shëndetësore, të kenë problem me mësimin”,



• Benjamin Perks

thotë Perks. Fëmijët të cilët kanë qenë viktimë të shkallës së lartë të dhunës, ose madje të disa llojeve të dhunës, mund të kenë probleme serioze në

zhvillimin e trurit të tyre, që tërheq probleme serioze në jetën e tyre të mëvonshme. Ata mund të kenë shkallë të lartë të varshmërive, të futen në krime dhe për 50 për qind mundësi më të mëdha të kryejnë vetëvrasje. Në Maqedoni rreth 50 për qind e fëmijëve janë ballafaquar me dhunën. Në korniza botërore, situata nuk është shumë më ndryshe, vetëm një e pesa e fëmijëve asnjëherë nuk janë ballafaquar me ndonjë lloj të dhunës ose traumës në jetë, ndërsa dy

e treta janë të prekur nga dy deri në tre lloje traumash. Profesoresha Alma Tasevska nga Instituti për pedagogji pranë Fakultetit të Filozofisë në Shkup pajtohet me qëndrimin se dhuna në fëmijëri të hershme ka pasoja serioze në jetën e mëtejshme. Për këtë arsye, nevojitet sistem dhe punë me familjet, por edhe ndërtim të kapaciteteve për njohje të hershme të dhunës që të mund të ndërmerren masa të domosdoshme për uljen ose pengimin e saj.



Dogana realizoi të ardhura më të larta për 7.8 për qind

Shkup, 2 nëntor - Drejtorja Doganore e Maqedonisë gjatë 10 muajve të kaluar të vitit i rriti të ardhurat për 7.8 për qind. Të ardhurat e realizuara janë 54.5 miliardë denarë që është për 4.7 miliardë denarë më shumë nga kjo periudhë vitin e kaluar. "Drejtorja Doganore e Republikës së Maqedonisë në 10 muajt e kaluar të këtij viti vazhdoi me realizimin e suksesshëm të pagesës së taksave gjatë importit si doganë, tatimin e vlerës së shtuar dhe akciza dhe pagesën e akcizës jo vetëm gjatë importit, por edhe qarkullimin e brendshëm", thotë drejtori i Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë, Gjoko Tanasoski në intervistë për MIA-n. Ai shtoi se suksesi i realizuar gjatë pagesës së të ardhurave është meritë e më shumë faktorëve, ndërsa para së gjithash të disiplinës së rritur financiare të të gjithë pjesëmarrësve në tregti. Sipas tij, është shumë i rëndësishëm edhe bashkëpunimi me institucionet të cilat kryejnë kontroll të tregut të brendshëm, posaçërisht me Drejtorinë për të Ardhura Publike dhe Inspektoratin Shtetëror të Tregut.

Rritet numri i punëtorëve në industri

Shkup, 2 nëntor - Numri i punëtorëve në industri në shtator të këtij viti është rritur për 3.3 për qind në raport me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, tregojnë të dhënat e Entit Shtetëror për Statistika. Numri i punëtorëve në sektorin xehetari dhe nxjerrje e gurëve në shtator të këtij viti shënon rënie prej 0.5 për qind në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dhe rënie prej 1.2 për qind në sektorin Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klijatizim. Rritje të numrit të punëtorëve prej 3.8 për qind është vërejtur në sektorin e industrisë përpunuese. Sipas grupeve kryesore industriale, numri i punëtorëve në industri në shtator të këtij viti, në krahasim me shtatorin e vitit të kaluar shënon rritje tek prodhimet intermediare, përveç energjisë, për 9.2 për qind, prodhimet kapitale për 14.9 për qind dhe prodhimet e qëndrueshme për konsum të gjerë për 1.2 për qind. Rënie shënon tek energjia për 0.7 për qind dhe prodhimet e paqëndrueshme për konsum të gjerë për 2.1 për qind. Numri i punëtorëve në industri në periudhën janar-shtator 2017, në krahasim me periudhën janar-shtator 2016, është rritur për 1.5 për qind.

Linja hekurudhore midis Shkupit dhe Sofjes me të cilën përfundon pjesa lindore e Korridorit 8, është projekti më i madh që realizohet pas nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkësi transportuese me të cilin u ndanë 70 milionë euro për aksin e dytë të kësaj hekurudhe, në shtrirjen nga Bellakovci deri në Kriva Pallankë, në gjatësi prej 34 kilometrash. Nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve thonë se Qeveria e Maqedonisë është fuqimisht e përkushtuar në realizimin e këtij projekti jashtëzakonisht të rëndësishëm

Shkup, 2 nëntor - Maqedonia dhe Bullgaria sërisht vendosën afat për lidhje të ndërsjellë hekurudhore e cila paralajmërohet mbi dy dekada nga disa qeveri në të dyja shtetet. Për tetë deri në dhjetë vjet, midis vitit 2025 dhe 2027, duhet të përfundojë ndërtimi i hekurudhës nga ana e Maqedonisë e cila përfshin tre akse: Kumanovë-Ballekovcë, Bellakovcë-Kriva Pallankë dhe Kriva Pallankë-vendkalimi kufitar Deve Bair, dhe nga ana bullgare nga Gjuesheva deri te kufiri i Maqedonisë. Linja hekurudhore midis Shkupit dhe Sofjes me të cilën përfundon pjesa lindore e Korridorit 8, është projekti më i madh që realizohet pas nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkësi transportuese me të cilin u ndanë 70 milionë euro për aksin e dytë të kësaj hekurudhe, në shtrirjen nga Bellakovci deri në Kriva Pallankë, në gjatësi prej 34 kilometrash. Nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve thonë se Qeveria e Maqedonisë është fuqimisht e përkushtuar në realizimin e këtij projekti jashtëzakonisht të rëndësishëm. Në këtë drejtim, potencojnë, janë edhe angazhimet që të arrihet marrëveshje e përbashkët me Qeverinë e Bullgarisë përmes nënshkrimit të Memorandumit me të cilin që të dyja palët zotohen që t'i ndërtojnë akset që mungojnë. "Problemi me shpronësimin për aksin e dytë në pjesë të madhe është tejkaluar dhe ka filluar proces për parakualifikim që është i lidhur me 70 milionë euro të ndara me qëllim që të përshpejtojmë dinamikën e punës. Themelore është që të dinamizohet procesi duke pasur parasysh se aksi i tretë për hekurudhën nga Kriva Pallanka deri në Bullgari, është më e komplikuar dhe më e shtrenjtë edhe pse është me më pak kilometra", deklaroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve Goran Sugareski. Siç porositi eurokomisarja për transport, Violeta Bulc në biznes Samitin 100 të kohëmeparshëm në Shkup, ndërlidhja tejkufitare transportuese është prioritet.

Kush e ngadalëson ndërtimin

"Hekurudha është mënyra më e mirë që të shkohet përpara, sepse në të njëjtën kohë i dërgoni kërkesat për harmonizim të ndërsjellë për transportin klasik rrugor. Më vjen mirë që hekurudha është prioritet kyç", deklaroi Bulc. Porosi për rëndësinë dhe

Premtimi dydekadesh për linjën hekurudhore Shkup-Sofje

Hekurudha që nuk e sheh fundin



përkushtimin e projektit infrastrukturor hekurudhor dërguan edhe në takimin në qershor të këtij viti ministrat e Transportit të Maqedonisë dhe Bullgarisë, Goran Sugareski dhe Ivajlo Moskovski. Lidhja hekurudhore nga Sofja deri në Shkup është me rëndësi thelbësore për qarkullim të lirë të udhëtarëve dhe mallrave, për ç'arsye ndërtimi i grupit është prioritet, vlerësuan pas takimit Sugareski dhe Moskovski. Ndërtimi i binarëve në Maqedoni ka filluar në vitin 1994. Për atë dedikim janë ndarë para nga Buxheti shtetëror gjithnjë deri në vitin 2004, kur ndërtimi u stopua. Pas pothuajse stagnimit shumëvjeçar të punëve ndërtimore, në mars të vitit 2014 filloi ripërtëritja e tuneleve të ndërtruara dhe urave dhe ndërtimi i pjesëve të reja në pajtim me projektin.

Tani në terren, në rrjedhë është ndërtimi i aksit të parë nga Kumanova deri në Bellakovc (30,8 km) por, sipas Ministrisë së resorit, me intensitet më të vogël. Atje janë paraqitur probleme të llojit të eksproprijimit të pazgjdhur dhe zbulimeve arkeologjike dhe në rrjedhë është tejkalimi i tyre. Janë realizuar 25 për qind e punëve ndërtimore. Për këtë aks tashmë janë siguruar 43,5 milionë euro. Aktivitetet në teren përfshijnë rehabilitim dhe përfundim të ndërtimit të rreshtit të poshtëm të hekurudhës. Është paraparë ndërtimi i tre ndërtesave anësore,

katër stacione, tre urave, një gyp tuneli, tetë nënkalimeve dhe gjashtë mbikalimeve, pesë kilometra rrugë stacionuese, rrugë qasëse me nënkalimet dhe mbikalimet e projektuar të reja, sinjalizim dhe telekomunikime, elektrifikimi i tërë infrastrukturës së domoshme. Për aksin rrugor Bellakovc-Kriva Pallankë, në gjatësi prej 34 kilometrave, në vijim është përpilimi i projekteve themelore. Sipas paralajmërimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, afati për përpilimin e tyre është deri në fund të këtij viti pas çka duhet të zbatohet procedurë tenderi për zgjedhjen e kryerësit të punëve. Afati i pritur për ndërtimin e këtij aksi rrugor, sipas Ministrisë dikasteriale, është fundi i vitit 2021. Për financimin e fazës së dytë të kësaj hekurudhe Maqedonia fitoi hua nga Banka Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim, në lartësi prej 145 milionë euro. Në Samitin në Triestë që u mbaj këtë vit, Qeveria arriti të sigurojë grant nga BE-ja në lartësi prej 70 milionë eurosh, të cilat do të shfrytëzohen për ndërtimin e këtij aksi, ndërsa vlera nga huaja do të ulet në lartësinë e këtyre mjeteve të grantit nga BE-ja.

Incizim gjeodezik për aksin më të shtrenjtë Kriva Pallankë-Deve Bair

Aksi i fundit, Kriva Pallankë - Deve Bair, është më i shtrenjti dhe më i komplikuar

për ndërtim, edhe pse është më i shkurtër, 24 kilometra. Për të ka filluar incizimi gjeodezik në terren. Shuma e ndërtimit vlerësohet në më shumë se 350 milionë euro. Deri tani përmes Operativës IPA programit 2014-2020 janë siguruar 60 milionë euro, ndërsa sipas Ministrisë të Transportit të tjerat do të sigurohen përmes institucioneve ndërkombëtare financiare të cilat kanë paraqitur interes për financimin e saj. Planet janë ndërtimi të fillojë në vitin 2020, ndërsa të përfundojë në vitin 2025. Për pjesën nga hekurudha e anës greke, megjithatë, duhet të bëhet modernizim i hekurudhës nga Sofjes deri në Gjushëvë, si dhe rindërtim i 2,5 kilometrave nga Gjushëva deri në kufirin e Maqedonisë të cilën janë siguruar mjete. Sipas mediave bullgare, së shpejti duhet të fillojë procedura për zgjedhjen e projektuesve për hekurudhën nga Radomiri përmes Qustendilit deri në Gjushëvë. Tërësisht kufiri i ri hekurudhor nga Radomiri deri në kufirin me Maqedoninë do të kushtonte 473 milionë euro. Në rrugën e re hekurudhore që duhet ta përshpejtojë qarkullimin e udhëtarëve dhe mallit në Korridorin 7, në pjesën e Maqedonisë për shkak të kompleksitetit paralajmërohet se do të vozitet me shpejtësi prej rreth 100 kilometra në orë, nga ajo bullgare deri 160.

(MIA)

BULLGARIA E MBËSHKET MAQEDONINË PËR NË NATO DHE BE

Bullgaria e mbështet anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe BE dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes për fqinjësi të mirë tashmë nuk ka çështje të diskutueshme mes dy vendeve, theksoi ministri bullgar i Mbrojtjes Krasimir Karakacnov pas takimit të djeshëm në Sofje me ministrin e Mbrojtjes të Maqedonisë Radmila Sekerinska. "Për ne nuk ka asnjë problem me emrin e Republikës së Maqedonisë, tha Karakacnov, duke shtuar se prioritet i kryesimit bullgar të Këshillit të BE-së që fillon nga 1 janari do të jetë integrimi evropian i Ballkanit Perëndimor. Ministria Shekerinska vlerësoi se Marrëveshja e nënshkruar për fqinjësi të mirë nuk është vetëm një copë letër, por një platformë për ndërtimin e bashkëpunimit të suksesshëm mes Maqedonisë dhe Bullgarisë në të gjitha fushat. Shekerinska informoi se me Karaçanovin kanë biseduar për më shumë fusha konkrete në mesin e të cilave për trajnimin e pjesëtarëve të armatave, aktivitete të përbashkëta stërvitëse dhe këmbim të përvojave për reformat në mbrojtje dhe për procesin integruar euroatlantik. Shekerinska dhe Karaçanov në Sofje nënshkruan edhe dy protokolle për bashkëpunim në fushën e avionit ushtarak dhe për inspektime laboratorike të lëndëve djegëse, materiale lubrifikante dhe lëngje speciale.

Ekuacione diplomatike në Ballkan



Dr. Bled KOMINI

Ngjarjet e fundit në Ballkan kanë treguar se barometri i diplomacisë "aktive" ka pësuar një luhajtje të ndjeshme duke favorizuar ekonominë politike. Dalja në shesh e disa të dhënave ku tregohet se gjigandi rus "Gazprom" po synon të monopolizojë përmes privatizimit të gjithë tregun ballkanas të naftës dhe gazit natyror, është një tregues se tashmë qeveritë e vendeve në fjalë do të gjenden përballë "ariut polar", jo vetëm të ekspozuara politikisht por dhe ekonomikisht. E në këtë rast pyetja shtrohet: A përbën kjo një shah-mat politik-financiar për shtetet ballkanike?

Marrja në bashkëpronësi e rafinerisë serbe në Pançevë pak kohë më parë prej "Gazprom"-it, zbuloi fije politiko-ekonomike me të cilat Moskë synon të ngjiz

"Duhet miliona vjet për t'u krijuar, dhe vetëm pak sekonda për t'u djegur", kështu shkruante Duncan Graham-Rowe, një ndër shkencëtarët britanikë që jetën e tij ja ka dedikuar natyrës dhe përmes shkrimeve është munduar të sensibilizojë shtetet për "politikën e gabuar mbi naftën, gazin natyror dhe energjinë".



diplomacinë dhe politikën e saj të jashtme në gadishullin e trazuar e të quajtur kahera si "fuçi baruti". (150 mijë tonë naftë eksportohen nga Serbia çdo vit prej rafinerisë së Pançevës. Vetëm nga ky eksport i naftës, Serbia fiton 1.3 miliard euro çdo vit dhe përbën jo pak por 16% të shpenzimeve buxhetore të të gjithë buxhetit serb.) E në këtë drejtim, ari i zi, apo dhe rezervat e ndryshme energjetike, shikohen herë si burim fitimi e herë si mjet për të cilin mund t'u ushtrohet trysni politike vendeve të varfra bal-

kanike, por dhe atyre që prej kohësh e shohin Evropën (BE) si pikësynim strategjik e afatgjatë. Ndërkaq në këtë lojë të madhe, ku ari i zi apo gazi natyror shfaqen si ndjelësit kryesorë të shteteve të fuqishme për t'u kthyer kah Ballkani, pak muaj më parë u fut edhe Shqipëria.

Në Samitin Botëror të Naftës që u mbajt në Stamboll gjatë këtij viti, kryeministri shqiptar deklaroi se në krahinën e Shpiragut në Berat, përveç zonave që njiheshin më parë, është zbuluar një rezervuar i madh naftëm-


bajtës, dhe çështje më e rëndësishme është zbuluar edhe një depozitë e madhe gazi natyror. Të dhënat kanë ardhur nga një kompani shumë e fuqishme botërore që punon në Berat që prej vitit 2013 dhe që tani është gati të nisë punën për të vjelur frytet. Bëhet fjalë për "Shell"-in e famshëm holandez, i cili sipas "Albania Business and Investment Opportunities Yearbook Volume 1", vetëm për hulumtimin e puseve ka parashikuar një buxhet prej 200 milion dollarësh. Kjo gjë ka bërë që Shqipëria të vihet në

shënjestrën e disa kompanive të tjera të mëdha në botë dhe normalisht nuk mund të mungonte as "Gazprom"-i.

Në realitet, interesimi i gjigandit energjetik rus për resurset shqiptare ka filluar që në periudhën mes viteve 2011-2013 kur "Gazprom"-i u shfaq si një prej gjashtë kompanive që gjatë kësaj periudhe kërkoi të privatizonte "Albpetrol"-in, por që nuk ja doli. Kështu, kompania serbe e naftës dhe gazit NIS (Nafta Industrija Srbije), e kontrolluar prej "Gazprom"-it, pati deklaruar gjatë vitit 2012

se kishte për synim që së shpejti të niste kërkimet e saj për hidrokarbure në Shqipëri dhe Greqi (lajm ky i bërë i ditur prej agjencisë serbe Bloom-berg), periudhë kjo që pasoi dhe me ndryshimet politike brenda vendit tonë dhe me ardhjen në pushtet të koalicionit PS-LSI.

Nga ana tjetër, gjer më sot, Rusia mbetet furnizuesi kryesor i Evropës me gaz natyror, duke siguruar pothuajse 30% të gazit natyror në Kontinentin e Vjetër, pavarësisht se një pjesë sigurohet edhe prej tubacioneve që vijnë nga Norvegjia dhe Algjeria e disa herë më pak prej gazit natyror (në gjendje lëngu) prej Katari. Rusia anuloi projektin e gazsjellësit "Rrjedha e Jugut" (South Stream) në dhjetor të vitit 2014, duke e zëvendësuar atë me tubacionin e ri të "Rrjedhës Turke" (Turkish Stream). Zgjatimi i këtij projekti ruso-turk është duke u ri-orientuar për të furnizuar me energji të gjithë Europën Lindore me tubacionet e gazit grek (Greek Stream) dhe atyre Tesla (Stream). Kjo politikë e cila kaloi disa



Loic TREGOURES

Mohimi i krimeve të luftës është një mekanizëm psikologjik mbrojtjeje

Ministri serb i mbrojtjes Aleksandar Vulin shkaktoi një polemikë më herët këtë muaj duke lavdëruar kriminelin e liruar të luftës Vladimir Lazareviç, ish-shefi i shtabit të Korpusit të Prishtinës të Ushtrisë Jugosllave, i cili u dënua me 15 vjet burg nga Gjykata e Hagës për rolin e tij gjatë sulmit në Kosovë në vitet 1998-1999. Ai jo vetëm që e lavdëroi Lazareviçin, por deklaroi gjithashtu se ai do të ishte një profesor i shkëlqyer për kadetët ushtarakë të Serbisë dhe se kishte ardhur koha që serbët të mos turpëroheshin nga ata që i mbrojtën ata, por në vend të kësaj "të ishin krenarë për ta".

Që Lazareviç është një njeri i lirë dhe e shleu dënimin e tij, siç theksoi kryeministria Ana Brnabiç, ai ka absolutisht të drejtë. Megjithatë, nuk është ky thelbi dhe Brnabiç e di këtë. Thelbi është nëse

Shtete dhe grupe etnike në Ballkan vazhdojnë ende të mohojnë se trupat e tyre kryen krime lufte në një përpjekje për t'u shmangur përgjegjësisë morale duke fajësuar palën tjetër, duke penguar kështu mundësinë për pajtim.

Lazareviç duhet të trajtohet si një hero kombëtar. A duhet të shërbejë ai si një model për t'u ndjekur dhe të jetë profesor për një brez të ri ushtarësh serbë?

Këto pyetje na çojnë në atë që psikologët e quajnë disonancë kognitive. Domethënë, nëse shumë njerëz nga populli serb e shohin Lazareviçin, Veselinin, Sljivančaninin, Nikola Sainoviçin dhe mad-

je edhe Slobodan Milloseviçin si heronj dhe jo si kriminelë lufte, kjo ndodh sepse nëse i shohin ata si kriminelë lufte kjo do të thotë se ata, si popull, do të kishin gjithashtu një përgjegjësi morale për atë që ndodhi. Nëse këta njerëz mbrojtën popullin serb, ata s'mund të jenë kriminelë. Por nëse ata janë kriminelë, atëherë kauza për të cilën ata luftuan mund të ketë qenë e gabuar, gjë që është e pa konceptueshme, sepse atëherë ata do të duhej të mbartim një pjesë të atij fajit. Edhe më keq akoma, vetë ministri i mbrojtjes tani po i pranon ato, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis kriminelëve të luftës dhe popullit serb, duke shprehur krenari për veprimet e kryera në emër të serbëve në vitet 1990. Nëse Vulin ka ndërë ndonjëherë turp për atë që ndodhi në vitet 1990 në emrin e tij dhe në emër të popullit

të tij, sipas vetë fjalëve të tij, kjo është një çështje e hapur.

Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, ICTY, u projektua që të shmange çdo ndjenjë fajit kolektiv dhe për të gjykuar individë për krimet e tyre. Vulin nga ana tjetër po përkrahë kriminelë që vepruan "për të mbrojtur serbët", duke pranuar përgjegjësi kolektive për ata, por duke hedhur poshtë çdo faj kolektiv. Në këtë mënyrë, autoritetet serbe po e bëjnë pothuajse të pamundur zhvillimin e ndonjë debati të sinqertë të brendshëm në lidhje me atë që ndodhi 25 vjet më parë. Të jem i sinqertë, një mekanizëm i tillë mbrojtës psikologjik, i cili e lejon një person ose një popull të shmangë përballjen me përgjegjësitë e veta, është shumë i zakonshëm. Merrni si shembull Turqinë dhe mohimin e vazh-

dueshëm të gjenocidit armen. U desh një brez gjermanësh që të nxirrnin nazistët e tyre në gjyq. U deshën 30 vjet dhe një historian amerikan që francezët t'i jepnin fund mitit të rezistencës kolektive ndaj nazistëve dhe të gërmojnë në historinë e regjimit të tyre Vichy pronazist. U deshën 50 vjet që presidenti Shirak të pranonte përgjegjësinë e Francës në grumbullimin Vel d'Hiv që përfundoi me dëbimin dhe vdekjen e qindra hebrenjve francezë.

Edhe sot, debatet për luftën në Algjeri janë ende plot me plagë të pashëruara ende në të dyja palët. Thjesht kujtoni valën e kritikave të shkaktuara nga kandidati për president Emmanuel Macron kur ai tha në një televizion algjerian në shkurt se kolonizimi kishte qenë një krim kundër njerëzimit. I dërguar atje si një ushtar i ri

në vitet 1950, gjyshi im dikur më tha se "ne luftuam për asgjë". Meqë ai uronte të fliste për këtë, s'e pyeta kurrë se çfarë donte të thotë me këtë. A i vinte keq që Franca kumbi Algjerinë? Apo e kuptoi që ai dhe mijëra shokë të tij u dërguan atje për të vrarë dhe për të vdekur për një kauzë që iu prezantua atij dhe shumicës dërrmuese të popullit francez dhe ishte e paligjshme dhe e gabuar? Megjithatë, njerëzit u vranë dhe u torturuan për këtë kauzë të paligjshme, që është një barrë që populli francez duhet ta pranojë. Përveç kësaj, është gjithashtu një mekanizëm mbrojtës psikologjik t'i shohim viktimat tona si të vetmet të ligjshme ndërsa mohojmë të drejtën e tjetrit për të vuajtur.

E njëjta gjë vlen edhe për krimet e kryera. Krimet tona (nëse janë pranuar se kanë qenë krime) janë të



Një fshat japonez, ku arti mbillet

Në Inadake ndodhen orizoret më antike të vendit dhe për ta festuar fshati krijoi një ceremoni unike në botë të orizoreve që shndërrohen në vepra të mëdha artistike me anë të një teknike të quajtur Tanbo.

Rrathët nëpër fusha të kultivuara janë një dukuri që përsëriten shpesh kudo në botë. Për disa janë një mashtrim, për të tjerë mesazhe për qenie jashtëtokësore. Megjithatë ka një fshat ku vizatimet të lenë me gojë hapur dhe nuk janë të përsëritshëm. Inadake është një fshat në veri të Japonisë që i përkiste prefekturës së Aomorit, ku jetojnë rreth 8000 mijë banorë në një sipërfaqe prej 22 km katror. Që në krye të herës kjo popullatë është mbajtur nga kultivimi i orizit, por prej më shumë se një dekadë aty mbillet art. Në vitin 1981 një grup arkeologësh gjeti aty mbetjet e disa orizoreve që datonin prej më shumë se 2000 vjetësh dhe që atëherë u mendua që të krijohesh një park tematik mbi jetën e neolitit, por turistët ishin të paktë. Dështoi si ide.

Vendi u zhyt në borxhe dhe në vitin 1993 Koichi Hanada, një punonjës bashkie, pati një ide brilante: të përdorte fushat si kanavacë dhe orizin si penel. Vizatimi i parë ishte një mal i bërë nga një lloj orizi me tonalitet të purpurt dhe nga një tjetër jeshil i ndritshëm. Kështu lindi Arti Tanbo, një mënyrë për të shprehur identitetin rajonal dhe që u kthye një traditë të përvitshme. Çdo prill një grup njerëzish mblidhen për të vendosur për imazhin që do të vizatohet në fusha. Më pas 1200 vullnetarë marrin përsipër mbjelljen dhe për t'i dhënë formë vizatimeve. Vizatimet jo vetëm që shihen nga lart, por ata kanë ngritur një vend observimi me pamje të një kështjelle mesjetare japoneze, mbi bashki. Arti Tanbo shpreh koncepte të kulturës rajonale ose lokale, por edhe ato historike si Napoleoni që kalon Alpet i Jacques-Louis David apo Vala e Madhe e Kanagawa-s, të Katsushika Hokusai, ka edhe nga kultura popullore si Star Wars, Godzilla apo Naruto. *(bota.al)*




Perla nënujore shqiptare në National Geographic

Shqipëria, një vend në Detin Adriatik midis Malit të Zi dhe Greqisë, ka një nga brigjet më pak të eksploruara në botë". Kështu e nis shkrimin edicioni spanjoll i National Geographic në një speciale dedikuar fund detit të Shqipërisë. Shkrimi flet për relikte e ndodhura në fund të detit në brigjet shqiptare, anijet e zhytura nga Lufta e Dytë Botërore, ndërsa përmend që autoritetet shqiptare miratojnë legjislacionin për të mbrojtur trashëgiminë nënujore.

"Në brigjet e Sarandës mbeten dhjetëra amfora të mbytura apo qindra nga Afrika e Veriut që nga shekulli i katërt pas Krishtit, të cilat janë një testament për lidhjet tregtare midis detit Adriatik dhe bregdetin verior të Afrikës. Anijet, ende të dukshme, janë shkrirë me shtratin e detit dhe mbetjet e anijes mund të varrosen në afërsi. Nga ana tjetër, mbetjet shpirtërore të anijes italiane MV Probitas, që datojnë nga Lufta e Dytë Botërore, ruhen", sipas The Associated Press.





Surinami e ka njohur pavarësinë e Kosovës më 8 qershor, 2016. Ky vend ndodhet në Amerikën Jugore, me sipërfaqe prej 163.820 kilometrash katrorë dhe ka mbi 550 mijë banorë

Mark Ellis ka thënë për Radion Evropa e Lirë se në të Drejtën Ndërkombëtare ekzistojnë dy teori kryesore rreth njohjes së shteteve - ajo konstituive dhe teoria deklarative. Sipas teorisë konstituive, sqaron Ellis, njohja nga shtetet e tjera është kriter për vetë shtetësinë

Pranimi i shteteve sipas të Drejtës Ndërkombëtare paraqet një akt politik dhe si i tillë nuk ka edhe ndonjë ndalesë për tërheqjen e njohjes, thotë Mark Ellis, drejtor ekzekutiv i Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve me seli në Londër. Komentet e tij, pasojnë deklaratat e shefit të diplomacisë së Serbisë, Ivica Dačić, sipas të cilit, Republika e Surinamit ka tërhequr vendimin për njohjen e shtetit të Kosovës. Institucionet e Kosovës, thonë se nuk kanë marrë asnjë informatë zyrtare nga Surinami, dhe potencojnë se në të Drejtën Ndërkombëtare nuk njihet praktika e tërheqjes së njohjes, por sipas Qeverisë së Kosovës, mund të ekzistojë vetëm ngrirje e raporteve mes shteteve. Në lidhje me këtë, Mark Ellis ka thënë për Radion Evropa e Lirë se në të Drejtën Ndërkombëtare ekzistojnë dy teori kryesore rreth njohjes së shteteve - ajo konstituive dhe teoria deklarative. Sipas teorisë konstituive, sqaron Ellis, njohja nga shtetet e tjera është kriter për vetë shtetësinë. "Një shtet konsiderohet shtet vetëm kur njihet si i tillë nga një numër i konsiderueshëm i shteteve të tjera. Shtetet kanë diskrecion nëse do të njohin apo jo një shtet të ri.

Njohja e Kosovës nuk është e pakthyeshme



Për më tepër, vetëm me njohjen nga shtetet e tjera bën që shteti i ri të ekzistojë, të paktën në kuptimin juridik", ka thënë ai. Kurse përmes teorisë deklarative, nënvizon ai, thjesht vlerësohet nëse shteti përmbush kriteret objektive për shtetësi. Sipas kësaj teorie, njohja nga shtetet e tjera (siç është edhe teoria konstituive) është e parëndësishme për statusin e shtetësisë. Ai rikujton Neni numër një të Konventës së Montevideos, ku përcaktohen katër kriteret për shtetësinë, të cilat janë të pranuar nga organizatat ndërkombëtare si deklaratë e saktë e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Shteti si pjesë e të Drejtës Ndërkombëtare duhet të posedojë këto kualifikime: popullsi të përherëshme, një territor të përcaktuar Qeveri dhe kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet

tjera. "Në përgjithësi, në bazë të teorisë deklarative, njohja e një shteti, sipas të Drejtës Ndërkombëtare paraqet një akt politik, ndryshe nga ai ligjor. Prandaj, nuk ka asnjë detyrim në të Drejtën Ndërkombëtare për të njohur shtetin ose të drejtën e shtetit për t'u njohur", thekson Ellis. Ngjashëm, thotë ai, edhe tërheqja e njohjes është një akt politik, dhe si i tillë, nuk ka ndalim të përgjithshëm ose detyrim rreth tërheqjes së njohjes së ndonjë shteti të pranuar paraprakisht, siç është rasti me Republikën e Surinamit. "Prandaj, mendoj se është e vështirë që Kosova ta vërtetojë apo dëshmojë se njohja e shtetit është përgjithmonë e pavarëshme", thotë Ellis. Ekziston edhe një argument tjetër të çështja e njohjeve, thotë Ellis, e që lidhet me traktatin e Vjenës. "Në këtë skenar thuhet se

veprimet e njëanshme, siç është njohja e shtetësisë, nuk janë të modifikuar, përveç nëse ka një rryshim të rëndësishëm në rrethanat, siç është zhbërja e një shteti, siç ishte rasti me Jugosllavinë. Sidoqoftë, unë nuk jam mbështetës i këtij argumenti", thotë Ellis. Ministria e Punëve të Jashtme e Qeverisë së Kosovës ende nuk ka marrë ndonjë dokument zyrtar nga Republika e Surinamit, nëse ky vend e ka tërhequr njohjen e Republikës së Kosovës. Një vendim i tillë eventual nuk është konfirmuar deri më tash as nga Qeveria e Surinamit, përdërisa i vetmi që ka deklaruar këtë "tërheqje të njohjes", është shefi i diplomacisë serbe, Ivica Dačić. Duke mos u ndërlidhur vetëm me rastin e Surinamit, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Greg Delawie u ka bërë thirrje shteteve që ta njohin Kosovën. "Mbështetja e Shteteve të Bashkuara për Kosovën është e palëkundur dhe e pandryshueshme. Fakti i pavarësisë së Kosovës është i pakthyeshëm", ka deklaruar Delawie, për Radion Evropa e Lirë. Surinami e ka njohur pavarësinë e Kosovës më 8 qershor, 2016. Ky vend ndodhet në Amerikën Jugore, me sipërfaqe prej 163.820 kilometrash katrorë dhe ka mbi 550 mijë banorë. Që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008, Kosovën e kanë njohur 114 shtete.

Pajtimi i Kosovës me Serbinë kalon nga pranimi i Kosovës

Ministri i Punëve të Jashtme Behgjet Pacolli, ka thënë se pajtimi në mes Kosovës dhe Serbisë kalon nga pranimi i Kosovës shtet i pavarur. Përmes një shkrimi në Facebook, shefi i diplomacisë kosovare ka theksuar se ky pajtim duhet të ketë në themel edhe bashkëpunimin ekonomik. Pajtimi i Kosovës me Serbinë kalon nga pranimi i Kosovës, si një realitet shtetëror i konsoliduar dhe me respekt të plotë të integritetit të saj territorial. Çdo model pajtimi duhet ta ketë në themel të vetin edhe ekonominë.

Shqiptarët kursejnë për shëndetësinë dhe shpenzojnë për ushqim

Shqiptarët kanë shpenzuar më shumë para për arsimim dhe më pak për ushqim. Janë këto dy të dhënat kyçe të Anketës së Buxhetit të Familjes 2016 publikuar nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë. Shpenzimet mesatare për konsum të një individi vlerësohet të jenë 19.591 lekë në muaj nga të cilat: 8.861 lekë për konsum ushqimor dhe 10.730 lekë për konsum jo-ushqimor. Vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum në vitin 2016 është 4.2% më i lartë se në vitin 2015. Uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor në vitin 2016, a ka shënuar grupi "Ushqim dhe pije jo-alkoolike" me 3.5 pikë përqindje krahasuar me 2015, ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në grupin "Arsim" me 2.3 pikë përqindje. Referuar këtyre treguesve duket se jo rastësisht rritja vjen tek arsimit kur gjatë vitit 2016 patëm një rritje të tarifave mesatarisht me 10 për qind për kategorinë master niveli i parë dhe i dytë. "Përqindja e buxheti për grupin 'Shëndet', zë një peshë prej 3.4% duke shënuar ulje prej 0.2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Peshën më të madhe e zë blerja e medikamenteve me rreth 75.4%, ndërsa pjesa tjetër shkon për kujdes shëndetësor", thuhet në anketë lidhur me grupin e Shëndetit.

Qeveria e Haradinajt ka 200 këshilltarë!

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministrat e tij do t'i kenë në dispozicion rreth 200 këshilltarë. Haradinaj u ka gjetur punë 16 këshilltarëve në kabinetin e tij, përdërisa njëri nga ministrat e tij në kabinet tashmë i ka "rehatuar" 7 këshilltarë politikë dhe dy

asistente ekzekutive, shkruan "Zëri". Nga 7 deri në 10 këshilltarë pritet t'i kenë edhe 20 ministrat e tjerë të kësaj Qeverie, përdërisa paga e një këshilltari të ministrit sillet në 600 euro derisa këshilltarët e kryeministrit marrin pagë mujore prej rreth 1500 eu-

rosh. Sipas një kalkulimi të thjeshtë del se për pagat e këshilltarëve të kryeministrit dhe të ministrave brenda vitit nga buxheti i Kosovës shpenzohen rreth 2 milionë euro. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në ueb-faqen e këtij

dikasteri qeveritar tashmë ka publikuar emrat e 7 këshilltarëve politikë, si dhe të dy asistentëve administrative. Përveç numrit të madh të ministrave, Qeveria e Kosovës pritet t'i ketë rreth 50 zëvendësministra, të cilët po ashtu kanë të drejtë të emërojnë asistentë.

Kosova ka mungesë të një politike proaktive kundruall Serbisë

Marko Gjuriq, shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, ka deklaruar se qëllimi i tyre është që të ndihmojnë shtetin e Serbisë në forcimin e kapaciteteve institucionale për t'u marrë me çështjen e Kosovës

Serbia ka formuar grupin punues për ofrimin e mbështetjes për dialogun e brendshëm të Serbisë për Kosovën, dialogu ky i inicuar nga presidenti serb, Aleksandar Vuçiq. Sipas njohësve të çështjeve politike në vend, Koso-

va nuk duhet ta neglizhojë këtë organizim të brendshëm të Serbisë, por të zhvillojë një politikë më reaktive e jo të reagojë pasi të merret një vendim në Serbi. Shteti serb ka filluar dialogun e brendshëm për Kosovën, për ta forcuar palën serbe karshi dialogut me Kosovën. Udhëheqësi i këtij grupi, Marko Gjuriq, shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, ka deklaruar se qëllimi i tyre është që të ndihmojnë shtetin e Serbisë në forcimin e kapaciteteve institucionale për t'u marrë me çështjen e Kosovës. Por ky organizim, sipas njohësve të çështjeve politike në Kosovë, duhet ta bëjë më përgjegjëse Kosovën në



këtë proces. Profesi i së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Afrim Hoti, tha për Radio Kosovën se vendi ynë në vazhdimësi duhet të jetë i përgjegjshëm për detyrat që ka, dhe për asnjë mo-

ment të mos i neglizhojnë planet që paraqet Serbia: "Autoritetet kosovare duhet të jenë të vetëdijshme se serbët në asnjë moment nuk do të ndalen duke paraqitur platformë, qoftë në nivelin kombëtar,

qoftë në atë ndërkombëtar. Mendoj që politika kosovare duhet të jetë e vetëdijshme, duhet të jetë përgjegjëse dhe duhet të jetë e gatshme t'i përgjigjet secilës sfidë", tha ai. Kurse politologu Ramush Tahiri duke folur për këtë çështje, i tha Radio Kosovës se Kosova ka mungesë të një politike proaktive, pasi gjithmonë pret të reagojë pas ndonjë vendimi në Serbi: "Duket se Kosova ka mbetur si zakonisht mbrapa dhe ka politikë reaktive. Reagon pasi të merret një qëndrim në Serbi, nuk ka politikë proaktive apo parandaluese, dhe tash edhe në skenën politike dhe në opinionin publik në Kosovë po pritet se çfarë do të thotë Serbia dhe cili

është opsioni i saj e mandej Kosova të reagojë. Kjo nuk është në rregull, por në Kosovë jemi në nivel të para-politikës jo të politikës shtetërore, edhe demarkacioni edhe zënkat partiake e dëshmojnë këtë punë se Kosova nuk ka mbërrirë në fazën e shtetit stabil dhe të qëndrueshëm, i cili ka politikë shtetërore e jo politikë të hijeve partiake", tha ai. Ndërkohë, sipas presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, Serbia pritet të ofrojë një platformë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe më së largu në mars të vitit të ardhshëm, që, sipas tij, zgjidhja nuk është "as në mitet dhe konfliktet", por "as në heqjen dorë nga interesat nacionale".



OKB duhet të mbrohet nga "diktati i SHBA-së"



Shtëpia e Bardhë kërkoj nga Rusia që të ndalojë përpjekjet për të penguar rinovimin e autoritetit të një organi hetues të Kombeve të Bashkuara, i ngarkuar për të përcaktuar se kush është përgjegjës për sulmet me armë kimike në Siri. Kremlini i hodhi poshtë thirrjet e SHBA-së dhe zëvendësimin e jashtëm rus, Sergei Ryabkov, tha se duhet të merren "masa urgjente dhe drastike për të mbrojtur trupën e OKB-së dhe të gjitha aktivitetet nga diktati i SHBA-së". Autoriteti i Mekanizmit të Përbashkët Hetimor të OKB-së dhe i Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike do të përfundojë në mes të nëntorit. Në Këshillin e Sigurimit, javën e kaluar, Rusia u ka vënë veto përpjekjeve për rinovim të mandatit të tij, të udhëhequra nga SHBA-ja. Ekipi hetues i OKB-së ka konstatuar se Qeveria siriane ka qenë përgjegjëse për një sulm me gaz sarin në qytetin sirian, Khan Sheikhoun, në muajin prill. Dhjetëra njerëz kanë humbur jetën në këtë sulm. "Përpjekjet e Rusisë për të minuar dhe eliminuar Mekanizmin e Përbashkët Hetimor tregojnë një mospërfillje të kobshme ndaj vuajtjeve dhe humbjeve të njerëzve, si pasojë e përdorimit të armëve kimike, dhe mungesë të plotë respekti për normat ndërkombëtare", tha përmes një deklarate Shtëpia e Bardhë. Qeveria e presidentit sirian, Bashar al-Assad, e cila gëzon mbështetjen e Rusisë, ka mohuar vazhdimisht përdorimin e armëve kimike. Për sulmin në Khan Sheikhoun, ajo ka fajësuar rebelët sirianë.

Shtetet që po vrasin gazetaret

Të rrëmbyer, të torturuar, të vrarë: në të gjithë botën dhuna kundër gazetareve është shtuar. Por vetëm një në dhjetë krime sqarohet. Armiqtë më të mëdhenj të gazetareve shpesh janë shtetet ku punojnë gazetaret

530 gazetarë të vrarë. Vetëm midis viteve 2012 dhe 2016. Këtë shifër e publikoi UNSECO në një raport paraprak për "Report World Trend in Freedom of Expression and Media Development". Në bazë të rrjetit "Reporterë pa kufi", në vitin 2017 kësaj shifre iu shtuan edhe 47 gazetarë të tjerë. Krahasuar me dekadat e mëparshme kemi një rritje të dukshme, "Jeta si gazetar po bëhet më e rrezikshme", konfirmon Christian Mihr, drejtor ekzekutiv i "Reporterëve pa kufi". Dhe vetëm një ndër dhjetë krime sqarohen. Për të tërhequr vëmendjen në këtë gjendje të rëndë, në vitin 2013 OKB-ja shpalli "Ditën ndërkombëtare kundër mosdënimit të krimeve kundër gazetareve". Veçanërisht të rrezikuar janë qytetarët që punojnë si gazetarë, të ashtuquajturit gazetarë qytetarë, të cilët përhapin informacione në mediet sociale si në Facebook dhe në Twitter. Ata raportojnë nga rajone dhe vende, në të cilat nuk guxojnë të shkojnë më gazetaret klasikë. Në një rezolutë të OKB-së të vitit 2014, pranohet për herë të parë roli dhe nevoja për mbrojtje e gazetareve qytetarë. Por megjithë rezolutat e shumta, të cilat duhet të garantojnë



mbrojtjen e atyre që informojnë, numri i vrasjeve është i lartë.

TË DREJTAT E NJERIUT? JO DHE KAQ TË RËNDËSISHME

Shkak për këtë sipas Mihr-it janë dukuritë e shpërbërjes në shumë shteteve. "Në Afganistan, në Siri ose në Somali faktikisht pushtetin e kanë organizata, të cilat nuk ndihen të lidhura me marrëveshjet e miratuara të të drejtave të njeriut", thotë Mihr. Por shpërbërja e shteteve nuk është problemi më i madh, thotë Mihr. Në shumë raste shtetet vetë nuk janë fare të interesuara për sqarimin e një krimi. "Gazetarët shpesh raportojnë për gjëra, të cilat nuk u pëlqejnë anëtarëve të caktuar të qeverisë ose të administratës". Për të gjetur një sjellje të tillë, nuk duhet të shkosh

shumë larg, mjafton të shkosh deri në Maltë. Mihr-i dyshon që ekziston një interes i ndershëm shtetëror në hetimet për vrasjen e gazetares Daphne Caruana Galizia.

RRËMBIME, ARRESTIME DHE TORTURA

Jo vetëm numri i gazetareve të vrarë është në rritje, në rritje është edhe numri i akteve të dhunshme. Arrestime arbitrare, rrëmbime dhe tortura janë vetëm disa nga krimet që numëron OKB-ja. Kësaj i shtohet dhuna në hapësirën digjitale përmes fushatave të nxitjes dhe sulmeve ndaj faqeve të internetit të gazetareve jo të preferuar. Shumë ndiqen hap pas hapi me anë të përgjimit digjital. Ajo që tingëllon e padëmshme, përfundon jo rrallë në dhunë reale. "Në gjysmën e të gjitha

rasteve, në të cilat Reporterët pa kufi japin ndihmë emergjente, njerëzit ndodhen në një situatë emergjente, pra janë arrestuar ose po torturohen, sepse janë përgjuar më parë në mënyrë digjitale", thotë Mihr. Prandaj Reporterët pa kufi kërkojnë një të ngarkuar të posaçëm të OKB-së, sipas shembullit të Të Ngarkuarit të Posaçëm për Fëmijë dhe konflikte të armatosura, të cilin e ka emëruar në vitin 1997 OKB-ja. Ky i Ngarkuar i Posaçëm mund të bënte kërkime në mënyrë të pavarur dhe të dokumentonte rastet e dhunës ndaj gazetareve, në mënyrë që këto raste të ndiqen penalisht, thotë Mihr. Kjo ide ka shumë mbështetës, Bundestagu Gjerman është parlamenti i parë në botë që e ka kërkuar këtë vit të Ngarkuarin e Posaçëm. (DW)

CIA publikon 470.000 dosje nga bastisja e Bin Ladenit

CIA ka publikuar afro 470.000 dosje të sekstruara gjatë vrasjes së ish-udhëheqësit të Al Kaidës, Osama Bin Laden, në vitin 2011. Materiali i ri përfshin di-

tarin e tij personal, dokumente dhe video. Ky është publikimi i katërt nga CIA i materialeve të gjetura gjatë bastisjes së strehës së Bin Ladenit në Abotabad të Pakistanit. Megjithatë, disa ma-

teriale nuk janë publikuar sepse mund të dëmtojnë sigurinë kombëtare, tha agjencia amerikane e inteligjencës. Sipas deklaratës së CIA-s, dokumentet e publikuara "ofrojnë njohuri për origjinën

e ndarjeve që ekzistojnë sot midis Al Kadiës dhe Shtetit Islamik (v.j. grup militant), si dhe "mosmarrëveshjet strategjike, doktrinare dhe fetare brenda Al Kaidës dhe aleatëve të saj".

"Sulmuesi i Nju Jorkut" mund të dërgohet në Guantanamo!

Presidenti Donald Trump tha se po e shqyrton këtë gjë, e cila fillimisht do të kërkonte nga ai që ta shpallte Saipovin "luftëtar të armikut." "Do ta konsideroj me siguri. Dërgojeni atë në Gitmo (Guantanamo)", tha Trump



Disa ligjvënës amerikanë i bënë thirrje Shtëpisë së Bardhë që ta dërgojë Sayfullo Saipovin, të akuzuarin për vrasjen e tetë personave në Nju Jork, në burgun ushtarak në Guantanamo. Presidenti Donald Trump tha se po e shqyrton këtë gjë, e cila fillimisht do të kërkonte

nga ai që ta shpallte Saipovin "luftëtar të armikut." "Do ta konsideroj me siguri. Dërgojeni atë në Gitmo (Guantanamo)", tha Trump. Në një postim në Twitter, presidenti po ashtu tha se beson se

Saipov "duhet të dënohet me vdekje", pasi, pas sulmit, ka thënë se është "i lumtur" dhe ka shprehur besnikëri ndaj grupit militant Shteti Islamik. Burgu ushtarak në bazën detare të SHBA-së në

Kubë është shfrytëzuar në të kaluarën kryesisht për të burgosur militantët e kapur nga forcat amerikane në fushat e betejës në Afganistan dhe Irak. Paraardhësi i Trumpit, Barack Obama,

ka shprehur keqardhje për praktikën, e cila, sipas tij dhe kritikëve të tjerë, u mohon të drejtat themelore ligjore të të burgosurve, dhe ka kërkuar mbylljen e burgut. Asnjë i paraburgosur nuk është dërguar në Guantanamo qysh në vitin 2008. Për më tepër, Saipov është banor i ligjshëm i SHBA-së dhe normalisht ka të drejtat ligjore që i janë dhënë me sistemin civil të drejtësisë amerikane. Por, kryetari i Komitetit të Senatit për Shërbime të Armatosura, John McCain, ishte midis atyre në Kongres që i bënë thirrje Trumpit për ta dërguar Saipovin në Guantanamo. "Nuk duhet t'i konsiderojmë këto sulme në tokën tonë si të izoluar, por t'i njohim ato ashtu siç janë: akte të luftës", tha McCain. Senatori re-

publikan, Lindsey Graham, po ashtu i bëri thirrje Trumpit që ta shpallë Saipovin "luftëtar të armikut". Graham tha se ai duhet të merret me shumë në pyetje për të përcaktuar me siguri nëse ka vepruar i vetëm, ashtu siç kanë thënë autoritetet në Nju Jork. "Është qesharake të besojmë se një ditë intervistash në spital na tregon gjithçka që duhet të dimë për lidhjet terroriste të Saipovit", tha Graham. Saipov, me prejardhje nga Uzbekistani, tashmë është akuzuar për terrorizëm nga një gjykatë e qarkut në Nju Jork. Më 31 tetor, ai dyshohet se ka goditur me kamion kalimtarë në një zonë të çiklistëve në lagjen Menhatën, duke vrarë tetë persona dhe plagosur disa të tjerë. (REL)



Ekonomi

A janë paraja dhe feja, më të ngjashme se sa mendojmë ne?



Paratë tona kanë vlerë sepse ne biem dakord që kanë. Sidomos teksa paraja bëhet gjithnjë e më digjitale — si kartat e debitit dhe Bitcoin — ideja e besimit tek vlerat monetare është thelbësore për strukturën ekonomike që kemi ngritur

Diana BROWN

Ka qindra (sipas disa vlerësimeve, mijëra) fe në mbarë botën. Fjalorët e Oksfordit e përcaktojnë fenë si “besimin dhe adhurimin e një fuqie kontrolluese mbinjerëzore, veçanërisht një Perëndi apo disa perëndi personale”.

Bazuar në këtë përkufizim, mund të nxjerrim disa krahasime interesante mes adhurimit të një perëndie dhe adhurimit të parasë së plotfuqishme. Sepse: Çfarë është paraja nëse nuk është një “fuqi kontrolluese mbinjerëzore”?

Nuk është se të gjithë njerëzit adhurojnë paranë — apo ekonominë, apo institucionet financiare. Por, shumë prej kurtheve të fesë së organizuar, janë të ngritura përreth tyre. Në librin e tij “Teologjia e parasë”, filozofi Philip Goodchild shkruan se i gjithë sistemi ynë financiar është i ngritur mbi besimin.

Paratë tona kanë vlerë sepse ne biem dakord që kanë. Sidomos teksa paraja bëhet gjithnjë e më digjitale — si kartat e debitit dhe Bitcoin — ide-

ja e besimit tek vlerat monetare është thelbësore për strukturën ekonomike që kemi ngritur. Monedha në thelb përfaqëson një premtim për të paguar një borxh, që mbështetet prej një institucioni financiar, si një bankë tregtare apo një bankë qendrore. Pa besimin tek ky premtim, paratë tona nuk vlejné as sa letra ku janë printuar.

Dhe nuk kanë qenë gjithmonë të printuara. Në të kaluarën, gjërat me vlerë si çokolat, kripa, piperi dhe të tjera mallra me vlerë përdoreshin për shkëmbim me të tjera mallra e shërbime.

Kështu që, përveç faktit që kemi një sistem ekonomik të bazuar në besimin, ka edhe të tjera aspekte të financës që pasqyrojnë fenë. Shumë fe, për shembull, kanë tempuj apo



Kush e tradhtoi Ana Frankun?

Vince Pankoke, një hetues i agjensisë federale të Amerikës do të ndërtojë historinë se si u kap vogëlushja në banesën ku jetonte e fshehur në Amsterdam. Pankoke do të realizojë një skanim të materialeve historike plus edhe teknologjinë që nuk ka qenë shfrytëzuar në hetimet e mëparshme

Kur në 14 gusht të 1944 Ana Franku dëgjoji një goditje të thatë muri e kuptoi se diçka po ndodhte. Nuk ishte një tingull i zakonshëm në atë vend sekret. Këtë zhurmë e kishte dëgjuar pak muaj më parë kur Gestapo-ja kishte inspektuar ndërtesën, ku jetonte e fshehur nga nazistët, gjatë pushtimit gjerman në Hollandë. Ajo u arrestua bashkë me 8 persona të tjerë. Të gjithë, përveç të atit, Otto Frank, vdiqën në kampe. Pas 73 vitesh hapet një hetim i udhëhequr nga një ish agjent i FBI-së, i cili kërkon të zbulojë misterin më të madh të Holokaustit dhe të Luftës së Dytë Botërore.

Kush e tradhtoi dhe dorëzoi Ana Frankun? Vince Pankoke, një hetues i agjensisë federale të Amerikës do të ndërtojë historinë se si u kap vogëlushja në banesën ku jetonte e fshehur në Amsterdam. Pankoke do të realizojë një skanim të materialeve historike plus edhe teknologjinë që nuk ka qenë shfrytëzuar në hetimet e mëparshme.

Qëllimi është të zbulohet se kush e lajmëroi policinë gjermane dhe t'u tregonte vendin e

saktë ku gjendeshin një grup çifutësh. Do të shfrytëzohen arkivat e Uashingtonit, Hollandës, Gjermanisë dhe Izraelit. Për këtë është ndërtuar një maket i banesës ku fshihej Ana. Do të analizohen tridimensionalisht se si perceptoheshin zhurmat nga brenda jashtë dhe do të përdoren teknika digjitale inovatore që do të lejojnë të kuptohet udhëtimi i tingujve përmes mureve të banesës.

Ky është një mister që nuk ka mundur të zgjidhet. Ka patur edhe hetime të mëparshme në vitin 1948 autoritetet hollandeze pretenduan se e kishin zbuluar informatorin, por pa sukses. Dështuan sërish në vitin 1963. Ana Franku jetoi e fshehur për dy vite, derisa për motive të panjohura në 14 gusht përfundoi në kampin e përqendrimit nazist. Sipas regjistrave naziste, Ana vdiq në shkurt të 1945 në Bergen-Belsen, një nga ferret gjermane, ku numri i çifutëve të mbledhur në Hollandë ishte 110 mijë.

Shpëtuan vetëm 5500. Në fillim u mendua se informatori ishte Wilhelm van Maaren, pronari i dyqanit që e dinte mjaft mirë vendndodhjen, por tani hetuesit janë të hapur ndaj çdokujt. Ajo që dihet me siguri është se tradhtari ishte i njohur nga familja Frank, të paktën kështu besojë gjithmonë. Kur Otto Franku u kthye në verën e 1945 supozoi se dikush i kishte dorëzuar. Megjithatë teoria nuk kufizohet vetëm me tradhtinë. Besohet se policia ishte në vendndodhje për motive të tjera dhe ata rastësisht u gjetën, referon kështu The New York Times.

Historia e njësisë ushtarake më elitare në histori

Garda Pretoriane

Me shërbime të fshehta, forca speciale dhe administratorë urbanë, Garda Pretoriane e Romës ishte një nga njësitë ushtarake më prestigjioze në botë. Ata njihen si ushtarët që i kanë shërbyer më mirë perandorit të Romës dhe Perandorisë Romake. Ata luftonin përkrah legjioneve, bllokonin kryengritjet e protestuesit si dhe shërbenin si siguri për gladiatorët që luftonin. Nga rritja e influencës së tyre, ata luajtën rol të rëndësishëm edhe në intrigat brenda perandorisë romake.

Origjina e tyre daton që nga Republika Romake

Garda Pretoriane ishte pjesë e epokës perandorake, por origjina e tyre daton që nga grupet e ushtarëve elitare që

mbronin gjeneralët gjatë Republikës Romake. Që në fillim të shekullit II para erës sonë, njësitë speciale ishin përzgjedhur për të mbrojtur liderët e njohur romakë: të tillë si Marc Antony, Scipio Afrikanus dhe Lucius Cornelius Sulla. Jul Cezari më pas e shtoi numrin e mbrojtësve të tij në dhjetë, por Garda Pretoriane u shfaq menjëherë pasi Augusti u bë perandori i parë i Romës në 27 para erës sonë. Garda madje kishte edhe fortesën e vetë të quajtur “Castrum Praetorium”.

Ata shërbyen edhe si zjarrfikës

Zjarri ishte një kërcënim i vazhdueshëm në



Romën e lashtë, edhe pse perandoria kishte një trupë të specializuar zjarrfikëse të quajtur “Vigiles,” nuk ishte e pazakontë për Pretorianët e perandorit të jepnin një dorë në rast zjarri. Ata gjithashtu ndihmuan

në shuarjen e zjarreve të ndezur nga kryengritësit gjatë mbretërimit të Neronit. Duke e përfshirë gjithnjë personelin e pretorianëve në punët e popullit, perandori donte të tregonte, që ai vinte njësinë

e tij mbrojtëse më të mirë në favor dhe në ndihmë të qytetarëve.

Merrnin pjesë në lojërat romake

Garda Pretoriane shpesh merrej me kontrollin e turmës në lojërat romake, por herë pas here ata futeshin në arenë dhe luanin një rol aktiv në gjakderdhje e beteja. Ka të dhëna që shumë prej tyre morën pjesë në përballje me kafshë të egra për të demonstruar aftësitë e tyre luftarake. Një nga spektaklet më të mëdha ishte përleshja e anijeve në arenë, në një lloj pishine të improvizuar. Shumica e pjesëmarrësve ishin të burgosur dhe skllevër, dhe

pretorianët, të armatosur me katapulte u futën në betejë në për të shtuar kaosin.

Ata vepronin si një forcë policore sekrete

Pretorianët ishin të njohur për angazhimet në spiunazh, kërcënime, arrestime dhe vrasje për të mbrojtur interesat e perandorit romak. Për operationet klandestine, ata mund të punësonin një krah të veçantë të trupave të njohur si “spekulatorët”. Dikur shërbenin si një trupë zbuluese në Republikën Romake, apo si korrierë dhe operativë të inteligjencës në shërbim të Cezarit. Pretorianët maskoheshin si qytetarë të zakonshëm në konkurse gladiatorësh, shfaqje teatrore dhe protesta për të monitoruar dhe për të



vende të shenjta ku mund të shkosh të adhurosh, apo të flasësh me një prift, apo anëtar të shenjtë, që të ndihmon të interpretosh vullnetin, sipas perëndisë apo perëndive të tyre. Edhe ëall Street-in, apo cilëndo bursë, mund ta interpretojme në mënyrë të ngjashme: një qendër e ekonomisë që zien, me investitorë që thërrasin të blesh a të shesësh aksione, bazuar në asgjë tjetër përveç besimit të investitorit – ose në thelb, besimin në vlerën e diçkaje.

Fuqia misterioze e tregut të lirë ose e ekonomisë, gjithashtu duhet të përkthehet në terma laikë për shumë prej nesh, veçanërisht pasi krijimi modern i parave është kaq i komplikuar. Ai përfshin kredi, huadhënie, bankë rezervash të pjesshme dhe kështu me radhë. Ne mbështetemi në këshilltarët financiarë për të interpretuar vullnetin e tregut për ne. Dhe keqmenaxhimi ose keqinterpretimi mund të rezultojë në një "goditje" prej forcës së "mbinatyrshme", në formën e recessioneve ekonomike dhe depressioneve, siç pamë në shumë vende gjatë krizës financiare globale të vitit 2008.

Feja është përdorur për të kontrolluar sjelljen njerëzore përmes kërcënimit të ferrit apo premtimit të jetës së përjetshme në parajsë. Por filozofi Goodchild argumenton se paraja, dhe borxhi, janë sot motivuesit kryesorë të bashkëpunimit njerëzor – kështu që një pjesë e madhe ka nisur të ndërthuret me fenë. Ekziston një sekt shumë i madh i kristianizmit që njihet si ungjilli i begatisë, i cili konsideron pasurinë personale, si shenjë e të qënit bekuar prej perëndisë, duke i lidhur edhe më shumë pranë me fenë. A do të thotë kjo që ndonjëherë do të krijohet një sekt zyrtar? Apo që forma më tradicionale të fesë do të anojnë në favor të një teologjie të parasë? (net – bota.al)

Shtatëdhjetë vjet më parë, një fermer i preu kokën një pule, por ajo refuzoi që të ngordhte. Mike, siç u quajt pula, mbijetoi për 18 muaj dhe u bë e famshme. Por si mbijetoi kaq shumë?

Më 10 shtator të vitit 1945, Lloyd Olsen dhe gruaja e tij, Clara, po prisnin pulat e fermës së tyre në Fruita, Kolorado. Ai u priste kokat pulave, e shoqja i pastronte. Por një nga 40 a 50 pulat e prera, nuk sillej si të tjerat. "Ajo ishte akoma gjallë dhe ecte vërdallë," thotë stërnipi i çiftit, Troy Waters, edhe ai fermer në Fruita.

Pula shkëlmonte dhe vraponte, dhe nuk ndalonte. Ata e vendosën në një arkë të vjetër mollësh për të kaluar natën. Kur Lloyd Olsen u ngrit mëngjesin tjetër, për të parë se çfarë kishte ndodhur, "pa se ajo gjëja e mallkuar ishte gjallë akoma," thotë Waters.

"Është pjesë e historisë së çuditshme të familjes sonë," thotë Christa, gruaja e Waters.

Waters e kishte dëgjuar historinë kur ishte i vogël, kur stërgjyshi i tij erdhi të jetonte me familjen e tyre, pasi ishte i sëmurë. I moshuari fliste për orë të tëra për pulën. Fjalët nisën të përhapen në mbarë zonën për mrekullinë e zogut pa kokë. Një gazetë lokale dërgoi një reporter për të intervistuar Olsen dhe dy vite më vonë, një promovues cirku, Hope Wade, shkoi atje. Ai kishte një propozim të thjeshtë: nxirreni në cirk dhe bëni para.

Fillimisht ata vizituan Universitetin e Jutah, ku pula iu nënshtrua disa testeve. Thuhej se shkencëtarët e universitetit ua prenë kokën shumë pulave të tjera për të parë nëse do mbijetinin. Pikërisht këtu revista Life u njoh me historinë e pulës së mrekullisë Mike. Ndërkohë Lloyd, Clara dhe Mike nisën një tur në SHBA. Ata shkuan nga Kalifornia në Arizona dhe Hope Wade e mori Mike në tur në pjesën juglindore të vendit kur çifti duhej të kthehej në

Pula që jetoi 18 muaj pa kokë



MIRACLE MIKE THE HEADLESS CHICKEN

I listened and heard the farmer say,
"We'll have this fowl for lunch today."
Thought I, "There won't be nothin' doin'
I just can't see myself a'atwinin'."
But he took the axe and chopped off my head
Then threw me down and left me for dead.
There on the ground for a moment I lay
Then I arose and walked away!

Said farmer Lloyd to his kindly wife,
"That's the strangest thing I've seen in my life."
Said the kindly wife to her farmer man,
"I can't put him in the frying pan—
A fowl that hates so much to die—
There must be some good reason why,
And since he wants so much to live
Every living chance to him we'll give."

Through my esophagus they feed me corn,
They give me drink and keep me warm.
I'm well and happy as can be.
I stand around for folks to see.
Although I haven't got a head—
I'm better off than if I'm a'ad!

Copyrighted 1945 by Arba A. Gleen

fermë për të korrurat.

Udhëtimet e zogut janë dokumentuar me kujdes nga Clara në një libër të ruajtur me armë sot nga Waters. Njerëz nga mbarë vendi shkruanin letra për ta, jo të gjitha pozitive.

Njëri i krahasonte ata me nazistët.

Pas turit të parë, familja Olsen e dërgoi Mike në një shfaqje në Feniks, Arizona, kur goditi katastrofa në verën e vitit 1947. "Këtu ngordhi, në Feniks," thotë Waters. Mike ushqej më ushqim të lëngshëm dhe ujë, të cilin ia derdhnin direkt në ezofag. Ata ia pastronin me kujdes mukusin nga fyti. Ata e ushqenin me pikatore dhe ia pastronin fytin me shiringë. Natën që ngordhi, ata u zgjuan në dhomën e motelit nga zhurmat e zogut që po

mbitej. Ata kërkuan me shpejtësi një shiringë, por e kishin harruar në cirk. Olsen nuk tregoi kurrë se çfarë u bë me zogun e ngordhur.

Por si mbijetoi kaq gjatë? Gjëja që e habit Dr. Tom Smulders, një ekspert pulash në Universitetin e Njukasëllit, është fakti që zogu nuk nxori gjak. Faktin që mund të jetonte pa kokë, ai e shpjegon lehtë. Një njeri mund të humbasë kokën dhe kjo nënkupton të humbasësh trurin. Për një pulë është ndryshe. "Do ushqej më ushqim të shikonit sa të vogël e ka trurin", thotë ai. Ai është i përqendruar kryesisht prapa syve. Raportimet flasin se sqepi, fytyra dhe sytë e Mike ishin hequr me një të goditur. Por Smulders mendon se rreth 80 përqind e trurit dhe gjithçka që kontrollon trupin e pulës, përfshi zem-

rën, frymëmarrjen dhe tretjen, mbeti e paprekur.

Në atë kohë u sugjerua se Mike mbijetoi për shkak se një pjesë e trurit i mbeti ngjitur me trupin. Por përse nuk patën sukses ata që tentuan të rikrijonin këtë rast? Duket se në rastin e Mike, prerja ishte fiks në vendin e duhur, duke krijuar një mpiksje që pengoi gjakderdhjen. Thuhet se Olsen tentoi të ripërsërisë suksesin, por nuk ia doli. Kur u kthye në fermë, njerëzit i kërkonin t'i qeraste me birra, pasi ishte bërë shumë i pasur. Në fakt ai bëri pak para, bleu një korrëse bari dhe dy traktorë, duke zëvendësuar kalin dhe mushkën. Po ashtu në atë kohë bleu edhe një kamioncinë Chevrolet. "Megjithatë pjesën tjetër të jetës e kaloi sërish si fermer," thotë stërnipi i tij. (bbc)

arrestuar të gjithë ata që e kritikonin perandorin.

Ata kanë luajtur rol në vrasjen e disa perandorëve Pretorianët mund të ketë qenë me detyrë "Mbrotjtja e perandorit romak", por ata ishin gjithashtu kërcënimi i vetëm më i madh i jetës së tij. Mashtrimi ishte një cilësi që e karakterizonte Perandorinë e Romës, dhe një pjesë e madhe e tyre bëheshin nga pretorianët që ishin të gatshëm për therje e vrasje për të instaluar perandorë të rinj kur tundoheshin nga premtimet e para apo pushteti. Pretorianët e pakënaqur ndërthurën vrasjen e Kaligulas dhe zgjedhjen e Klaudit si pasuesin e tij në vitin 41.

Ata nxirrnin në ankand perandorinë për ofruesin më të lartë

Sipas historianit Cassius Dio, pas vrasjes së

Perandorit Pertinax në vitin 193, Garda Pretoriane u përpoq të fitonte me të holla vakuumin e pushtetit duke vendosur fronin romak në ankand. Pas një lufte të shkaktuar mes tyre dhe të pakënaqurve ndaj kësaj ideje. Ky incident është një nga episode më të këqija e famëkeqe në historinë e njësisive ushtarake.

Njëherë luftuan kundër njëritjetrit në një betejë

Një nga incidentet më të pazakonta në historinë e pretorianëve erdhi në vitin 69, kur gjenerali Vitellius mposhti Perandorin Oto dhe morri fronin romak. Duke iu frikësuar vrasjes në duar e pretorianëve besnikë ndaj Otos, Vitellius i zboi ata për t'i zëvendësuar me një fuqi më të madhe trupash të rekrutuar nga legjionet e tij. Për fatin e tij të keq, mbretërimi i Vitellius zg-

jati shumë pak, pasi komandanti i legjioneve Vespasiani e shpalli veten perandor dhe u zhvendos në Romë. Një seri betejash mes pretorianëve zgjatën në periferi të qytetit.

Ishin në mendje të ndryshme për të mbështetur fronin romak

Struktura e Gardën Pretoriane ndryshoi përgjithnjë në shekullin e dytë, kur perandori Septimius Severus shkarkoi trupat e tij, dhe filloi të rekrutonte truproja nga legjioni i tij. Megjithatë, e drejta e tyre për të mbrojtur fronin romak nuk mbaroi zyrtarisht deri në shekullin e katërt. Në vitin 306, pretorianët u përpoqën të luajnë rolin e vendimmarrësit një herë të fundit kur ata vendosën në krye të Perandorisë perëndimor Romake, uzurpatorin Maxentius.

(History Channel)

Zbulohet amaneti i fundit i Hitlerit

Rochus Misch ishte truproja personale e Hitlerit, ai ishte njeriu i parë që pa trupin e pajetë të diktatorit nazist. Në autobiografinë e tij Misch shkruan se diktatori i tha pak para se të vriste veten se donte që trupi i tij digjej. Hitleri ndodhej në bunker, më 30 prill 1945-ës, kur Gjenerali Keitel i dha mesazhin se ushtria nuk arriti të thyejë rrethimin sovjetik në Berlin dhe se fundi i Luftës së Dytë Botërore ishte i pashmangshëm.

Hitleri i kishte rrëfyer si amanet të fundit se, nuk donte që trupi i tij të keqtrajtohej publikisht, siç ishte bërë me Mussolinin dhe se donte që



kufoma e tij të digjej. Truproja e rrëfen kështu momentin, kur gjeti trupin e pa jetë të diktatorit: Sytë e mi shkuan fillimisht tek Eva, ajo ishte shtrirë pranë tij, këpucët e saj ishin nën

divan, pranë saj. Pastaj pashë Hitlerin, sytë e tij ishin të hapur dhe të skuqur. Misch u kap nga Ushtria e Kuqe Sovjetike dhe u burgos në kampet e punës për tetë vjet, por mundi të arratisëj.



Në afro 100 faqe Orwell zhvillon një revolucion në fermën Manor, ku kafshët shkarkojnë njerëzit dhe pastaj heqin dorë edhe nga Utopia që ata donin të krijonin

Nuk keni kohë për ta lexuar “Luftën dhe Paqen” të Leo Tolstoit? Këta libra të mëdhenj, por të shkurtër, mund t’i lexoni brenda një dite. Këta 10 libra, të cilët, pavarësisht prej faqeve të pakta dhe lakonizmit të tyre, janë ndër librat më të mirënjohur në histori.


Librat ikonë që mund t’i lexoni brenda një dite

ERNEST HEMINGWAY: “PLAKU DHE DETI”- Ky është libri me të cilin Hemingway fitoi çmimin “Nobel”. Jo keq për një libër që numëron rreth 110 faqe. Ai tregon historinë e një peshkatari, Santiagos, i cili nuk kishte kapur gjë prej gjëje për 84 ditë. Ditën e 85-të, peshkatari merr barkën e tij modeste dhe shkon shumë larg. Ai kalon beteja serioze, tekta lufton me një peshkë shumë të madh. Hemingway refuzoi të përdorte simbolizmin eksplisit në punët e tij, duke preferuar që lexuesit të gjejnë vetë kuptimin e ngjarjes. Aftësia e tij për të dhënë një shumësi interpretimesh të mundshme e ka bërë atë popullor, që kur u publikua për herë të parë.

ALBERT CAMUS: “I HUAJI”- Kjo është një vepër tjetër, fituese e çmimit “Nobel”, por krejtësisht e ndryshme nga punët e Hemingway-t. “I huaji” tregon historinë e një burri, Mersei, nëna e të cilit sapo ka vdekur. Ai nuk shfaq asnjë emocion gjatë funeralit të saj. Pas kësaj, Mersei gjendet afër një shoku, i cili do të hakmerret ndaj disa arabëve. Mersei, pa ndonjë arsye të dukshme, vret disa njerëz. Indiferenca e tij çudit gjykatësit dhe ai dënohet me vdekje. Ndërsa pret vdekjen, Mersei mendon për ftohësinë e universit, por duket se gjen rehati në “indiferencën e butë të botës”. Një punë e tërë filozofike, të cilës i mjaftojnë fare pak faqe.

GEORGE ORWELL: “FERMA E KAFSHËVE”- Duket si një histori përralle, por në fakt “Ferma e kafshëve” është një alegori e fortë për regjimet totalitare të viteve 1930, sidomos për regjimin stalinist të Bashkimit Sovjetik. Në afro 100 faqe Orwell zhvillon një revolucion në fermën Manor, ku kafshët shkarkojnë njerëzit dhe pastaj heqin dorë edhe nga Utopia që ata donin të krijonin. Historia nuk është lehtësisht e lexueshme, pasi çdo anëtar i shoqërisë sulmohet për një aspekt të veçantë totalitarizmi: delja budallaqe që ndjek çdo diktat të ri, derrat që kthejnë punën e të gjithëve në përfitim të tyre, gomari intelektual që e sheh se ç’ndodh, por që nuk bën gjë prej gjëje dhe kali punëtor, i cili beson verbërisht në detyrat e njerëzve. Të gjitha këto janë gabime njerëzore.

REMARQUE: “ASGJË E RE NGA FRONTI I PERËNDIMIT”- “Asgjë e re nga fronti i Perëndimit” është historia e një brezi të humbur. Disa djem shkojnë për të luftuar në Luftën e Parë Botërore. Paul Baumer tregon për jetën e njerëzve në luftë dhe për njerëzit që i presin ata në shtëpi. Para luftës, djemtë janë të mbushur me ndjenja patriotike dhe me veprat e Homerit. Gjatë luftës, të gjithë miqtë e Baumer-it vriten dhe ai kupton se nuk do t’ia dijë më për të ardhmen. Libri përfundon me



mesazhin “Asgjë e re nga Perëndimi”. Të gjitha vdekjet dhe historitë e librit reduktohen në një fjalë, atë për të cilën këta burra shkuan të luftojnë.

GOETHE: “VUAJTJET E DJALOSHIT VERTER”- Pas botimit të këtij libri, pati një valë vetëvrasjesh. Historia rrëfëhet përmes letrave të një djali të ri me temperament, Verter-it dhe shoqes së tij. Verter është një romantik, i dhënë pas dashurisë dhe poezisë, ndonëse i ati e shtyn drejt marrjes së një profesioni. Ndërsa jeton në fshat, ai bie në dashuri me Sharlotën, pavarësisht se ajo është e fejuar. Kjo dashuri e konsumon Verterin dhe kur i fejuari, e më

vonë bashkëshorti i Sharlotës, Alberti, e detyron Verterin që t’i lërë ata vetëm, Verter kryen vetëvrasje. I veshur me kostumin që kishte kur takoi për herë të parë Sharlotën, ai qëllon veten. Goethe, veprat e të cilit zakonisht përfshijnë tema të mëdha, nuk e pëlqente asociimin vetëm me Verterin, por në jetën e tij të vonshme ai pranoi se do të ishte humbje në rast se një person nuk do të ishte ndër të paktën një herë në jetë si Verteri.

OSCAR WILDE: “PORTRETI I DORIAN GREIT”- “Portreti i Dorian Greit” është një lloj libri i pritshëm nga Wilde. Ai është i mbushur me detaje të zgjuara, ndërsa rrefën historinë e Dorian Greit, një djalosh i ri, shumë i pashëm dhe shumë i pasur, i cili korruptohet nga bota. Apo korruptohet nga vetja? Kur fytyra e tij e bukur hidhet në pikturë nga miku i tij piktor, ai uron që piktura të vjetrohet, ndërsa ai të qëndrojë i ri gjithnjë. Ndërsa Doriani bie në mëkate dhe krime, fytyra e piktorës bëhet e mizorshme. I paafër për të parë portretin e tij, ai e fsheh atë, ndërsa fytyra e tij mbetet e pandryshuar. Ai bën përpjekje që të rregullojë gabimet duke bërë punë të mira, por tashmë është vonë. Në fund, ai vret edhe shokun e tij më të mirë dhe shkatërron pikturën, duke thyer dëshirën që u kthye në mallkim. Në libër shihen qartë

shenja homoseksualiteti. **ANTOINE DE SAINT-EXUPÉRY:** “PRINCI I VOGËL” - “Princi i vogël” është një nga ata libra për fëmijë që ofron një material të mirë leximi për cilëndo moshë. Tepër i thjeshtë në strukturë, libri tregon historinë e një princi, i cili drejton një asteroid dhe aventurat e tij në tokë. Ai takon të rritur që drejtojnë asteroidët e tyre dhe të cilët janë tepër komikë. Është një mbret, i cili do të dënojë me vdekje miun, që dyshohet se jeton në asteroidin e tij. Megjithatë, ai do t’i kërkonte falje nëse e kapte; “Për hir të ekonomisë. Është vetëm një mi”. Disa e gjejnë tepër të vështirë kuptimin e fundit të udhëtimit të Princit, dhe kjo vlen edhe për të rriturit.

ELIE WIESEL: “NATA”- “Nata” është rrëfimi i asaj që vetë Wiesel ka përjetuar si djalë i ri gjatë Holokaustit. Ai është një djalë i ri hebre, shumë studiues, i cili përpjeket të mësojë sa të mundet rreth Kabbalah-së. Për fat të keq, Lufta e Dytë Botërore dhe qeveria hungareze kufizon të drejtat e hebrenjve. “Nata” rrefën se si Eliezeri humb të ëmën dhe motrën në kampet e përqendrimit. Ai fillon ta urrejë babanë, pasi ai i kërkon Eliezerit të kujdeset për të në kamp. Ai nuk beson më në Zot e, megjithatë, ia del të mbijetojë dhe të rindërtojë atë që ka mbetur në jetën pas Holokaustit.

“MetroFest”

Ka hapur siparin edicioni i parë i Festivalit të dramës shqipe “MetroFest”, organizuar nga Qendra Kulturore Tirana (Teatri Metropol). Në këtë edicion të parë të festivalit janë përzgjedhur vepra të panjohura të arkivit, si “Loja e Mbasdrekës” e Martin Camaj, “Armiqtë” e Shpëtim Ginës dhe “I biri i Begut” e Milo Duçit

“Është një festival i për-vitshëm i Teatrit Metropol, i cili do të ofrojë në çdo edicion të tij, eksplorimin e një aspekti të ndryshëm të teatrit. “Jemi shumë të entuziazmuar që këtë edicion të parë vendosëm që të humtonim disa nga veprat shqiptare të arkivave, të cilat për një arsye ose një tjetër nuk e kanë prekur kurrë skenën. Fokusi ynë, është te krijimi i një marrëdhënie të shëndetshme me veprën shqiptare”, shpjegon Jonida Beqo, drejtore e Teatrit Metropol. Veprat vihen për herë të parë në skenë nga regjisorët, platformat e të cilëve janë përzgjedhur me platformat e tyre gjatë audicionit në Teatrin Metropol. Përkatesisht; “Loja e Mbasdrekës” nga Martin Camaj, e cila do të vihet në skenë nga Shkëlzen Berisha, vepra e dytë është “I biri i Begut”, vepër e shk-

Vepra e panjohur e Martin Camajt për gjakmarrjen

ruar nga Milo Duçi dhe me regji nga Joana Omeraj si dhe vepra e ndaluar e Shpëtim Ginës me titull “Armiqtë” që do të vihen në skenë nga Xhuljano Brisku.

Gjithashtu në “MetroFest” do të marrë pjesë shfaqja “Rrno për me tregue” e At Zef Pllumit me regji nga Milto Kutali si dhe disa pjesë inskenim të “Njollat e murrme” e shkruar nga Minush Jero dhe regji nga Sonila Kapidani. Gjatë ditëve të festivalit do të ketë edhe dy lexime veprash, “Foleja Kombëtare” nga Lumo Skëndo si dhe “Prangat” nga Halil Laze dhe pas çdo shfaqjeje do të organizohen panele diskutimesh për çdo vepër përkatesë.

“Në fillim të pranverës ne shpërndamë këto tekste në klasat e regjisë master në Universitetin e Arsteve, për të na paraqitur më pas secili platformën e tij regjisoriale. Si pjesë integrale e punës me veprën shqiptare dhe teatrin shqiptar, pyetja e vazhdueshme është se kush do ta trashëgojë dramë shqipe, kush po vjen tani e kush do të vij më pas, kush do vazhdojë këtë punë e kush do ta çoj më tej? Tre regjisorët e veprave shqiptare u përzgjedhën si rezultat i



këndvështrimit që kishin mbi këto vepra”, thotë regjisorja Beqo.

“Loja e pasdrekës” e Martin Camajt do të vihet në skenë nën regjinë e Shkëlzen Berishës. Në qëndër të veprës është fenomen i gjakmarrjes. Është shkruar në vitin 1981, dhe është botuar në vitin 1995. Ngjarjet në veprën “Loja e Mbasdrekës” zhvillohen në një fshat të malësisë së Dukagjinit, duke nxitur ndjesinë e lartësisë që vjen prej klimës së alpeve. “Loja” përdoret me mjeshtri në

këtë shfaqje si nocion që e vendos njeriun mes “sajimit” dhe “së vërtetës”.

E konsideruar nga regjisori jo vetëm si proces krijues, por si proces kulturor i çon të kërkojnë gjuhësore, historike e sociale, puna për realizimin e kësaj shfaqjeje ka qenë një rrugëtim mjaft i fuqishëm dhe nxitës që ngre pyetje që çojnë në një hapësirë të re thellimi e jo që gjen dhe jep përgjigje statike: Çfarë është drejtësia? Çfarë është padrejtësia? Vepra “Armiqtë” vjen nën regjinë e Xhuliano Bri-

skut. Një autor i ri, por shumë i veçantë e kërkues është quajtur Shpëtim Gina nga shumë njerëz që e kanë njohur ose punuar me të, që fatkeqësisht u nda nga jeta para kohe. Vepra “Armiqtë” e nisur për t’u vënë në skenë në vitet ‘70-të do të shfaqet më në fund për herë të parë në Teatrin Metropol në Festivalin MetroFest.

Ngjarjet e dramës zhvillohen në Itali, viti 1943. Një fshat i humbur në një krahinë të largët. Shtëpia e plakës Terrinë. Në anën tjetër të kënetës, një kamp përqendrimi nga vijnë krisma, thirrje, lehtë qensh. Është arratisur dikush. Një shqiptar e një italian. Si perceptohet një luftë nga njerëz të ndryshëm me kulturë dhe jetë të ndryshme? Si dhe kush është armiku kur bëhet fjalë për mbijetesë? Personazhet jetojnë në presion dhe ky presion i çon të kërkojnë shtigje prej nga mund të kuptojnë gjithë çka ndodh e sit e dalin prej saj.

Çdo gjë që i përplas ata në atë bodrum, në atë arratisje, është dëshira për liri e cila njëkohësisht krijon ankth. “I biri i Begut” risjell në teatër Milo Duçin nën regjinë e Joana Omeraj. Kjo shfaqje shkruar nga Milo Duci e bo-

tuar në Kajro, do t’i prezantojë publikut rrethanat sociale e familjare në të cilat kanë jetuar familjet shqiptare në Kaninë të Vlorës, një zonë me tjetër dinamikë jetese nga ajo e sotmja, me një tjetër shqipe të artikuluar nga personazhet nga ajo që flasim sot, por me halle e probleme që shqetësojnë njeriun në çdo kohë e hapësirë. Historia flet për një gjyshe të pasur e cila ka rritur për 25 vite me radhë dy djem të mbetur jetimë.


Gjatë këtyre 25 viteve ajo pyet veten se cili është nipi i saj i vërtetë? I do të dy njësoj, i ka rritur njësoj, por dy djemtë kanë karaktere të ndryshme dhe një ditë njëri prej tyre humb jetën duke lënë kështu pa përgjigje gjyshen se cili është në të vërtetë nipi i saj. Në situata komike, personazhet gjenden të trazuar nga padija, zakonet dhe dëshirat, zilia e interesi për para, deri në fund kur ndodh humbja. Shfaqja vjen e freskët, me ngjyra të gjalla e të shumta si dëshmi e viteve për të cilat teatri nuk ka edhe shumë realizime në skenë, por që shqiptarët e atëhershëm këmbëngulin për botim. Pikërisht frymëmarrja e saj do të jetë fije lidhëse me të kaluarës e të sotmen.



Kiks-Boks, në Budapest fillon Kampionati Botëror

Ramadani favorit për medalje

Njëri prej favoritëve kryesor për ti sjell medalje Maqedonisë në këtë Botëror është kik-boksieri shqiptar Hadis Ramadani. Për kik-boksierin nga Shkupi do të jetë kjo një mundësi e mirë që më në fund në konkurrencën e seniorëve të dëshmojë talentin dhe kualitetet që i posedon. Ai do të merr pjesë në konkurrencën e seniorëve, ndërsa deri më tani ka regjistruar shtatë meçe profesionale në Zvicër dhe të gjitha i ka fitore, që paraqet një uverturë të mirë para Botërorit në Budapest



ment do të merr pjesë edhe përfaqësuesja e Maqedonisë, të cilën do ta prezantojnë nëntë garues. Konkurrenca pritet të jetë shumë e madhe, ndërsa pritet të marrin pjesë mbi 1.300 kik-boksier nga 54 shtete. Njëri prej favoritëve kryesor për ti sjell medalje Maqedonisë në këtë

Botëror është kik-boksieri shqiptar Hadis Ramadani. Për kik-boksierin nga Shkupi do të jetë kjo një mundësi e mirë që më në fund në konkurrencën e seniorëve të dëshmojë talentin dhe kualitetet që i posedon. Ai do të merr pjesë në konkurrencën e seniorëve, ndërsa deri më

tani ka regjistruar shtatë meçe profesionale në Zvicër dhe të gjitha i ka fitore, që paraqet një uverturë të mirë para Botërorit në Budapest. Për atë se çka pret në Kampionatin Botëror në Budapest të Hungarisë, Ramadani tha se pret rezultat të mirë dhe se do të jep më të mirën nga vetja për të fituar medalje e pse jo të artë. "Në kampionatin Botëror pres rezultate të mirë të kolegëve të mi. Gjithashtu pres që edhe unë të arrij rezultat të mirë. Konkurrenca në kategorinë time është e madhe, por unë jam përgatitur si gjithmonë maksimalisht dhe patjetër të jap më të mirën nga vetja. Epiritin e favoritetit për të fituar medaljen e artë e kam për shkak se kam zhvilluar disa lufta të forta gjatë këtij viti, ku siç e dini të gjitha i kam fituar, pra nga shtatë meçe profesionale kam shtatë fitore", deklaroi kik-boksieri nga Shkupi, Hadis Ramadani. Ndërkohë, seleksionues i përfaqësueses së Maqedonisë është Dejan Mitrovski, derisa pos Ramadani favorit për të fituar medalje janë edhe Milan Kubin, Jetmir Emruli dhe Enver Rexhepovski.

Ftesa kuqezi edhe për Gavazajn

Enis Gavazaj është kandidati i radhës për të marrë një ftesë kuqezi nga trajneri Kristian Panuçi. Sulmuesi i Skënderbeut, që ka shkëlqyer në këtë sezon është futur prej kohësh në orbitën e kombëtares. Kjo është arsyeja përse miqësorja e 13 nëntorit në Antal ndaj Turqisë mund të jetë shansi i djaloshit nga Prizreni. Gavazaj është kthyer në një prej pikave më të forta të korçarëve në sezonin ku skuadra ka arritur kualifikimin e dytë në histori në fazën e grupeve të "Europa League". 22-vjeçari arriti të plotësonte më së miri hapësirat e lëna në sulmin e Skënderbeut nga shitja e Bernard Berishës dhe Liridon Latifit, madje tashmë ai vlerësohet si ylli i radhës që mund të transferohet jashtë Shqipërisë. Grumbullimi i Enis Gavazajt në Kombëtare do



të pasonte thirrjen në skuadër të mesfushorit Sabien Lilaj, prezenca e të cilit në miqësoren e Turqinë duket thuajse e sigurt. Nëse trajneri Panuçi do të vendosë ta afrojë në skuadër dhe ti japë një shans, do të bëhet fjalë për rikthimin e Gavazajt pas dy vjetësh me ngjyrat kuqezi, me lojtarin që deri në 2015-ën ka luajtur me përfaqësuesen shpërndarë, ku regjistroi 11 ndeshje duke shënuar edhe një gol.

Vokri: Kosova pa trajner të ri kundër Letonisë



Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri insiston se nuk do të ketë trajner të ri për ndeshjen miqësore ndaj Letonisë, e cila do të zhvillohet me 13 nëntor në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Cekim, Kosova është pa trajner që nga nëntë tetori i këtij viti, kur Albert Bunjaki u largua në marrëveshje me FFK-në, pas më shumë se tetë viteve në krye të Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Vokrri, tregoi se për këtë miqësore Kosovën do ta udhëheqin dy trajnerët kosovar, Muharrem Sahiti dhe Genc Hoxha, të cilët ishin ndihmës të Albert Bunjakit. "Kosova nuk do të ketë trajner të ri me 13 nëntor në ndeshjen ndaj Letonisë. Kombëtares në

këtë ndeshje do ta drejtojnë dy trajnerët, Muharrem Sahiti dhe Genc Hoxha", tha Vokrri. Ai po ashtu foli edhe për trajnerin e ri, ku insiston se ende nuk kanë nisur bisedimet me askënd, sepse për momentin vetëm janë duke shikuar mundësitë. "Ne nuk jemi ende në bisedime me asnjë trajner, pasi për momentin jemi në inspektim të tyre", u shpreh ai në fund. Pavarësisht se FFK ende nuk flet për emra, trajneri italian Rodolfo Vanoli e ka pranuar se ka pasur kontakt nga FFK dhe i ka thënë "po" Kosovës, por me disa kushte. Në listën e Kosovës thuhet se janë edhe emrat e disa trajnerëve të tjerë të njohur nga Italia, Gjermania dhe Franca.

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 2 nëntor – Sot (e premte) do të fillojë Kampionati Botëror i kik boksit "Budapest 2017". Ndryshe, në këtë eveni-

Vrenezi do të takohet me Lalloviqin



Shkup, 2 nëntor – Kryetari i Federatës së Mundjes së Maqedonisë Betim Vrenezi dhe nënkryetari i sak Dejan Bogdanov, pas Kampionatit Ballkanik për fëmijë dhe kadetë që këtë fundjavë do të mbahet në Murska Subota në Slloveni, do të takohen në Lozanë të Zvicrës me njeriun e parë të Luftërave të bashkuara botërore, Nenad Lalloviq. Këtë e konfirmon edhe vet kryetari Vrenezi. "Në takimim me Lalloviqin, do të bisedojmë për përmirësimin e

mundjes si sport në Maqedoni dhe zhvillimin e saj, si dhe marrjen e të drejtës për organizimin e Kampionatit Botëror për kadetë në vitin 2019. Gjithashtu do të bisedojmë edhe për vazhdimin e bashkëpunimit me kuadrot profesionale të mundjes së bashkuar botërore, respektivisht organizimin e seminareve si dhe ndarjen e mjeteve të llojit të dyshekëve dhe rekuizitave tjera për stërvitje", deklaroi Vrenezi, njeriu i parë i mundjes në Maqedoni.

U 17 – Shorti për plasman në KE në Angli më 6 dhjetor

Maqedonia mëson kundërshtarët e mundshëm

Shkup, 2 nëntor – Përfaqësuesja e Maqedonisë për futbollist deri më 17-vjeç, siç dihet për herë të parë në historinë e saj kjo gjeneratë, siguroi plasman në kualifikimet elitare për Kampionatin Evropian. Të përzgjedhurit e seleksionuesit Goran Staniç u gjendën në mesin e 32 përfaqësuesve nga Evropa të cilët në pranverë vitin e ardhshëm do të luajnë në kualifikimet elitare për vend në KE, pasi me suk-

ses kaluan fazën e parë të kualifikimeve. Ndryshe, pas përfundimit të grupeve kualifikuese, janë mësuar 32 përfaqësueset të cilat do të luajnë në këto kualifikime. Pas përfaqësuesve më mirë të renditura Gjermania dhe Portugalia, edhe 30 siguruan vend në short nëpërmjet raundit të parë kualifikues, ndërsa ata janë Belgjika, Zvicra, Kroacia, Spanja, Izraeli, Çekia, Turqia, Finlanda, Islanda, Serbia, Greqia,



Norvegjia, Franca, Sllovenia, Skocia, Danimarka, BeH, Sllovakia, Maqedonia, Hungaria, Holanda,

Austria, Rumania, Republika e Irlandës, Polonia, Suedia, Qipro, Italia dhe Gjeorgjia. Derisa, shorti për kualifikimet elitare do të mbahet më 6 dhjetor në Nion. Përfaqësueset do të ndahen në tetë grupe nga katër skuadra, pas së cilës të parat në grup dhe tetë më të mirët nga vendi i dytë nga tetë grupet, do të luajnë në KE, bashkë me nikoqirin Anglinë. Kujtojmë, Maqedonia fazën e parë të kualifikimeve e kaloi pasi ishte

skuadra më e mirë e vendit të tretë nga 13-grupet. Në grupin kualifikues në Shkup, Maqedonia luajti baras pa gola me BeH dhe Sllovakinë, kurse e mundi Moldavinë me 2-0. Interesante është se përfaqësuesja e Maqedonisë është njëra prej gjashtë përfaqësuesve, bashkë me Italinë, Izraelin, Danimarkën, Finlandën dhe Islandën, e cila nuk pranoi gol në fazën e parë të kualifikimeve nga gjithsejtë 13 grupe sa ishin.



NBA

Klivilend në krizë të thellë

Klivilend ka pësuar humbjen e 4-t radhazi në NBA, duke u mundur 124-107 nga Indiana, një përballje që konfirmoi krizën e ekipit kampion në Konferencën e Lindjes. LeBron me 33 pikë e 11 asistime bëri maksimumin për të evituar humbjen, por nuk ia doli mbanë



Kriza e Klivilend Kavalirs nuk njeh limite. LeBron Xhejms me shokë pësuan humbjen e katërt radhazi dhe të pestën sezonale përballë Indiana Pejzers me rezultatin 107-124. Në "Quicken Loans Arena" për Cavs vetën Xhejmss u mundua të bënte diçka, por 33

pikët e tij, 11 asistimet dhe 6 rikuperime ishin pak përballë një skuadra mjaft të organizuar si Pejzers. Jang dhe Kollison, me nga 26 dhe 25 pikë secili, ishin pika e referimit për skuadrën nga Indi-

anapolis, që me 5 fitore dhe 3 humbje është ngjitur në vendin e tretë në Konferencën e Lindjes. Kthehet te fitorja pas dy humbjeve radhazi Hjuston Rokets, që gjeti Xhejms Harden në superformë në

fitoren 107-119 në parketin e Nju Jork Niks. 31 pikë, 9 asistime dhe 5 rikuperime regjistroi Harden, që kishte statistikat më të mirë të ndeshjes. Los Anxhelos Klipers vazhdon të kryesojnë Kon-

ferencën e Perëndimit, pasi kaloi 119-98 Dallas Maverik, skuadër që mbyll renditjen me vetëm një fitore në 9 ndeshje. Griffin edhe këtë radhë rezultoi më i miri për kalifornianët me 20 pikë, 7 asistime dhe 6 rikuperime. Në takimet e tjerë të mbrëmjes Sharlot Hornets kaloi 126-122 Milvoki Baks, Filadelfias iu imponua 119-109 Atlanta Hauks, Feniks San triumfoi 116-122 në parketin e Uashington Uizards, Boston Seltik fitoi 113-86 me Sakremento Kings, Majami Hit më në fund gjen fitoren 97-91 ndaj Çikago Bulls, Memfis Grizzli u dorëzua 99-101 me Orlandon, Nju Orleans u mposht 98-104 nga Minnesota, Denver Nagets shpërtheu 129-111 ndaj Toronto Raptors dhe Juta Xhez triumfoi 112-103 ndaj Portlandit.

Nadal e nis me fitore Mastersin e Parisit

Rafael Nadal u kualifikua në raundin e 3-t të Mastersit të Parisit turne që po zhvillohet aktualisht në kryeqytetin francez. Numri 1 i Botës i cili e nisi aventurën e tij nga raundi i dytë eliminoi lehtësisht në 2 sete koreano-jugorin Çung me shifrat 7-5 6-3.

Në raundin tjetër Nadal do të sfidojë uruguaiian Pablo Kuevas. Surprizën e ditës në Paris e dhuroi Benneteau i cili eliminoi në set final, bashkëkombësin e tij Jo Vilfried Tsonga. Avancuan më tej emra të tjerë të rëndësishëm si Huan Martin Del Potro, Fernando Verdasko, Lukas Pouille e Jon Isner.

Publicitet

Zhito Pollog SHA Tetovë publikon SHPALLJE PËR SHITJE TË PRONËS SË PATUNDSHME-DYQANE

Përshkrim	Çmimi minimal i shitjes
Dyqan prej 41m2 në Tetovë	7.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 26m2 në Tetovë	4.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 26m2 në Tetovë	8.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 50m2 në Tetovë	8.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 63m2 në Tetovë	8.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 19m2 në Tetovë	2.000€/m2+tvsh
Dyqan prej 49m2 në Tetovë	4.000€/m2+tvsh

Mundësi për kredi përmes Stopanska Banka sh.a Manastir

Për më tepër informacione kontaktoni personin Dejan Kanaçkoviç në 070 343 522

Ju lutemi ofertat ti dorëzoni në zarf të mbyllur në adresën Zhito Pollog SHA Tetovë, rr.Marshall Tito 134, 1200 Tetovë, Maqedoni

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për energjetikë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 16/11, 136/11, 79/13, 164/13, 41/14, 151/14 dhe 33/15) dhe nenit 20, paragrafi 2 alineja 1 dhe 2 e Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarisë energjetike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 143/11, 78/13 dhe 33/15), Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime "FLOU" SHPKNJ import-eksport Kavadar me adresë: rr. "Narodna Mlladina" nr. 3 Kavadar, Republika e Maqedonisë për prodhim të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "FLOU" në vijim publikon

LAJMËRIM

Lajmërohet opinioni se Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime "FLOU" SHPKNJ import-eksport Kavadar me adresë: rr. "Narodna Mlladina" nr. 3 Kavadar për prodhim të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "FLOU", më datë 20.09.2017 ka parashtruar kërkesë deri te KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike me PAI nr. 12-171/17.

Emri i kërkesit:

Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime "FLOU" SHPKNJ import-eksport Kavadar, për prodhim të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "FLOU".

Loji i energjisë elektrike:

Prodhimi i energjisë elektrike nga burime të ripërtëritura të energjisë nga centrali fotovoltaik.

Rajoni ku do të realizohet veprimtaria:

Veprimtarinë energjetike, prodhim i energjisë elektrike nga burime të ripërtëritura të energjisë nga centrali fotovoltaik "FLOU", Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime "FLOU" SHPKNJ import-eksport Kavadar, do ta realizoj në lokacionin PK 1226/27 v.q Popova Kulla, KK Demir Kapi, komuna Demir Kapi, Republika e Maqedonisë.

Përshkrimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime "FLOU" SHPKNJ import-eksport Kavadar, do të prodhojë energji elektrike në një central fotovoltaik "FLOU" deri më 49,8 kW, me vend për kyçje në rrjetin elektrodistribues të EVN Maqedoni SHA Shkup.

Kohëzgjatja e licencës:

Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime "FLOU" SHPKNJ import-eksport Kavadar, për prodhim të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "FLOU" nga KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË kërkon që licenca të jetë me kohëzgjatje prej 35 (tridhjetepesë) vjet.

Mënyra dhe afati përfundimtar për parashtrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me Kërkesën për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike:

Palët e interesuara, subjektet juridike dhe fizike mund që me shkrim të parashtrorjnë deri tek KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, propozimet, mendimet dhe sugjerimet në lidhje me kërkesën për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të LAJMERIMIT në shtypin ditor për kërkesë për dhënie të licencës për prodhim të energjisë elektrike.

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Makedonija pn, pallati L Lazar Pop Trajkov, kati 6
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Në bazë të miratimit nr. 12-8901/2 nga 27.07.2017 Rishikimi nr. 5 nga ana e Ministrisë për Arsimit dhe Shkencë, nga Ligji për Arsimit të Mesëm, VD drejtori i shkollës "Nace Bugjoni" Kumanovë shpall:

Shpallje publike

për plotësimin e vendit të lirë të punës

Sekretar të shkollës

1. -1 (një) sekretar të shkollës

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për marrëdhënie pune, kushtet e përcaktuara në nenin 59,59-a dhe 59 -b nga Ligji për arsim të mesëm, t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës dhe në Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, edhe atë:

- Të ketë të mbaruar studime në shkencat e drejtësisë.
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.
- Të njohuri themelore dhe aftësi për të punuar me një kompjuter.
- Të ketë aftësi komunikuese dhe organizative.

Konkursi e mësipërm është për kohë të caktuar të punës, më së voni deri më 31.08.2018, orari i punës nga or 07:00 deri 13:00, nga e hëna deri e premtdja, me pagë neto për kohë të plotë të punës 21.516.00 den.

Shpallja publike do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shpalljen publike, ndërsa përzgjedhja do të bëhet në bazë të kushteve të plotësuar që kë kërkohen në afat prej 15 ditë pune pas përfundimit të shpalljes publike. Aplikimet jo me kohë të caktuar dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk



Ronaldo mohon zërat

Kam edhe katër vjet, nuk dua të rinovoj

"Unë jam duke kaluar shumë mirë te Real Madridi. Kam katër vjet të mbetura në kontratën time dhe nuk dua të rinovoj. Jam mirë", - tha ai për "BEIN Sport"



Kristiano Ronaldo mohoi se ai është duke kërkuar një kontratë të përmirësuar me Real Madridin, pasi ka parë skuadrën e tij të mposhtet nga Tottenhami në përplasjen e Ligës së Kampionëve, të mërkurën. Me Neymarin duke nënshkruar një kontratë fitimprurëse te PSZH-ja, duke u bërë blerja më e shtrenjtë në botë, dhe Lionel Messin, që kohët e fundit është duke zgjeruar marrëveshjen e tij te Barcelona, raportet kishin sugjeruar se Ronaldo do të

kërkonte të fitonte barazi me dy superstarët. Sulmuesi portugez, i cili shënoi golin e vetëm të Real Madridit në "Ëmbley", në humbjen 3-1 të tijve, ka

hedhur poshtë pretendimet se ka qenë duke i bërë presion bordit të Merengues për një ngritje të pagës. "Unë jam duke kaluar shumë mirë te Real

Madridi. Kam katër vjet të mbetura në kontratën time dhe nuk dua të rinovoj. Jam mirë", - tha ai për "BEIN Sport" pas ndeshjes. Real Madridi ishte një hije e zbehtë në përballjen me "Spurs". Kampionët e Çampionit në dy sezonet e fundit kanë nevojë për një shkundje, ndaj Ronaldo i bëri thirrje ekipit të tij të kthehej te fitoret. "Kjo situatë është e keqe, për shkak se po humbasim, ndërsa ne jemi mësuar të fitojmë. Është një gjë e keqe vërtet. Nuk janë si do t'i donim gjërat, por këto ndodhin në futboll. Është një zhvillim i keq, por ne duam të ndryshojmë dhe jam i sigurt se do të ndryshojmë. Kemi shumë kohë për të marrë më të mirën dhe jam i bindur se mund ta bëjmë këtë." Me gjashtë gola, Ronaldo është golashënuesi më i mirë i Ligës së Kampionëve deri tani.

Një mbrojtës, një mesfushor dhe një ëndërr për titullin e Interit



Interi po përgatitet për merkaton e verës. Pak blerje, por të goditura. Ky është plani i zikaltrëve. Objektivi është ai që të përmirësohet skuadra pa bërë shumë ndryshime brenda një grupi, që po funksionon shumë mirë nën drejtimin e Luçiano Spaletit. Zikaltrit, deri tani, kanë marrë 9 fitore dhe dy barazime në kampionat dhe janë në luftë për një titull që mungon prej shtatë vitesh. Ata janë në vendin e dytë, dy pikë larg Napolit. Për mesfushën, drejtuesit e klubit milanez po mendojnë për Ramires, ish-braziliani i Çellsit, i cili mund të largohet nga Jiangsu Suning për Interin me kosto zero, duke parë se klubi kinez është në pronësi të pronarëve aktualë të zikaltrëve. Por ëndërra është Javier Pastore. Argentinasi duket se nuk ka më dëshirë të qëndrojë te PSZH dhe Interi po mendon t'i ofrojë francezëve një këmbim me Zhoao Mario, edhe pse argentinasi duhet të pranojë të reduktojë rrogën aktuale që përfiton nga PSZH, 9 milionë euro. Ndërkohë, për mbrojtjen është zgjedhur Eliaquim Mangala. Spaletti do një alternativë për qendërmbrojtësit Shkriniar dhe Miranda, që kanë qenë një mur i vërtetë për ekipet kundërshtare. Për këtë arsye, francezi paraqet një mundësi të artë, duke parë se nuk ka hapësira te Mançester Siti. Falë marrëdhënieve të mira me menaxherët, lojtari mund të merret në huazim.

Skandal në Rusi, skualifikohen tre futbollistë Vënë bast kundër skuadrës së tyre!

Jurij Zukov, drejtuesi i përgjithshëm i Smena Komsomolsk, klub në kategorinë e dytë të Rusisë, ka deklaruar se ka mbetur pa fjalë nga sjellja e disa futbollistëve si Igor Baldin, Ibragim Bazaev dhe Nariman Gusalov të cilët akuzohen se kanë vënë bast në ndeshjen e tyre kundër Irtysh Omsk. Sipas drejtuesit, futbollistët kanë vënë bast një shumë të konsiderueshme për humbjen e skuadrës së tyre, duke fituar një "mal" me parë. Ndeshja u mbyll 0-1 për miqtë me penalltinë e shënuar në minutën e 18-të, pavarësisht se luajtën me një futbollist më pak që nga minuta e 30-të, kur njëri prej futbollistëve të Irtysh u ndëshkua me kartonin e kuq. "Na vjen shumë keq për atë që ndodhi. Është një tronditje për klubin tonë! Nuk do ta kisha pritur kurrë prej këtyre njerëzve. As që do ta



kisha menduar njëherë. Si mund të vihet bast kundër skuadrës ku luan? Është diçka e paimagjueshme!", - deklaroi Zukov. Ndërkohë, edhe zv.presidenti i Federatës së Futbollit në Rusi, Nikita Simonjan, ka komentuar skandalin e ndodhur në kategorinë e dytë duke pranuar se kjo situatë do të kushtëzojë reputacionin e futbollit rus. "Një situatë e tillë do të ndikojë nega-

tivisht te imazhi i futbollit rus. Akuzat janë vërtetuar dhe tani do të merren masa sepse këto persona nuk kanë të bëjnë me futbollin rus", deklaroi Simonjan. Ndërkohë, pas kësaj është vendosur se ndeshja e trukuar do të riluhet, ndërsa tre futbollistët të Smena Komsomolsk janë skualifikuar për dy vjet për shitje ndeshjesh me qëllim përfitimi nga bastvënia.

Ederi do të rinovojë për Interin

Ederi raportohet se është afër rinovimit të kontratës me Interin. Sulmuesi italian u bashkua me Interin në janar të vitit 2016 nga Sampdoria dhe ka shënuar 10 gola sezonin e kaluar. Ishte thënë se Mançini dëshiron ta transferojë atë te Zeniti, por "Tuttosport" shkruan se ai është shumë afër një rinovimi. Mendohet se bos i aktual, Luçiano Spaletti ka shprehur gatishmërinë që ta mbajë sulmuesin, kështu që ai do të nënshkruaj marrëveshjen e re që vlen deri në vitin 2021. Eder



deri tash e ka luajtur rolin e zëvendësuesit të super sulmuesit, Mauro Ijardi dhe ka pasur minutash të kufizuar. Interi gjenden në pozitën e dytë në Serie

A me 29 pikë, dy pikë më pak se Napoli në vendin e parë. Fitorja e fundit e Interit ishte ndaj Veronas në Marc'Antonio Bentegodi me rezultat 2-1.

Shkurt

Vidal nuk largohet

Arturo Vidal është objektivi i madh i Interit për merkaton e janarit por ashtu siç dështuan gjatë verës gjasat janë që zikaltrit të dështojnë sërish për të firmosur me mesfushorin kilian. Drejtori sportiv i bavarezëve Hasan Salihamixhiç ka nënvizuar se Vidal është një lojtar shumë i rëndësishëm për Bajernin dhe nuk do të largohet kursesi për asnjë arsye nga kampionët e Gjermanisë në merkaton e dimrit. Boshnjaku shtoi gjithashtu se trajneri i ri Jupp Henkes e njëj shumë mirë Arturon që nga koha që drejtonte Bayer Leverkusenin dhe di si të marrë më të mirën nga mesfushori amerikano-jugor.

Goretzka nuk rinovon

Shalke 04 vazhdon të këmbëngulë për t'i rinovuar kontratën talentin Leon Goretzka, por duket se mesfushori nuk ka ndërmend të qëndrojë gjatë në Bundesliga. 22-vjeçari është i tërhequr nga ofertat e disa prej klubeve më të mëdha evropiane, kur përfshihen Juventus, Barcelona, Arsenali, Mançester Junajtedi dhe Liverpooli. Kontrata e tij me Shalken përfundon verën e ardhshme, çka do të thotë se do të largohet me parametër zero. Drejtuesit e klubit gjerman po insistojnë për t'i zgjatur kontratën, ose do të jenë të detyruar ta shesin në janar, për të përfituar nga kartoni i tij.

Kutinjo dëshiron vetëm Barcelonën

Mesfushori brazilian, Filip Kutinjo ishte pranë largimit nga Liverpool verën e kaluar, por në fund skuadra angleze refuzoi shitjen e tij. Thashethemet rreth të ardhmes kanë filluar sërish, me Barcelonën dhe PSZH-në të interesuara për shërbimet e tij. Por, e përditshmja katalonase, "Mundo Deportivo" shkruan se Kutinjo dëshiron vetëm Barcelonën, ose në të kundërtën do të qëndrojë në Liverpool. Braziliani ka kontratë me skuadrën angleze deri në vitin 2022, ndërsa Liverpooli për shërbimet e tij kërkon 150 milionë euro.

Guardiola i çmendur pas Kimishit

Mbrojtësi i kampionëve gjermanë, Xhoshua Kimish, është vënë në shënjestër e ish-trajnerit bavarez, Pep Guardiola. Sipas të përditshmes britanike "Daily Mail" thuhet se trajneri i skuadrës së Mançester Siti është fiksuar pas mbrojtësit bavarez, për të cilin është i gatshëm të ofrojë një vlerë prej 50 milionë eurosh, por sipas këtyre burimeve, klubi i Bajernit nuk pritet ta lëshojë mbrojtësin gjerman. Ndoshta një shifër edhe më e lartë mund t'u ndryshonte mendjen shefave bavareze. Megjithatë, disa ditë më parë, mbrojtësi i kampionëve gjermanë ka deklaruar se kërkon të luajë gjatë me fanellën bavareze.

Interi ia mbyll dyert Barçës për Shkriniar

Raportohet se Interi i ka bërë të ditur Barcelonës se nuk e kanë ndërmend të shesin Milan Shkriniar. Sipas "Mundo Deportivo" klubi katalunas e ka futu slllovakun në listën e tre mbrojtjeve për t'i transferuar gjatë afatit kalimtar të janarit. Por, sipas "Tuttosport" thotë se nuk ka vend për panik te tifozët italian pasi Shkriniar nuk do largohet nga Interi. Shkriniar ka bërë revolucion këtë sezon në fazën mbrojtëse te Interi duke i befusuar të gjithë me paraqitje të mira. Te klubi nga Milano ai erdhi nga Sampdoria për 25 milionë euro.



Rezultati është i padrejtë nëse marrim parasysh performancën që kemi bërë. Është mëkat, pasi që ne e mbajtëm në 16 metërsh ekipin më të mirë në Evropë për një kohë të gjatë. Duhet t'i studiojmë detajet dhe të minimizojmë gabimet

Mbrëmja e dytë e ndeshjeve të katërta në grupet e "Champions League" është shënuar kryesisht nga dy rezultate befasisuese. Kampionët e Realit të Madridit janë "gjunjzuar" në "Wembley" të Londrës nga Tottenhami, ndërsa Napoli i Elseid Hysajit rrezikon të mbetet jashtë turneut prestigjioz, pas humbjes në "San Paolo" 2-4 nga Manchester Siti

Lojtarët e Tottenhamit ishin "Los Blancos-it" e vërtetë gjatë mbrëmjes së mërkurës teksa skuadra e drejtuar nga Mauricio Pochettino ka fituar bindshëm me rezultatin 3-0 ndaj Real Madridit. Kriza e skuadrës së Zinedin Zidane vazhdon, dhe tani Ronaldo me shokë rrezikojnë seriozisht pjesëmarrjen në fazën e ardhshme të Ligës së kampionëve, por barazimi i Borussia Dortmund me APOEL ka zvogëluar paksa hidhërimin e kësaj disfatë të rëndë. Golat për Tottenhamin i shënuan Dele Ali në dy herë dhe Eriksen, ndërsa golin e nderit për Realin e shënoi Cristiano Ronaldo. Pikërisht Dele Ali pas ndeshjes nuk ishte i befisuar nga cilësia e performancës së Tottenhamit në fitoren ndaj Realit, ndërsa pohon se kanë mundur të shënojnë më shumë. "Të jem i singertë, jo", i tha Alli "BT Sport" kur u pyet nëse u befisua nga paraqitja ndaj Realit. "Ne kemi biseduar pas ndeshjes në "Bernabeu" dhe kemi e kemi kuptuar se besuam sa hapësirë kemi pasur për të luajtur dhe sa lehtë bënim

Liga e kampionëve – Kampioni aktual gjunjzohet në "Wembley"

Dy rezultate befasisuese



pasimet, pasi ata ishin shumë të pa angazhuar. Mendoj se e kemi ditur se nëse ne jemi solid atëherë mund të arrijmë të krijojmë raste dhe gjithmonë ndaj ekipeve të tilla luajmë për fitore. Ishte performancë fantastike prej nesh. Ne i kemi qëndruar besnik planit të lojës dhe bëmë shumë raste. Kemi mundur të shënojmë më shumë, por jam i kënaqur me rezultatin", deklaroi autori i dy golave për Tottenhamin. Në anën tjetër kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, nuk ka mundur ta rruaj temperamentin pas ndeshjes. Por, Ramos insiston se ekipi i Zidane që

AGUERO THYEN REKORDIN 78-VJEÇAR

Sergio Agüero është bërë golashënuesi kryesor i Manchester Sinit, në sajë të golit të tij kundër Napolit. Argjentinasi tani ka 178 gola për Sinit, duke tejkaluar Erik Bruk, me 177 gola. Bruk shënoi golin e tij final për klubin anglez në vitin 1939, që do të thotë se Agüero ka thyer një rekord, që ka qëndruar në fuqi për 78 vjet. Ndërsa Bruk i shënoi golat e tij gjatë një periudhe 11-vjeçare me Manchester Sinit, Agüero ka arritur ta tejkalojë atë në pak më shumë se gjashtë vite.

është i dyti në Grupin H do të rikthehet fuqishëm. "Ne i kuptojmë tifozët të cilët mund të zhgënjehen nga rezultatet e fundit, por Real Madridi do të luftojë dhe do të kthehet e nëse dikush mendon se jemi të mbaruar, ne do t'ua tregojmë vendin shumë shpejt.

Nga përvoja ime te Reali, kur humbisni disa ndeshje, njerëzit fillojnë të flasin për krizë. Duhet të qëndrojmë të qetë dhe të bashkuar. Ne jemi gjallë në garën tonë të preferuar, në Ligën e Kampionëve. Ne duhet të mbesim të qetë, të mbesim të

posedimin më mirë. Nëse lejoni Napolin të luaj, atëherë ka gjasa të mos dilni nga zona e penaltisë për 90 minuta. Unë e di se çfarë ekipi kemi mposhtur këtu. Është ekip që kënaqem duke e shikuar. Ata më bënë të vuaj në pjesën e parë. Shpresoj se lojtarët e tyre do të qëndrojnë pa lëndime, sepse futbollit ka nevojë për ekipe si Napoli. Unë kam respekt të madh për Napolin, Sarrin dhe gjithë këtë ekip. Shaktari po ashtu po luan mirë. Por, ne do të shkojmë në Ukrainë për të fituar dhe Napoli i ka gjasat e veta", deklaroi pas ndeshjes trajneri i Sinit, Pep Guardiola.

Ndërkohë Liverpooli ka mundur pa shumë probleme Mariborin, por këtë herë pa goleadë duke ruajtur energjitë për ndeshjen e radhës në Premier Ligë, ku nuk janë paraqitur ashtu siç duhet. Të besuarit e Jurgen Klopp, pas një pjese të parë pa gola, gjetën golin me anë të Salah në të 49' dhe Xhan në të 64'. Në fund ishte edhe Starrixh që shënoi golin për herë të parë pas shtatë vitesh në "Champions League". Një natë për t'u harruar ishte kjo për gjermanët, me Dortmundin që nuk shkoi më shumë sesa barazimi 1-1 me APOEL-in e Nikozisë, ndërsa Leipzig u mposht nga Porto 1-3 në duelin për vendin e dytë të grupit G.

Lanus – Gremio, finalja e "Copa Libertadores"



Lanus do të ketë përballë Gremion në finalen e "Copa Libertadores", që do të luhet më 22 dhe 29 nëntor. Skuadra braziliane u mposht 0-1 në shtëpinë e saj nga Barcelona e Ekuadorit, duke prenotuar një biletë për përplasjen e madhe. Futbollit i Amerikës së Jugut ka treguar shpeshherë që është i surprizave të mëdha, sikurse ndodhi me përmbysjen historike të Lanusit, që fitoi 4-2 me River Plate. Barcelona (sigurisht jo

ajo e Messit), tentoi të pamundurën në "Arena do Gremio" në Porto Alegre, por nuk shënoi më shumë se një gol në portën e vendasve, që mbeten nën presion deri në vërshtëllimën e fundit të gjyqtarit, edhe pse kishin fituar 3-0 në fushën kundërshtare. Goli i Alvez në minutën e 33-të u dha zemër futbollistëve ekuadorianë, që gjithsesi, nuk mundën të realizonin një përmbysje të madhe, që do të ishte historike.

Mediat spanjolle nuk mund të qëndrojnë indiferent

Atletiko po përballet me momentin më kritik të viteve të fundit

Mediat spanjolle nuk mund të qëndrojnë indiferente përballë krizës që po kalon një prej skuadrave më dominante në kampionatin spanjoll, gjatë viteve të fundit, me Atletikon e Madridit që po përballet me momentin më kritik të viteve të fundit, si në kampionat ashtu edhe në "Champions League". Në një analizë ato parashetrojnë motivet që duket se po përmbysin skuadrën e Simeones. Mungesa e golit, e rezultateve dhe mos shpërfaqja e cilësive maksimale të yjeve madrilenë si Griezmann, Gameiro, Gaitan, Torres, Karrasko apo Vietto, janë përkthyer në një periudhë thatësire për Atletikon. I vetmi që nuk e ka humbur ende grintën në fushë mbetet Korrea.

Griezmann në veçanti nuk po tregon nivelin që pretendohet prej tij. Në 12 takime ka shënuar vetëm tre gola, dy në La Liga dhe një në "Champions" dhe tre asistime. Shifra tërësi-




sht të pamjaftueshme për të justifikuar statusin e tij. Nga ana tjetër vlen për t'u përmendur edhe moshën mesatare e organikës së "Los Colochoneros", si faktori i rëndësishëm që ndikon në situatën kritike. Kështu një pjesë e mirë e strukturës, madje edhe lojtarë kyç si Filipe, Godin, Gabi apo Huanfran i kanë lënë më kohë të 30-at.

Njëherazi sanksionet e gjykatës së arbitrazhit sportiv, të cilat janë aplikuar tek Atletiko, duke i mohuar mundësinë për të përforcuar organikën


gjatë merkatos verore, kanë pasur ndikimin e tyre negativ. Simeones iu desh të konfirmonte aftësitë e tij drejtuese me minimumin e lojtarëve, e po kështu do t'i duhet të vijojë deri vitin e ardhshëm, kur mund të jetë sërish aktiv në merkato. Diego Kosta do të jetë përforcimi i parë i rëndësishëm. Përgjatë viteve të fundit Atletiko karakterizohet nga forca, ish-te një skuadër nga ato mjaft të vështira për t'u thyer, kjo falë një mbrojtjeje solide, një me-fushe të definuar si dhe

një sulmi që ushtronte presion. Një rival që stepte cilindo ekip që i dilte përballë, por sot panorama është kthyer në invers. Kjo skuadër ka ndalur së funksionuari. Mesa duket edhe stadiumi i ri nuk ka qenë shumë fatsjellës për skuadrën e "Los Colochoneros", ndryshe nga Visente Calderon. Tekniku argjentinasi dhe skuadra e tij kanë parë shumë pikë të rëndësishme t'u shpëtojnë nga duart gjatë takimeve të fundit. Atletiko është parë të shndërrohet në këtë sezon, pasi ka pësuar më shumë se 10, 7 prej të cilëve me kokë, gjë që nuk mund të ndodhte kur mbrojtja e tyre ishte si një mur i pathyeshëm. Për një ekip që në vitet e fundit ka qenë një dominues i lojës në ajër, të gjitha këto janë argumente se Atletiko e Madridit nuk është më e njëjta, dyshimi është deri ku do të mund të shkojnë ata në këtë rrugëtim që çalon.


DASHI (20/III-20/IV)

 Dita e sotme do të jetë pak kaotike dhe me të papritura aspak të këndshme dhe kjo vjen si shkak i Hënës në kundërshtim. Në marrëdhënien në çift nuk ndiheni mjaft të dashuruar. Ditë mjaft e ngarkuar edhe në punë.


DEMI (21/IV-20/V)

 Me yjet në favor mund ta quani veten të privilegjuar sot. Trokitni në të gjitha dyert që ju kanë mbetur të mbyllura deri tani, sepse sigurisht ndonjëra do ju hapet. Dashuria do ju dhurojë momente të bukura, sidomos në mbrëmje.


BINJAKËT (21/V-20/VI)

 Yjet ju këshillojnë të tregoni kujdes në çështjet financiare, sepse rrezikoni të shpenzoni jashtë kufijve tuaj. Ditë e mirë për sa i përket jetës sentimentale, me takime mjaft interesante, edhe pse do të kaloni më shumë kohë me miqtë tuaj.


GAFORRJA (21/VI-22/VII)

 Nuk do të mungojnë pengesa të ndryshme dhe një humor aspak i mirë si shkak i Hënës te shenja e Bricjapit. Gjithsesi do të keni energji të mjaftueshme për të përballuar çdo të papritur.


LUANI (23/VII-22/VIII)

 Do të dini si t'i arrini objektivat e dëshiruara dhe personat që ju qëndrojnë pranë do të aprovojnë vendimet tuaja. Nuk është një fazë kalimtare, por një fazë mjaft e ekuilibruar dhe harmonike për sa i përket sektorit profesional.


VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)

 Nuk do të mungojnë okazionet për të gjetur zgjidhjen e një problemi, për të kaluar sa më mirë kohën e lirë, ose për të diskutuar me partnerin siç nuk ndodhte prej kohësh. Ditë e rëndësishme për ata që janë vetëm, të cilët do të ndiejnë dëshirën për të pasur dikë që mund ta dashurojnë.


PESHORJA (23/IX-22/X)

 Përgatituni për një ditë mjaft të ngjeshur me punë. Në qoftë se jeni çift do të argëtoheni duke ngacmuar partnerin për ta bërë marrëdhënien tuaj më të bukur. Momente të bukura nuk do të mungojnë për ata që janë vetëm.


AKREPI (22/X-21/XII)

 Qielli sot do të jetë i gjithi në favorin tuaj, sidomos në qoftë se keni lindur në nëntor. Ditë e favorshme për të udhëtuar, për të nisur një histori të re dashurie, ose për të ftuar për darkë miqtë tuaj më të ngushtë.


SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

 Jeta sociale do të jetë mjaft e gjallëruar, ashtu siç dëshironi ju: ftesa, festa dhe darka që nuk do ju lënë kohë për pushim. Në qoftë se jeni vetëm, shikoni mirë përreth, ndoshta shpirti juaj binjak mund të jetë fshehur midis personave që frekuentoni çdo ditë.


BRICJAPI (22/XII-20/I)


 Me Hënën në shenjë, të lumtur dhe triumfues do të realizoni me entuziazëm gjithçka që keni për zemër. Afërdita ju fton t'i kushtoni më shumë më shumë vëmendje si shëndetit, ashtu edhe njeriut të zemrës.

UJORI (20/I-19/II)

 Koincidenca që duken të pabesueshme do ju lejojnë të bëni hapa para në projektet tuaja. Zemra ka nevojë për diçka të re, merrni iniciativa edhe pse mund t'ju duken paksa të nxituara. Ditë e bukur për ata që janë të dashuruar.

PESHQIT (20/II-19/III)

 Hëna në sektorin e karrierës ju stimulon më shumë për të arritur objektiva të rëndësishme profesionale. Nuk ka asnjë mundësi që dikush t'ju pengojë, sepse energjitë dhe kurajotja që keni ju ndihmojnë të arrini atë që dëshironi. Jupiteri dhe Urani nxisin më shumë fantazinë tuaj.



NE KETE DATE

FILM ME AKTORIN NË FOTO	R	PREMTIM PËR TË BËRË DIÇKA, DALJA ZOT E NJË PUNE	I RIFILLON	NORVEGJIA	LLAMBAMETRI ELEKTRODA	KRATER NE HËNE EUROPE	SHPREHJE MATEMATKORE E PËRBËRË VETEM PREJ NUMRAVE (PA OPERACIONE MATEMATKORE)
ÇINTEGRIM	D						
ELEMENT KIMIK (B)				LUMË NË GJERMANI MAQEDONIA			MOLIBDENI INSEKT I NEVERITSHËM
SHOYRTIMI I RRETHANAVE TË NJË KRIMI	H					REVOLUCIONARI DURAKU LETËRSI (SHKURT.)	
ISH KRYETARI AMERIKAN, ABRAHAM							OKSIGJENI Ë. T.
PËREMËR PRONOR				DOKTRINË QË E QUAN ZOTIN VETEM SI KR LUJES KALIUMI			
PULË DETI MISEROKE (SH.)						KALI I SHALËS	

ZGJIDHJET: K, DEPO, JOPAK, LIRA, FLAK, LOBO, MUGULL, N, RA, R, DAG, DEZINTEGRIM, BOR, RUR, MO, HETIMI, EMIN, LINKOLNI, O, IMI, DEIZËM, MISKAT, ATI.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

			1	3	9						2						
1		4									1	8					4
	6		8		4				8	4	6			5			
	4									9		2	5	8		7	
		3	5	9				8	2		7		6				5
			3			5						9	1	3			
		2			8	4		5						4	5	1	3
	3		6									5			4		
					5		7			3					2		

Shumë i lehtë: 857213964, 124967853, 369854721, 546781239, 713592648, 298346517, 672138495, 435679182, 981425376. Mesatar: 952461738, 371829654, 846375921, 194258376, 283746195, 567913842, 728694513, 619532487, 435187269.



Avioni përplas me njërin krah furgonin gjatë uljes

Përplasja në tokë mes një avioni të kompanisë "Ukraine International Airlines" dhe një furgoni të aeroportit, ka shkaktuar kaos në aeroportin e Kievit. Por në fund, gjithçka ka shkuar mirë. Protagonist i incidentit, ishte një "Boeing 737-800" i linjës "Fly Uia Kiev-Charkiv" dhe kur komandanti ka marrë "OK"-in për manovrën e përgatitjes së uljes në listë, ka godi-



tur me njërin kah furgonin e shërbimit në zonën e parkimit. Episodi është fotografuar nga punonjësit e aeroportit. Kompania ajrore ka shpërndarë më pas në profilin e saj në "Facebook" një komunikatë, duke sqaruar mbi atë që ka ndodhur dhe qetësuar pasagjerët. Pavarësisht nga ajo që ndodhi dhe vonesës së shkaktuar, avioni ka zbritur rregullisht mbi pistë.

Avokati: Femrat që veshin xhinse të grisura duhet të përdhunojnë!

Një avokat egjiptian është vënë në qendër të kritikave pasi ka deklaruar se gratë të cilat mbajnë xhinse të grisura duhet të përdhunojnë. Nabih al-Wahsh tha se nëse një grua mban veshur pantallona të tilla ajo meriton të ngacmohet seksualisht dhe sipas tij, kjo ishte detyra kombëtare e çdo mashkulli egjiptian. Komente të tilla skandalozë u bënë nga juristi egjiptian gjatë një shfaqjeje televizive në kanalin Al-Assema. Al-Wahsh ishte i ftuar në një emision televiziv, ku të ftuarit po diskutonin rreth ligjeve në lidhje me



"prirjet drejt shturjes". Ai tha se nëse gratë veshin xhinse të grisura duke treguar pjesë të këmbëve të tyre, "ftojnë" meshkujt që t'i ngacmojnë ata. Sipas asaj që shkruan Al Arabiya, avokati shtoi se të përdhunosur gratë që mbajnë të tilla xhinse është një detyrë kombëtare, duke nënkuptuar se kjo është një mënyrë që ata të mësojnë të respektojnë veten. Ai tha: "Femrat duhet të respektojnë veten, në mënyrë që të kenë edhe respektin e të tjerëve. Mbrojtja e moralit është më e rëndësishme se mbrojtja e kufijve".

Qyteti fare pa policë dhe ku komuna ta ndërton shtëpinë



Marinaleda është një qytet që gjendet në pjesën jugore të Spanjës, me një sipërfaqe prej 25 kilometra katrorë. Ky vend është ndër qytetet më ideale për të jetuar. Thuhet se aty Bashkia ta ndërton falas shtëpinë, nuk ka të

papunë dhe rrogat fillojnë nga 1200 euro. Stërviçet po ashtu janë pa pagesë në të gjitha stadiumet, nuk ka polici dhe interneti është pa pagesë në gjithë qytetin! Më poshtë keni pamje të këtij vendi që secili do të donte të jetonte në të.

KALENDARI HISTORIK 3 NËNTOR

- 644 - Omer Ibn Hatabi, Kalifi i dytë mysliman, vritet nga një skllav persian në Medina.
- 1394 - Hebrënjtë dëbohen nga Franca me urdhër të Çarlsit VI.
- 1493 - Kristofor Kolombo zbulon ishujt dominikane.
- 1656 - Traktati i Vilnius - Rusia dhe Polonia nënshkruajnë marrëveshje kundër Suedisë.
- 1676 - Kara Mustafa trashëgon Ahmed Kipru lu si Vezir të Madh turk.
- 1716 - Traktati paqësor i Varshavës: Cari Pjetri i Madh garanton Monarkut sakson August I Mbretërinë polake.
- 1903 - Kolumbia pranon pavarësinë e Panamasë.
- 1918 - Shuhet Perandoria Austro-Hungareze.
- 1918 - Polonia shpall pavarësinë nga Rusia pas Luftës së Parë Botërore.
- 1928 - Turqia ndryshon alfabetin prej arab në atë latin.
- 1978 - BRSS dhe Vietnamit nënshkruajnë Traktat të Paqes dhe Miqësisë.
- 1992 - Bill Klinton fiton zgjedhjet presidenciale kundër Presidentit Xhorxh Bush.

A E DINI SE... ?

Në 2016, 300 milionë gra në 69 shtetet më të varfra në botë kanë përdorur metoda kontraceptive, deri në 30 milionë më shumë se në vitin 2012. Në vitin 2015, ishin 36.7 milionë njerëz me HIV pozitivë, 1.8 milion prej të cilëve ishin nën moshën 15 vjeç. Ende një numër shumë i lartë, por shumë është duke u bërë në drejtim të ngritjes së vetëdijes për masat parandaluese dhe terapitë antiretrovirale, të cilët sot marrin një diagnozë, me terapitë e duhura mund të kenë një jetëgjatësi në normë.



Varfëria absolute është përcaktuar si nevoja ekstreme e atyre që janë të detyruar të jetojnë me më pak se 1.90 dollarë në ditë (\$ 1.58) në ditë. Për 150 vjet, nga 1820 deri më 1970, numri i njerëzve në këtë situatë vazhdoi të rritet: në fund të viteve 1970, mbi dy miliardë njerëz në botë ishin në gjendje të varfërisë absolute. Tani ky numër ka rënë në 705 milionë, falë politikave të përfshirjes dhe bashkëpunimit që e kanë bërë luftën kundër indigjencës një nga prioritetet globale.



BARSOLETA



DY BIONDE DHE PASQRYA
Duke ecur rrugës, dy bionde gjejnë një pasqyrë.
Njëra e merr, e shikon dhe thotë:
- Sa e njohur me duket kjo vajzë!
E merr tjetra dhe shikon:
- Budallaçke, a s'e sheh se jam unë!

THËNIA E DITËS

Budallallëku është shumë më i rrezikshëm sesa e keqja, sepse e keqja herë pas here bën pushim, kurse budallallëku jo!
(Anatole France)

